

Ramiz Gjini

# Pëllumbat e rrugës

Roman



**BOTIMET M&B**

RAMIZ GJINI

# Pëllumbat e rrugës

**BOTIMET M&B**

Ramiz Gjini  
Pëllumbat e rrugës  
*Roman*

*Redaktor:*  
Agron Tufa

*Në kopertinë:*  
*Pikturë nga Anatoly Kozelsky*

*Grafika: M&B*

ISBN: 978-9928-172-56-3

© Të gjitha të drejtat i takojnë autorit

**BOTIMET M&B**

Rr. "Isa Boletini", Pall. "Planet X", Tiranë  
Tel. (04) 22 33 283. Cel: 069 20 68 603  
E-mail: info@mbootime.com / mbootime@gmail.com  
www.mbootime.com.  
<https://www.facebook.com/mbootime>

O Zoti ynë! Si ta rrëfejme këtë histori? Kush do të na e besojë, përderisa gjithë çudirat që ndodhin në Biboll t'i mveshin ty? Sepse, nëse në Biboll ndodh ndonjë bidat më vete dhe kërkon të dish shkaqet pse ndodhi, ata menjëherë të thonë se kështu e kishte shkruar *Zoti i madh* në defter! Askush nuk e zë me gojë *zotin e vogël*, të plotfuqishmin, këtë cub modern, që ka në dorë gjithë fatet e bibollasve.

Ky *zoti i vogël*, ka lindur si një fëmijë i jashtëligjshëm dhe është rritur pothuajse në ilegalitet.

*Ai* zotëron aftësinë për të ndryshuar dukjen e për të shkërbyer të tjerët. Emrin e tij e has në shumë pasaporta. Ai banon në të katër anët e atdheut tonë jo dhe aq të lavdishëm, prandaj dhe është i kudogjendshëm.

Nganjëherë, *zoti i vogël* vishet shik si një zotëri i lartë dhe mban syze të errëta. Është i pastër, i larë e i rruar dhe bie erë livando. Kur ecën në këmbë, mban gjithmonë një dosje nën sqetull dhe e ndjekin nga pas një eskortë hallexhinjsh. *Zoti i vogël*, preferon më shumë lokalet ku serviret mish i pjekur qengji, qofte, biftekë viçi, kukurecë si dhe raki e verë e vjetër. Ulet në një vend të dukshëm dhe

para se të nisë të flasë, që ta dëgjojnë me shumë vëmendje, ngre dorën përtueshëm lart. Dora e tij është e bardhë, me pak qime të zeza në kurrizin e saj dhe me gishtërinjtë e ngrydhët e si të gëlqerosur. Me këtë lëvizje të ngathët, por të magjishme, *zoti i vogël*, vendos qetësi absolute jo vetëm mes njerëzve që e rrethojnë, por anembanë Bibollit.

Nganjëherë, *zoti i vogël* duket si kaubojs, si gangster rruge, si kodosh grash, hajdut ordiner, por edhe vjedhës i moderuar me grada; mban flokë të gjata, të palara, vishet me rroba të ngushta që t'i duken muskujt dhe nuk fshin as hundët e veta; por udhëton me makina të shtrenjta dhe në brez mban armë vdekjeprurëse.

Në të gjitha rastet, *zotit të vogël* i gëlojnë në kokë mendime të mbrapshta.

Një herë, është parë edhe në zyrën e kryeparit Xhabir Kaçorri duke bërë allishverishe me bosin e një kompanie të huaj. Dëshmitarët thonë që, për të mos rënë në sy, *zoti i vogël* kishte shkërbyer kryekëput kryeparin tonë të nderuar. Mu si kryepari ynë, edhe ai, ngrinte supet dhe shtrembëronte kokën sa herë bëhej gati të nxirrte ndonjë fjalë nga goja.

Një herë tjetër është parë në doganë teksa kontrollonte kamionë të mëdhenj të ngarkuar me mall kontrabandë. *Zoti i vogël* që veshur me të njëjtat rroba që vesh shefi i policisë, Filip Zhuli. Në thilenë e xhaketës së tij binte në sy dekorata e *trimërisë*, dhënë nga presidenti i republikës. Madje, *zoti i vogël*, për t'u dukur kopje perfekte e Filipit, kishte veshur me flori edhe tre dhëmbë të krimbur. Qenë të njëjtët dhëmbë që ka veshur me flori edhe Filipi.

Hodo Marubi nga Arrasi betohet e stërbetohet se e ka parë *zotin e vogël* edhe në zyrën e kryetarit të bashkisë.

Tymoste puro të trashë, bënte shaka prej babaxhani dhe qeraste e dehte një hallexhi me uiski të markës *Johny Walker*. A nuk bën nganjëherë të njëjtën gjë edhe kryetari ynë i nderuar? Por Hodo Marubi u bë i pabesueshëm kur tha se e kishte parë *zotin e vogël* edhe në rrugë të madhe, teksa vriste një njeri me armë...

Nëse të gjitha këto që pëshpëriten lart e poshtë janë rragatje fjalësh të kota, atëherë kush mund të thotë, përse punët e *Zotit të madh* janë mu si t'i kryente *zoti i vogël*?

Autori i këtij libri, hë për hë, nuk e ka fort për zemër të vazhdojë të rrëfejë për *zotin e vogël*. Këtë, mbase do ta bëjë herë tjetër. Tani, thjesht do të rrëfejë për Lushen, Tushin dhe ca të tjerë, që i do shumë e që nuk i rrihet pa treguar për ta, ndaj bëni durim dhe ndiqni rrëfimin.

Lushja qe vajza e vetme e Brahim Çadërbashit, ish kryetar këshilli të lartë, burri më me mend në *Zonën e Shkurreve*. Ai qe aq i matur në veprime, sa i linte punët zvarrë, dhe aq i përmbajtur në fjalë, sa përgjigjen e një pyetje që ia bëje sot, ta jepte pasnesër. Kishte qenë kandidat për kryetar bashkie në tre fushata zgjedhore, por nuk kishte arritur të zgjidhej.

E bija e Brahimimit, Lushja, nuk ishte as e pashme, as e shëmtuar. Mbante një nishan në faqe si dhe kishte një dhëmbë të thyer në rrethana që nuk i dimë. Për këtë shkak, sa herë qeshte, ajo vendoste dorën te goja. Por kishte një palë buzë epshore gjithë tul dhe një vështrim i ëmbël i buronte nga sytë e saj të mëdhenj e të zinj.

Tushi qe njëri nga dymbëdhjetë fëmijët e Zav Tarrotës, i cili kishte gjithë jetën që lëngonte nga sëmundja e mërzisë së thellë. Ky llafazan i patëkeq, vajti edhe në Qabe për haxhillëk dhe, kur u kthye prej andej, nisi të bënte një jetë aq të ndershme e të drejtë, sa, edhe kur ecte rrugës, i bënte sytë katër nga frika se mos shkelte pa dashje ndonjë milingonë.

Tushi, kishte marrë nga i ati shumë veti fizike dhe

morale. I ngjante në paraqitje, ecte si ai, duke u lëkundur, i pëlqente të bënte nga një çikëz filozofi dhe vuante nga sëmundja e mërzisë së thellë. Ama, ndryshe nga i ati, ai kishte gjetur një mënyrë për ta vrarë mërzinë: të gjitha të vërtetat që ka jeta, i merrte si lojë. Kësisoj, ai kalonte kohën, zbaviste veten dhe të tjerët.

Ç'është e vërteta, bibollasve në përgjithësi u pëlqente të luanin me njëri-tjetrin. Ata zgjidhnin lojtarin ose lojtarët për t'u bërë palë me ta dhe pozicionoheshin në lojë përballë kundërshtarit ose kundërshtarëve. Kishte lojëra të hapura, por kishte edhe lojëra të fshehta. Cilido mund të gjendej brenda lojës, pa e ditur se ishte në lojë. Por mund të ndodhte, që dikush të vazhdonte të luante, pa e ditur se ishte nxjerrë jashtë loje. Shumë nga lojërat ishin të njohura, dinin t'i luanin të gjithë; por kishte edhe lojëra që sajoheshin aty për aty në mënyrë spontane me një fantazi të përkryer; ato qenë shumë tërheqëse e zbavitëse.

Lojërat që luheshin më shumë në Biboll ishin:

loja me *pushtetarin, shtetin dhe popullin*;

loja me *sekretaren, drejtorin dhe gruan e drejtorit*;

loja me *doktorin, të sëmurin dhe prindin hallexhi*;

loja me *haramin, hallallin dhe hallin*;

loja e *deputetit me votuesit*;

loja me *burrin, gruan dhe dashnorin e gruas*;

loja me *analistin han-alistin dhe drejtuesin e emisionit*;

loja me *avokatin, gjyqtarin dhe kriminelin*;

loja me *hajdutin e xhepave, faturinon dhe shoferin e autobusit*;

loja me *vipat dhe rrypat*;

loja me *patriotin, tradhtarin dhe tundësin e flamurit*;



loja me *Zotin, hoxhën dhe besimtarin*;  
 loja me *drogën, shitësin dhe të droguarin*; si dhe shumë e shumë lojëra të tjera, që nuk ia vlen t'i përmendim të gjitha.

Thjeshtë për lojë, bibollasit hynin në marrëdhënie edhe me kafshët. Imitonin ta zëmë, një blegërimë cjapi dhe bënin të reagonte prej dikah një dhi, që ishte ose nuk ishte dhi. Nxirrnin një hingëllimë pele dhe fill pas kësaj vinte prej larg përgjigjja e një kali, që ishte ose nuk ishte kalë. Nëse dikush palte si gomar, do të merrte si përgjigje pëllitjen e një, dy, ose tre “gomerëve”, që ishin ose nuk ishin gomerë. Dikush luante qenin, dikush derrin, dikush dhelprën e dikush tjetër ujkun. Nganjëherë bibollasit i luanin këto kafshë në mënyrë të pavetëtishme, pa e ditur aspak cilën kafshë po luanin. Ndothte që ndonjëri, ndërsa mendonte se luante, ta zëmë, luanin, befasohej kur kuptonte, që në të vërtetë po luante gomarin! Nëse e pyesje tjetrin çfarë kafshe luante, ai nuk tregonte. Madje zemërohej kur i bëhej kjo pyetje, pasi loja kishte rregullat e veta. Pak a shumë, qe e njëllotjë si në lojën me letra, ku kundërshtarët i fshehin letrat, nuk i tregojnë, ndryshe nuk mund të luhet loja. Pra, bibollasit e fshihnin kafshën që luanin, nuk e tregonin atë, ndryshe, nuk mund të ishin të suksesshëm në lojë. Edhe nëse ndonjëri i thoshte dikujt se ishte luan, tigër apo qen, nuk e besonte askush, sepse e dinin, që kjo ishte thjesht një taktikë për të gënjyer, trembur e çorientuar kundërshtarin. Në shumicën e rasteve, luani dilte që ishte lepur, ose më e shumta, çakall.

Vajzat zakonisht luanin sorkadhen, delen, dhinë, pulën e ndonjëra edhe thëllëzën. Por kishte që luanin edhe macen, lopën, dhinë ose dosën.

Lushes disa lojëra i pëlqenin e disa të tjera jo. Njëren nga lojërat që pëlqente, ajo e luajti një mbrëmje vere.

Kjo lojë nisi kur ajo dëgjoi t'i vinte në vesh një blegërimë cjapi, që për Lushen mund të ishte ftesë për shoqëri, përshëndetje e një të njohuri; mund të ishte lutje, ankesë, qortim, thirrje për ndihmë ose propozim për dashuri. Le ta tregojmë si ndodhi:

Lushja po kthehej e vetme nga një festë ditëlindje, që i mblodhi bashkë gjithë ish shokët dhe shoqet më të ngushta të shkollës kur dëgjoi t'i vinte në vesh një blegërimë cjapi.

Teksa ecte, ajo mbajti hapin. Të blegërinte vërtet ndonjë cjan që kish mbetur prapa tufës apo dikujt i pëlqente të lozte me të? Nëse dikujt ia kish shkrepur të luante me të, Lushja do të donte të dinte cili ishte ai ose ajo që donte të luante me të, dhe se ku mund ta shpinte kjo lojë.

Ajo u bë kurioze dhe hyri në lojë: blegëriu si dhi dhe mbajti vesh. Përnjëherësh, cjapi ia ktheu me blegërimën e tij.

Lushja nuk arriti të kuptonte nga cila anë i erdhi blegërima si përgjigje. Jo shumë larg prej aty, gjendeshin dy mullarë me jonxhë të tharë. Ajo u afrua pranë tyre, u vajti rrotull me kujdes, por nuk gjeti aty asnjë frymë gjallese. E ndolli sërish cjanin. Dhe sërish mori një tjetër blegërimë si përgjigje. Ajo mundi të përcaktonte vetëm drejtimin nga i erdhi blegërima, por nuk arriti të shikonte asgjë me sy.

Loja po ndizej më tepër.

Kësaj here, asaj iu bë sikur cjapi po i largohej. Lushja shpejtoi hapin dhe hyri në një rrugicë të ngushtë për anash së cilës kishte plepa dhe vidha. Kjo rrugicë shtrihej përreth një kanali me uji të pakët dhe varej teposhtë përskaj varrezës,

derisa arrinte rrënojat e një mulliri të vjetër; pastaj ngjitej në krye të një livadhi të pjerrët ku gjendej plevica e Tush Tarrotës, e mbushur me bar të thatë. Plevica kishte një derë llamarine të ndryshkur, pa çelës.

Lushja ndaloi hapin, u mbush me frymë dhe mbajti vesh mos dëgjonte ndonjë zhurmë, por asnjë zhurmë nuk u dëgjua përveç xinxërimit të bulkthave, zhurmimit të lehtë që bënte uji brenda kanalit e nganjëherë më të rrallë, ndonjë flatrim zogu i trembur.

Kaluan ca çaste dhe ajo dëgjoi t'i vinte sërish në vesh një tjetër blegërimë prej cjapit. Kësaj here, blegërima i erdhi si një ftesë plot lutje e përgjërim.

Lushja ia ktheu me blegërimën e saj. Ajo shpejtoi hapin me zemrën që i rrihte fort në kraharor dhe ndaloi pranë plevicës.

Blegëriu sërish, tashmë si një dhi e vetmuar; dhe sërish cjapi ia ktheu me blegërimën e tij, gjithashtu, plot nota vetmie.

Lushja nuk pati pik dyshimi që cjapi kishte hyrë brenda plevicës, sepse dera ndodhej e hapur.

Befas, nisi të dëgjohej një muzikë, që, dalëngadalë, erdhi duke u rritur në nota të larta. Dikush po kalonte rrugës me një radio të ndezur në dorë. Nga kjo radio buronin notat e njëres nga ato pjesët muzikore të kompozuara enkas për ndonjë lojë teatrale, që rëndom dëgjohen pak para se të ndriçohet skena e të nisë shfaqja.

Era e lehtë që frynte nga jugu depërtonte përmes pullazit të plevicës, trazonte fijet e barit, duke përfutur kështu një zhurmim të butë e të pandërprerë, mu sikur po hapej perdja e një skene.

Lushja hodhi hapin dhe hyri në plevicë, domethënë në skenë.

Me të hyrë Lushja brenda plevicës muzika erdhi duke u shumuar, derisa ndaloi, sepse ai kalimtari me radion tashmë qe larguar, kurse skena u ndriçua nga hëna, që sapo doli nga një rë. Dhe nisi veprimi:

Sa hap e mbyll sytë cjapi ngrihet në dy këmbët e pasme, e mbërthen Lushen për beli dhe e rrëzon mbi bar!

Ai thotë:

*- Shshsht... Mos u ndje. Çfarë do bëjmë tani, ka ndodhur dje e pardje; do ndodhë nesër, pasnesër e përgjithmonë. Asht' zanati jonë. I duhet njerëzisë për të pjellë gjenerata. Ndryshe boshatiset pjata e shuhet gjallnimi. Thahen i joti dhe i imi...*

Ajo përpiqet t'i shpëtojë, ndërsa me zë të vogël pyet:

*- Më thuaj: çfarë je ti, kafshë apo njeri...?*

Ai:

*- Jam njeri, moj, çfarë tjetër?! Madje, njeri nga raca më e vjetër...*

Ajo:

*- Cili njeri?*

Ai i pëshpërit mu te veshi:

*- Jam Tushi, ma i ambli, buzë tambli, hirushi...*

Ajo ia largon kokën me duar:

*- Cili Tush, mos qofsh kurrkush?! Ne kemi shumë tusha, që o Zot, i hëngërt arusha...!*

Ai e puth në buzë, pastaj i pëshpërit sërish te veshi:

*- Jam Tush Tarrota. Të kam fituar me vota...*

Ajo përpiqet të ngrihet, ndërsa thotë:

*- Lermë se do bërtas... A të kam dhënë ndonjë shkas...?*

*As mos më nga, as nuk të ngas...*

Ai nuk e lë të ngrihet. I thotë:

- *Ti je vajzë e urtë e pa huq... Të premtoj një fustan neiloni të kuq.*

Ajo bën si një vajzë e zgjuar, do të tregojë, që nuk mund t'ia hedhin lehtë. Thotë:

- *Ç' thua kështu, more ujk shurdh?! Me një fustan të më futësh në kurth?!*

Ai nis t'i shkopsisë bluzën.

Ajo e kap për duarsh, bën sikur e kundërshton:

- *Hiqmu, se do e lëmë namin topa- topa....! Këtë turp se lan lumi, se nxë as gropa.*

Ai nis t'i premtojë më shumë:

- *Do të të blej në dyqan edhe një shall mëndafshi indian... Ta vendosësh në qafë si zonja e parë e vendit... Do bahesh tema e kuvendit anë e mbanë Bibollit.*

Ajo e tall:

- *Ti nuk ke brekë, jo më lekë... A nuk shikoj unë, që edhe pantallonat t'i ka falur dajë Shkëlzeni se iu grisën aty te veni?*

Ai nuk do t'ia dijë për fjalët e saj. I thotë:

- *Unë nuk prekem, moj thëllëzë fushe...! Zjarrin më fort ma përpushe...*

Ajo bën sikur nxehet:

- *Hiqmu, mos më prek, se ky turp lahet me dyfek! Unë jam vajzë sojlie, i kam ngjarë tezes Adivie, që u vesh si burrë e nuk u martua kurrë.*

Ai arsyeton me të butë:

- *Teze Adivia u plak shpejt nga vetmia. Sikur të kish pasur një burrë ngatë, do rronte edhe njëzetë vjet më gjatë...*

Ajo e shtyn me duar dhe përpiqet të ngrihet:

- *Ti s'je tjetër, veçse një horr... Largohu, o lugat, të raftë një plumb qorr mu në demonstratë të opozitës. Pastaj të ngrefshin në ndonjë qoshe lapidar e të pshurrshin katundarët që dalin në pazar!*

Ai vazhdon t'i premtojë ëmbël e butë:

- *Të thashë: do të të blej një fustan të hapur krejt përpara, të dukesh si këngëtarja e bukur Ema Skara. Kur ke mall të mirë me vete, bahesh sekretare, drejtoreshë, gazetare... Dhe po u solle si pëllumbeshë duke u zhveshë, fiton pikë, hy dhe në politikë. Do ngjallësh interes tek njerëzit më pozitivë të lartë në shoqëri... Tek ata që qesin dokrra e shesin kakërdhi...*

Ajo, medemek, nervozohet. E paralajmëron:

- *Mos mi shtrëngo cicat ashtu, o i pamarru.... Do thërras fort... Do vijë gjithë fisi... Dhe pa të gjykuar fare mexhelisi, do të të zhdëpin në dru... E ndoshta ta presin kokën e ta ngulin në një hu.*

Ai e mbërthen më fort duke e tërhequr pas vetes; e puth në buzë, në faqe, në gushë... I thotë:

- *Të premtoj, që do ta bëj me kujdes, ngadalë-ngadalë, në dash si këndes, në dash si kalë.*

Ajo:

- *Ua, ky! Unë... Nuk kam besim...*

Ai:

- *Po nuk pate besim, do bëhesh teslim pa shkak... Do të ta jap pak e nga pak...*

Ajo bën sërish sikur nervozohet:

- *Për krye t'nanës, ti do varur me tërkuzë në bri të hanës... Sepse kështu premtoni ju djemtë e Bibollit, pastaj*

*bëni hatanë më keq se në fushë të Torviollit. Suleni me uf e me of si kau në urov.*

Ai ngulmon me premtime:

*- Do të të blej edhe një palë geta...*

Tashmë ajo bëhet kurioze. Pyet me naivitet:

*- Si ato që veshin Zhaneta, Luljeta dhe Çiljeta?!*

Ai:

*- Do dukesh seks klasi; nuk do kesh të dytë; do të t'i ngulin sytë gjithë njerëzit e veseve, që nga punëtorët e deri tek pronarët e bizneseve.*

I fut duart shalëve dhe i ngre këmbët. Gishtat gjejnë llastikun e brekëve.

Ajo nuk reziston, por nis të ankohet:

*- Ti po më lëpin nga koka gjer te themra...! Po m'pushon zemra... Më thuaj, aman, ç'është kjo që po ban?!*

Ai:

*- Asht' dashni, moj, dashni... Asht' diçka që merr flakë...*

Ajo plotëson mendimin e tij:

*- Në fillim nga pak...*

Ai pason:

*- Pastaj vrundullon...*

Pason ajo:

*- Djeg e shkrumbon derisa digjet edhe vetë e bahet hi...*

Pason ai:

*- Dhe hirin e merr era përngahera... Zhduket e bahet fir...*

Pason ajo:

*- Dhe sërish ia beh nga hiçi, marros burra e gra, të vjetër e të ri...*

Pason ai:

- *Falet, shitet, baltoset, vritet...*

*Pason ajo:*

- *E nganjëherë nuk blihet as me flori...*

*Ai i lutet:*

- *Ma fal, pra, këtë dashni, trup për trup e sy për sy...*

*Ajo ngurron:*

- *Po sikur të na e marrin vesh? Do na bëjnë copa, përshesh... Ti e di si janë njerëzia: morali, urrejtja, zilia... Do na përzhënë nga shtëpia, do bëhemi serë e nuk do gjejmë derë ku të futemi, ndaj nuk kemi pse ngutemi...*

*Ai:*

- *Mjaft tani! Mos nxirr të kotat pretendime. Qysh sonte ti je gruaja ime. Nesër ia behim te hoxhë Rrahimi dhe bëjmë njëfarë bekimi. Shkojmë dhe në gjendjen civile... E kam pa hile.*

*Ajo heziton sërish, përpiqet të rezistojë. E ngacmon:*

- *Por unë... Nuk do desha të martohesha me një cjamin si ti, që blegërin e ban filozofi...*

*Ai:*

- *Nuk jam cjamin. Jam njeri serioz, por marr e jap si një cjamin varroz.*

*Ajo këndellet:*

- *Pa na thuaj njëherë, çfarë merr e jep? Se ti të lë pa mend përngaherë...*

*Ai:*

- *Jap gjithë botën për një gisht vend.*

*Ajo:*

- *Për krye t'nanës ti rren sa të dend...! E ban se rrena asht' në trend.*

*Ai:*



- *Nuk rrej, moj, nuk rrej... Më ler tani të të mbërthej si dua unë, se e pat kjo punë...*

Ajo:

- *Bëj bënë, që nuk rrën, se nuk dua ta marr mrena me rrena.*

Ai betohet:

- *Po rrejta sa fija e flokut, ma këputshin kokën si patokut!*

Ajo dorëzohet:

- *Liroma, pra, pak kamën... Liroma, ta bofsha njanën...!*

Ai

- *Ja, ta lirova... Tani, a je mirë? Dukesh pak e rreshkur në fytyrë, ke marrë një si ngjyrë....*

Ajo i hedh duart rreth qafës dhe nis ta puthë me afsh:

- *Oh! Mirë jam, mirë, por vdiqa për t' u qirë...*

Tashmë është ai që tërhiqet. I thotë:

- *Ngadalë, moj, ngadalë... Mos bëj si femër e përdalë; si Nuria, Lemja, Hasia, Merjemja...*

Ajo ia kërkon; do që t' ia kapë me dorë. Thotë:

- *Ku ma ke...? E dua si kalë... Ma jep shpejt, më shtifsh në dhë... Le të vëmë qysh tani kunorë.*

- *Beee, beee... - blegërin Tushi një si thirrje për ndihmë. Dhe fill pas kësaj, nxjerr një teshtimë.*

- *Shëndet... - thotë ajo. - Shikon?! Seksi të ban alergji kur e do pa rënë në ujdi...*

Ai e kundërshton me të njëjtën mënyrë, që e pati kundërshtuar ajo. I thotë:

- *Lërmë se do bërtas... A të kam dhënë ndonjë shkas?! As mos më nga, as nuk të ngas...*

Ajo merr rolin e tij. Nis t' i premtojë:

- *Do të qëndis për ty një shami të bukur, që ta mbash për t'u dukur...*

Ai bën si një djalë i zgjuar; do të tregojë, që nuk mund t'ia hedhin kollaj. Thotë:

- *Ç'thua kështu, moj sorkadhe mali?! Për një shami të jepet djali?!*

Ajo është pushtuar nga ethet e dashnisë. Ndërsa dridhet prej afshit seksual, nis t'i shkopsisë këmishën. E vështron drejt në sy. I thotë:

- *I shkreti ti, ç'do të të gjejë tani...!*

Ai bën sikur e pengon; medemek përpiqet të ngrihet, të çlirohet prej saj. Thotë:

- *Lëshomë, moj lanete...! Me kërcënime kërkon të më bësh për vete?!*

Ajo:

- *Do të bëhesh një dhëndër, që nuk është parë as në ëndërr në nahien tonë; do të të këndoje kanarina dhe bilbili... Vërsnikët do të thonë: shif, shif, çfarë nuse mori, kopili!*

Ai pyet me naivitet:

- *A do jem si Muji, si Halili...?*

Ajo shpjegon:

- *Kur të ecësh kokëllartë udhës katundit, t'i bie sh mes për mes hurdhës me ujë; të bësh bujë trimoshi edhe pse nuk je veçse një copë asoshi...*

Ndërkohë, ajo i ka zberthyer kopsat e këmishës e nis t'i puthë gjoksin.

Ai bën sikur alarmohet. Nxitimthi pyet:

- *Çfarë do kështu, me ah e me oh?! Thuaje ta dëgjoj se nuk frigohem.*

Ajo:

- *Dua të pallohem, të çlirohem, të shkërmoqem, të bahem teslim me zjarrin tënd, me zjarrin tim...*

Që nga hatllat e shtëpisë që braktisi Jusufi, dëgjohet klithmë-habia e një bufi: u-auuu, u-auuu, u-auuu...

Ai:

- *Po sikur t'na e marrë vesh dynjaja, baba, halla, tezja, daja...? Do plasi belaja, do bëhet hataja...*

Ajo ngulmon në të sajën:

- *Le ta marrë vesh gjithë bota. Që sonte, t'i je boshti; unë jam rrota e mullirit ku bluhet bereqeti; Ti je Hasani i Beqirit, Ismeti i Shaqirit, Burhani, Bexheti... Je mashkulli im; je kënaqësia; je burimi ku do rrjedhin gëzime. Je kafsha e kafshës time...*

Ia shtrëngon njëherë fort me dorë, pastaj thotë:

- *E dua tani... Ma..., ma..., ma.... Oh, marshalla!*

Ai e qorton me zë të ëmbël:

- *Mos ma shtrëngo shumë, se po më kthehet gjaku në shkumë...*

Ajo bëhet nervoze nga padurimi:

- *Nuk po ta shtrëngo, o kokëftua... Po të marr njëherë masën, sepse do bahem grua. Ta di sa e ke dhe ta dish sa e dua.*

- *Ma merr, pra, masën...*, - Dorëzohet Tush jarani. Nga fyti i del një si tingull i hollë kënaqësie breshkani.

Dhe bufi sërish atje jashtë, tashmë mbi hurin e mullarit me kashtë: u-auuu, u-auuu, u-auuu...

Ajo thotë e kënaqur:

- *E paske në masën që dua unë... Ky po, ban punë, jo ai që ka Qamili, si sqep i hollë bilbili...*

Dhe e terezit mes shalëve të saj, ku rrëshqet e futet lehtë si në vaj.

Befas, Tushi nis të ankohej:

- *Më luajti vendit zemra... Më duket se më ra poshtë, te themra...*

Ajo pyet me tallandisje:

- *Ç'të gjeti, o shoku? Mos bëre karambol me ndonjë karrocë uloku?*

Ai është shumë i tronditur. Thotë:

- *Më zhgënjeve... Zembrën e ngratë në kryq ma mbërtheve!*

Ajo bën sikur habitet:

- *Ç'thua kështu, more i uruar?*

Ai shpërthen fort i dëshpëruar:

- *Të gjeta të shpuar...! Më thuaj drejt, kush të ka palluar?*

Ajo:

- *Uaaa, ky! Tani po na flet si shejtan me një bri... Të betohem në krye t'nanës, ka ndodhur veç njëherë nën hije të thanës.*

Ai kërkon të dijë:

- *Më rrëfe shpejt: si ndodhi ajo hata që dëshirën ma vodhi e shpirtin ma përdrodhi?*

Ajo bie në mendime, kujton kohën e shkuar dhe nis të rrëfejë:

- *Qe verë... Isha e lodhur nga mërzia, vetmia dhe vapa. Uji i kanalit zhurmonte nga prapa. Ndërsa bëja punë dore, para meje në hamullore, shikoja kalin e Mark Patit, teksa ia rraste pelës së Bec Ferhatit. Nuk di pse mu trazua shpirti, m'u mpak fuqia, s'më mbanin këmbët... Më kaploi*

*dëshira ta merrja edhe unë si pela, gjer te kërthiza, gjer te dhëmbët... Ashtu siç qeshë e ulur në bisht, bëra një selfie me gisht. Dhe nisa të ndizem, të digjem si pisha nga flaka, gjersa u prisha e u mpaka; u bëra prush, por nderin ama, e ruajta, s'ma mori kush.*

Ai:

*- Do të ta pres atë gisht, që më bëri xheloz.*

Ajo:

*- Aman jo, se e lëpi kur fshi tenxheren me kos.*

E mbërthen me pëllëmbët pas mollaqeve dhe e tërheq fort nga vetja...

Pikërisht ato çaste, një gomar palli andej nga lagjja e Tarrotëve; pastaj u dëgjua hingëllima e një pele; karabashi i Brahimit, nisi të lehte më fort; pas tij filluan njëherësh gjithë qentë anë e mbanë Bibollit; pulat kakarisnin koteceve; macet mjaullinin; blegërinin delet e dhitë; cjeptë dhe deshtë rrihnin tokën me këmbë dhe shfrynin hundët me gjuhën jashtë; dy yje u fikën dhe ranë diku andej nga kënetat e Gjikollit; u dogjën bukët që piqeshin në furrat; tenxheret me qumësht e gjellë që vlonin mbi zjarre grafluan dhe u derdhën; hëna u bë me turp si një çupë e marrshme dhe u fsheh pas një reje; qielli u nxi, u shfaqën vetëtima; shpërthyen bubullima, toka nisi të lëkundej, kërkëllonin trarët e tavanëve; plakat nisën të luteshin, ca bënin kryqin e ca binin në shajdet; fëmijët qanin; burrat dolën oborreve; gratë nxorën kokën dritareve; të gjithë pyesnin njëri-tjetrin, ngase donin të dinin çfarë po ndodhte...

Qe një llazurë aq e madhe, a thua se po bëhej kiameti.

Kryeplaku Maliq Burnazi, doli në dritaren e kullës së tij trekatëshe e thirri me sa i hante zëri:

- Çfarë po ndodh, kështu, he burra malsie? - Dhe bam, bam, bam, gjuajti tre herë me pushkë kah qielli.

Dy lakuriq nate ranë coftë në tokë.

Daci i Zav Tarrotës vrapoi nëpër terr dhe kapi njërin. Tjetrin e kapi macja e Brahim Çadërbashit.

- A mos ndoshta ndonjë haram i ktheu fjalën babës së tij, bre? - pyeti Oleg Kurbini i mëhallës së poshtme.

- Ndonjë grua ka dalë rrugës së pazarit me cica e shalë jashtë, sepse po shikoj, që hëna është fshehur nga turpi pas një reje, - tha Fazil Krosi.

- Dikush në Biboll ka shkelë bukën, - tha furrëtari Tush Llatini.

- Diçka po ndodh, por nuk dimë çfarë..., - ia pat me zë të lartë, që nga oborri i shtëpisë së tij tekniku i ndërimit Marin Dermeku.

- Tërmet, o millet, tërmet i madh...! - briti Mazllum Qederi.

- I erdhi fundi botës, burra...! - tha kryeplaku. - Bëhuni gati të mos marrohem, por të vdesim si na ka hije.

- Ku-kuuu për në...! - vajtoi një zë i çjerrë.

- O bibollas të ngratë! - thirri së fundi fallxhorja Leze Delfi, menjëherë pasi kishte parë filxhanin. - Mbajeni veten, sepse nuk po vjen fundi i botës.

- Po ç'është, pra, moj Leze, a s'na thua?

- Filxhani më thotë, që diku në Biboll ka rënë një zjarr dashnie e dy të rinj po digjen, - tha Lezja.

- Dilni burra t'i gjejmë ku janë e t'i shpëtojmë!

- Telefononi të vijë zjarrfikësja.

- Dilni, dilni...!

Dhe u derdhën me yrish të gjithë jashtë. Nisën të

kërkonin duke mbajtur në dorë kush një fener, kush ndonjë elektrik dore e ca të tjerë batanije, gjyma e kova me uji.

- Të mbulohehi me bar se do na gjejnë, - tha Lushja e trembur pas gjithë kësaj zallamahie.

- Dreqi ta hajë! - ia pat Tushi. - Ç'është gjithë kjo gurgulë që bëhet anë e mbanë Bibollit?! Kurrë nuk e kisha mendu se dashnia sillka një kataklizmë kaq të madhe.

- Mos ndoshta, nuk është dashni? - pyeti Lushja me naivitet. - Sepse po hutohet krejt mileti...

- Mos është ndonjë gjë me spec?!

- Dashni, moj është, dashni. Ç'të jetë tjetër? Kot po e bëjnë kiamet, - tha Tushi.

- A është dashni si e Ramiut me Çelietën, që e ka përshkru ai shkrimtari i madh Shefki Spiri? - pyeti ajo.

- Njësoj është, por me një ndryshim të vogël: ngase nuk do vdesim, dashninë tonë nuk ka për ta shkrujtë kurkush.

- Ma mirë k'shtu, - tha Lushja, - sepse po na e shkrujtën, na bënë serë në gjithë miletin.

Shpejt e shpejt ata hapën një tunel të thellë brenda barit, u rrasën aty dhe e bllokuan grykën e tunelit me një duaj kashte. Lanë vetëm një vrimë të vogël sa për të marrë frymë e ia filluan sërish nga e para.

- Ma jep ngadalë, pa zhurmë, siç ia jep baba im nanës, kur flemë të gjithë bashkë në një dhomë, - i tha ajo. - Dhe mbaje një vesh pipëz jashtë se mos vijnë e na gjejnë.

Të tjerat nuk shkruhen, sepse qenë vetëm rënkime dhe pasthirrma.

Në mëngjes, zallamahia jashtë qe fashitur. Gjithçka kishte rënë në fashë. Dy rreze dielli depërtonin nga të çarat e plevicës dhe lanin me dritë fytyrat e tyre.

- Sa mirë e luajte lojën e dashnisë! - i tha Lushja.- Pata frikë se do të harronim tekstin, por shkoi shumë-shumë mirë.

- Po, vërtet, mirë shkoi, - e mbështeti Tushi.

- Loja e dashnisë ka tekst të thjeshtë, - tha ajo. Dhe pyeti: - Nuk është kështu?

- Ashtu është, - e mbështeti ai.

- Herë tjetër do të provojmë ta luajmë pa tekst fare.

- E provojmë, pse jo, - tha ai.

- Them se do të jetë më e lehtë, sepse nganjëherë ndodh që përpiqesh të mbash mend tekstin dhe, ose frenohet veprimi, ose ngatërron mizanskenat.

- Ashtu është. Xim budallai, ta zëmë, e bën pa tekst fare.

- Vërtet?

- Po. Edhe Qenan Qima, ai turiderrri, pa tekst e bën. E shumta, mund të nxjerrë ndonjë hungurimë. Në Biboll ka shumë që e bëjnë pa tekst fare.



- Po ish sekretari i partisë, hoxhë Rrahimi?

- Edhe hoxhë Rrahimi e bën pa tekst. Thjesht thotë një “bismilah” në fillim kur hapet perdja e nis veprimi. Kafshët, po ashtu, e bëjnë pa tekst, sepse nuk dinë të flasin. Gjithsesi, unë mendoj që teksti i jep tharm lojës, krijon situatë...

- Të të them diçka, nëse nuk të ngelet qejfi?- pyeti Lushja.

- Thuaje, thuaje... Pa problem.

- Në fillim të lojës së dashnisë ti ishe më energjik, më këmbëngulës... - tha ajo. - Pastaj andej nga fundi sikur...

- Ke të drejtë. Andej nga fundi u ngatërrova njëherë, kur thash se të gjeta të shpuar...- u kujtua Tushi. - Kjo qe gabim, por nuk di si më doli.

- Pra, e pranon edhe vetë, që nuk duhej thënë ajo që the? Kështu?

- Ndoshta nuk duhej thënë... - u mëdysh ai. - Mbase ai çast duhej kaluar me një pauzë të shkurtër; me një pauzë gjithë temp të brendshëm, që të tregonte se isha skandalizuar e zhgënjyer aq shumë, sa më iku goja... Pra, të mos flisja fare.

- Jo, jo, - e kundërshtoi Lushja. - Ashtu duhej, por vetëm se harrova të shtojë një frazë që duhej të ishte “vdeksha unë për ty”. Kam dëgjuar që të gjithë djemtë e thonë këtë.

- Po, vërtet e thonë, - tha Tushi. Dhe pyeti: - A mos, ndoshta, harrova pa thënë ndonjë gjë tjetër me rëndësi? Nëse po, ma thuaj e dashur, sepse nuk ta marr për keq.

Ajo u mendua një çast e tha:

- Më duket se nuk i bërë të gjitha premtimet... A më premtove që do të bëhesh copa-copa për të më bërë të

lumtur gjithë jetën? Sepse, zakonisht, edhe kjo thuhet në raste të tilla.

- Jo, këtë vërtet nuk e thashë. Nuk e thashë vetë, e lashë, sepse m'u duk shumë e rëndë.

- S'ka gjë... , tha ajo. - Në përgjithësi loja shkoi mirë. Nuk është kështu?

- Mirë shkoi, - ia ktheu Tushi dhe i kafshoi lehtë majën e veshit.

Ajo u rrënoqeth. E preku me gishtin tregues në mjekër dhe pyeti:

- Mos ndoshta edhe unë harrova ndonjë fjalë pa thënë gjatë lojës së dashnisë? Mos ndoshta, bëra ndonjë gabim në tekst?

Ai u mendua një copë herë, pastaj tha:

- Kur më the *“kokëftua”* sikur ra pak tek unë tempi i brendshëm. Ndoshta duhej gjetur një krahasim tjetër...

- Ke të drejtë, - tha Lushja duke qeshur. - Në fakt, kisha në mend të të thërrisja *“kokëkungull”*, por nuk më dilte me rimë. Më thuaj, a pati ndonjë gjë tjetër, që u duk sikur stonoi?

- Jo, nuk pati, - tha ai. - Gjithçka ishte në rregull. Vetëm një frazë andej nga fundi nuk e kuptova, kur the: *“Do të bësh bujë trimoshi edhe pse nuk je veçse një copë asoshi...”* Nuk e mora vesh çfarë kishe në mendje.

- Oh, i dashur! - ia bëri Lushja. - Ajo që thjesht një lajthitje; lajthitje nga ato që pëson një femër në situata të tilla, kur nis e flet mbarë e prapë... Të kërkoj ndjesë nëse të kam lënduar.

- Jo, nuk ka problem, - tha ai. - Vërtet shkoi shumë-shumë mirë. Gjynah të qahemi.

- Më thuaj: mos ndoshta, rrëshqita e dola ndonjë çast nga linja e subjektit?- pyeti sërish ajo.

- Jo, çne? As mos e ço në mend një gjë të tillë. Gjatë gjithë kohës ke qenë në linjë, nga fillimi në fund... Ishe e vetëdijshme për çka bëje dhe shumë e vendosur në qëllimin që kishe.

- A isha e besueshme në masën e duhur apo dukej sikur shtiresha?

- Ç' thua, moj?! Ishe mjaft e besueshme, - tha ai. - Me përjashtim të një rasti fare të papërfillshëm. Ka qenë momenti kur u betove në krye të nanës e the se e kishe humbur virgjërinë gjatë një selfie që kishe bërë me gisht nën hije të thanës.

Ajo e kundërshtoi:

- Jo, jo... Në këtë pikë nuk jam dakord me ty. Unë mendoj se ato çaste isha aq e vërtetë, sa për pak e besova edhe vetë...

- Ndoshta ke të drejtë, por mua sepse m'u duk sikur...

Ajo:

- Pastaj... Uaaa! çfarë mrekullie kur arrita atë pikën kulmore...!

Ai:

- Lëre, lëre...

- Dua të gjej një fjalë që ta përshkruaj, por nuk e gjej dot, - tha ajo.

- Sikur të mund ta përshkruanin me ndonjë fjalë, nuk do ishte gjë, - tha Tushi.

Ajo mori frymë thellë, iu rras edhe më tepër ngjit për trupit dhe pyeti:

- Sikur cjeptë të flisnin, me çfarë fjalësh mendon ti do ta shprehnin dashninë ndaj dhive?

- Me fjalët që të thashë unë, - tha krejt seriozisht ai. - Por më mirë që nuk flasin, sepse kësisoj, nuk kanë mundësi të gënjejnë.

- Mos do të thuash që më ke gënjyer me ato që the?

Ai u mendua një copë herë me sytë e ngulur në një qoshe ku një merimangë thurte me nge rretjen e saj.

- Në një farë mënyre po e në një farë mënyre jo, - tha ai.

- Si ta marr këtë përgjigje?

- Ne e tërhoqëm njëri-tjetrin me blegërima mu si kafshët, prandaj mes nesh, përveç fjalëve që thamë, gjithçka tjetër është e vërtetë.

- Jo, jo... Nuk është mirë kështu, - u ankua Lushja. - Unë dua të paktën për atë shallin indian, që më premtove, ta mbash fjalën. Vetëm për shallin, jo për tjerat.

- Nuk ka problem, - tha Tushi. - Do e mbaj fjalën. Një shall është ai.

Tushi e dërgoi Lushen në shtëpinë e tij, por i ati, Zav Tarrota, ky burrë plak me shumë namuz, që kish qenë tre herë si haxhi në Qabe, nuk i la të hynin brenda.

- Jashtë të rrishë, ëdëpsëz! - i tha ai të birit. - Na e vare marren në derë të madhe!

- Unë e dua Lushen, - tha Tushi. - Ku e shikon ti babë turpin tonë?

- Nuk shikoj turpin tuaj, - tha plaku. - Shikoj turpin me të cilin u mvesh bota.

Dhe ua mbylli portën mu te hunda.

- Po tani, çfarë do të bëjmë? - pyeti Lushja.

- Ç'të bëjmë? - pyeti edhe ai.

- A më premtove gjatë lojës që do të bëhesha gruaja jote?

- Të premtova, posi, - tha Tushi. - Por loja e dashnisë ka pengesa, sakrifica... Do të shkojmë të jetojmë përkohësisht te plevica.

- Te plevica?!- u habit Lushja.

- Po, te plevica. - tha ai.

- Te ajo e barit?!

- Te ajo e barit, e jonxhës dhe e kashtës.

- Te ajo e thurura me thupra?!
- Me thupra, pa thupra...
- Te ajo ku nisi loja e dashnisë?!
- Një minutë... Qetësohu. Duhet të flasim normalisht...
- Te ajo ku flenë qentë e Bibollit?!
- Lushe! Unë nuk....
- Aty ku nuk kemi as ku gatuajmë, as ku lahemi dhe

as ku...?!

- Sa të gjejmë një zgjidhje tjetër, moj zemër...
  - Aty ku hedhin valle minjtë e thurin rrjeta merimangat?!
- Ajo bëri të largohej, por Tushi e mbërtheu për krahu, e ktheu nga vetja, ia mori kokën në duar e i tha:

- Më vështro drejt në sy...
- Nuk dua, - tha ajo.
- Vështromë, thashë..., - ngulmoi ai.

Ajo e pa njëherë, por e hoqi vështrimin duke kthyer kokën e inatosur në një anë.

- Më vështro gjatë, - tha Tushi. - Qetësohu dhe më vështro. Përpiqu ta futësh vështrimin thellë, shumë thellë syve të mi. Pastaj më thuaj, çfarë shikove.

Lushja ia nguli vështrimin kokërr ndër sy dhe e mbajti pa ia shqitur për gjatë kohë. Atëherë, ndodhi mrekullia: u shfaq një skenë, që vetëm ndonjë shkrimtar i famshëm si Aush Loshi mund ta përshkruajë.

Në sytë e Tushit retina u hap në mes dhe dy pjesët e saj lëvizën anash mu si perdet e një skene! Ajo e pa veten teksa qëndronte bashkë me Tushin të ulur kundruall nën hijen e një qershie dhe hanin frutat e saj të pjekura. Këto fruta qershie ata i merrnin nga një shportë; ndërsa e vështronin njëri-tjetrin me shumë dashuri.

Tushi kishte një trup të gjatë prej atleti dhe qe veshur bukur. Fytyrën vezake, të kthjellët në dukje dhe ballin e lartë. Flokët kaçurrel i shkëlqenin nga feksi i rrezeve të diellit, që depërtonin mes degëve; kurse kraharorin e kishte të gjerë. Sytë, të zinj, të mëdhenj, me qepallat e gjata e të lakuara me majë përpjetë. Gjatë gjithë kohës Tushi buzëqeshte. Dhe kur buzëqeshte, i shkëlqenin dhëmbët e bardhë si bora. Dukej mu sikur dielli kur lind në një ditë të bukur pranvere. Prej trupit të tij përhapej një aromë e mirë, e pakrahasueshme me asnjë lloj parfumi. Ndërsa merrnin qershi, herë njëri, herë tjetri, në fund ngeli në shportë vetëm një kokërr. Sipas radhës, ajo kokërr i takonte Tushit ta hante. Por Tushi nuk e mori, ngase donte që ta merrte e ta hante Lushja. Kësisoj, nuk e hëngri as njëri, as tjetri. Për çudi, kokrra e mbetur në pjatë nisi të hapej dhe që aty doli një fidan trëndafili, që u rrit ngadalë mu nën sytë e tyre, derisa u shfaq një gonxhe në prag të shpërthimit; por nuk shpërtheu për të hapur petalet. Ishte një gonxhe e rumbullt e si me majë, që Lushja e vështronte mirakandas. Nga maja e kësaj gonxheje të paçelur bulëzonte vesë. Tushi e mori gonxhen e trëndafilin dhe ia dha Lushes, e cila, pasi i thithi me etje pikat e rumbullta të vesës me buzët e saj të tulta, e fshehu në gji që të mos ia shikonte bota.

Ato çaste retina e syve të Tushit që ishte hapur si një perde, u mbyll sërish dhe Lushja e gjeti veten para një Tushi krejt tjetër.

Ky Tushi tjetër, rrinte para saj si hu gardhi; ndërsa e vështronte mu si një budalla. Kishte një trup mesatar krejt të zakonshëm dhe vinte paksa i kërrusur në shpatulla. Dukej i cokatun nga puna dhe hallet e shumta.

Ishte veshur me një xhakëtë të përdorur, të blerë te firma “Gabi”, që ishte pahitur me zbokth te supet. Pantallonat ia kishte falur dajë Shkëlzeni, të grisura dhe të arnuara aty te veni. Fytyra e tij qe disi e turbullt e pa shprehje. Lëkura e fytyrës i qe rrahur nga dielli, era dhe të ftohti i Bibollit, ndaj dukej si gliskër hardhuce. Ballin e kishte të ngushtë, mbi të cilin vareshin poshtë ca qime flokësh të lyrosura, të ngjitura për njëra-tjetrës. Në flokë, tek-tuk, i qenë ngjitur edhe fije bari dhe kashte që nga plevica. Veshët e mëdhenj si veshët e të atit, Zavit. Tushi tjetër dukej sikur nuk kishte fare kraharor, sepse xhaketa që mbante veshur i rrinte si e varur në një gozhdë. Për këpucë ai mbante një palë rregzina katër numra më të mëdha nga ç’ duheshin në të vërtetë. Sytë i kishte të lodhur, qerpikët si të fryrë e të rënduar nga pagjumësia e natës së shkuar, ndaj i rrinin pothuajse të mbyllur. Hundën si një llullë e fikur, e pashkundur nga pluhuri i duhanit. I vinte era djersë e thartuar, një erë pak a shumë si erë qeni. As nuk buzëqeshte, as nuk fliste; rrinte si i trembur.

Lushja nuk dinte, cili nga këta të dy ishte Tushi i vërtetë. Përse e kishte detyruar ta vështronte në sy? Kish dashur ta kobiste, ta magjepste me ndonjë marifet prestigjatorësh? Ç’është e vërteta, ai Tushi, që ajo pa si në ëndërr i pëlqeu, por çfarë i duhej asaj, kur zgjati vetëm nja tridhjetë sekonda? Pastaj, dukej ashiqare, që Tushi i atyre çasteve ishte i këndshëm vetëm për t’u parë, për të ngrënë bashkë me të qershi nën hije, për t’u puthur e ndoshta mund t’i duhej kur ta rrokte gjakimi për burrë, që është thjesht një dëshirë pushtimi... Por, a ja vlente vetëm kaq? Asaj i duhej një Tush rrapatash, që të dinte t’ia numëronte gjithë tejtaz



e pejzat petkut të jetës; dhe punëve t'u dilte zot si një burrë i vërtetë...

- Tani, më thuaj, çfarë pe? - e ndërmendi Tushi.

- Pashë një rrenë të bukur; një rrenë brenda një të vërtete të rëndomtë, - tha ajo.

I ktheu shpinën dhe u largua me vrap.

Ai i thirri nga prapa që të ndalonte, por Lushja u bë erë.

Tushi u mërzit shumë prej ndarjes me Lushen. Nuk i rrihej në një vend. Sapo ulej, ngrihej sërish. Bënte veprime që, në të vërtetë, nuk kishin ndonjë qëllim. Hynte e dilte nga shtëpia pa i folur as të ëmës, as të atit. Netëve e bënte gjumin copa-copa dhe, kur flinte, blegërinte në jermi; pastaj zgjohej i trembur nga ëndrrat e këqija. Nuk hante rregullisht, sepse i iku edhe oreksi.

E ëma, Minja, u përpoq ta qetësonte. Nuk ishte bërë hataja. Bibolli kishte vajza plot; do të gjendej një tjetër, madje më e mirë se Lushja e Brahim Çadërbashit.

- Është bishtpërdredhur; i ka ngjarë të ëmës, Lulushes, prandaj mos të të bëhet hiç vonë, - i tha ajo të birit. - Është rritur me të mira ajo, nuk bën për derën e një varfanjaku.

I ati i Tushit, Zavi, qe bërë i heshtur. Ai dukej sikur bluante në kokë mendime pirate, sepse shtrëngonte buzët e kafshonte gjuhën si të kishte frikë se mos i shpëtonte ndonjë fjalë. Kishte arsye të fortë për ta penguar këtë lidhje, pasi shumë vite më parë ishte bërë pré e një ndodhie të pakëndshme.

Kishte ndodhur kur po kthehej nga puna për të shkuar në shtëpi. Nga mërzia e thellë pati pirë e qe dehur, ndaj

kishte ngatërruar rrugë. Në vend që të futej në shtëpinë e tij, qe futur në shtëpinë e Brahim Çadërbashit. Nuk pati qenë faji i tij, pasi në atë kohën e regjimit komunist, çdo gjë ngjante me njëra-tjetrën. Rrugët qenë njësoj, shtëpitë gjithashtu, njësoj; njerëzit visheshin, qetheshin, mendonin dhe flisnin po njësoj; sendet që përdoreshin, krejt të njëjlojta.

Pra, pati ndodhur që Zavi u fut gabimisht në shtëpinë e Brahimit, i cili atë natë, nuk ndodhej aty. Energjia elektrike qe ndërprerë dhe ai e gjeti krevatin me të prekur, pasi aty brenda ishte errësirë e plotë. Qe zhveshur ngadalë dhe qe futur në krevat, ku ai e dinte se flinte e shoqja. Por në vend të të shoqes, ndodhi që Zavi gjeti Lulushen e Brahimit. Kur e kuptoi ku gjendej, deshi të ngrihej shpejt e të dilte prej aty, por Lulushja e mbërtheu dhe nuk e la. Dhe s'kishte si ta linte. Kishte kapur një brac duke vjedhur kopshtin e saj; atë kopësht që i shoqi e linte të thahej për ujë, ngase ujiste kopshtiet e grave të botës. Këtë histori e dinë tashmë gjithë bibollasit.

Duke vrarë vazhdimisht mendjen, Tushi nxori konkluzionin se loja e dashnisë me Lushen nuk kishte mbaruar ende. Ai i dha karar që ta vazhdonte më tej lojën. Kështu, ditën tjetër, ai vajti dhe u ngul para shtëpisë së Lushes, ku blegëriu nga mëngjesi e gjer në darkë; me intervale të shkurtra, kuptohet, duke bërë edhe ndonjë pushim kur lodhej. Pastaj, një herë, ai qe i detyruar t'i shkëpuste blegërimat, ngase iu desh të gjente një qoshe për të bërë shurrën, ku u bë me turp, sepse ndodhi që e pa gjyshja e Marin Dermekut. Gjyshja e Marinit, kishte dalë të mblidhte hithra për të bërë një petë.

- Mos pshurr në hithra, or çun, sepse do të të kapë djalli për koqesh! - e qortoi plaka.

Një herë tjetër, andej nga dreka, ai vajti tek lokali i Fazil Krosit, i cili, ndodhet tek sheshi i Bibollit dhe quhet “*Potiri*”.

Te “*Potiri*” ai hëngri dy biftekë dhe piu katër shishe me birrë.

Edhe pse blegërinte, Tushi njeri ishte dhe, si i tillë, i duhej patjetër të përmbushte ca nevoja të domosdoshme, sidomos, të mbushte dhe zbrazte barkun. Veç kësaj, kur kthehej sërish para shtëpisë së Lushes, ai ndjehej më i çlodhur dhe niste të blegërinte pa ndonjë sforcim të madh.

“*Potiri*” qe një lokal aq i bukur, sa hyje aty brenda me mend dhe dilje pa mend!

Në muret brenda lokalit Fazili kishte ngjitur me brumë foto femrash të bukura, bionde dhe brune, të veshura dhe të zhveshura, të urta dhe nazelie, të qeshura dhe serioze! Bah, çfarë femrash! Femra të të gjitha ngjyrave e racave, që ai i kishte grisur me shumë xhentilesë nga revistat e modës. Dhe veç t’i shikoje në çfarë pozicionesh kishin dalë ato femra në fotografi! Ua shëtisje me sy të gjitha viset.

Fazili ishte treguar artist me shije të madhe në zbukurimin e lokalit. Sepse këto foto, ca të rralla e ca jo fort të rralla, përveçse joshnin klientët duke i bërë të blegërinin dhe i jepnin bukuri e lezet “*Potirit*“, ata mbulonin edhe drangat e mëdha të zhulit nëpër mure, vrimat e gozhdëve të shkulura, si dhe pllangat ku kishte rënë suvaja.

Ajo që e plotësonte ende më mirë pamjen e mureve aty brenda, duke krijuar një harmoni të ngërthyer në mënyrë krejt të natyrshme, ishte dyshemeja, mbi të cilën, ai kishte

derdhur sërish një pjesë të madhe të talentit të tij. Ta kishte ënda t'i ngulje sytë e të mos i shqisje fare nga ai mozaik i bërë nga mendja gjeniale dhe duart punëtore të Fazilit.

Dyshemeja ishte shtruar me pllaka të të gjitha llojeve, përmasave dhe ngjyrave: pllaka qeramike: të plota, çerekëshe, gjysma dhe treçerekëshe; pllaka guri e mermeri: të mëdha, pak më të vogla se të mëdhatë, jo dhe aq të mëdha, të mesme, të vogla, akoma më të vogla dhe të vogla fare. Të gjitha të thyera spontanisht me lezet e të vendosura me kombinime të vështira, të studiuara mirë e me një radhë pune që të habiste.

Kishte në atë dysheme pllaka betoni: me forma të rregullta dhe të parregullta; disa qenë rrumbullake si petullat e disa në formë paralelopipedi, si kallëp revanie, në dukje të thjeshta, por që plotësonin edhe ato diçka në atë panoramë të përgjithshme; kishte edhe pllaka plastike: të shtrenjta dhe të lira, me vizatime e figura përsipër, por edhe me ngjyra: të zeza, shumë të zeza, të zeza fare-fare dhe sterrë të zeza; mes të zezave gjendeshin të bardha, por kishte edhe të zbërdhulëta; mes të bardhave kishte të kuqe, të kuqe qershie dhe të kuqe molle; mes të kuqes kishte jeshile, jeshile si e jonxhës dhe jeshile si e sallatës; mes jeshiles, gjendeshin blu e fortë dhe blu e butë; mes blusë Fazili kishte rrasur ato në ngjyrë bizele, pastaj ngjyrë lakre, ngjyrë kastravec të njomë, por edhe nga ai i lënë për farë; pastaj vinin pllakat me ngjyrat e verdha dhe të verdhemta; vende-vende të mbivendosura njëra mbi tjetrën për të arritur trashësinë e të tjerave, por që Fazili i kishte rregulluar plot merak duke u futur me çekiç edhe nga një gozhdë ose thumb të trashë përsipër, që të mos lëvizin.

Edhe nëse ndonjëra lëvizte, kjo që një lëvizje e llogaritur gjithë kujdes nga ana e tij për të lëshuar ndonjë tingull të bukur e për t'i dhënë gjallëri ambientit.

Dhe mos ua vini veshin atyre gojëve të këqija, që flasin e thonë që Fazili i mblodhi në një piring të madh plehrash pllakat me të cilat shtroi dyshtemenë e “*Potirit*“, sepse kjo nuk është e vërtetë. Absolutisht, jo!

Një tjetër kryevepër e rrallë ishte banaku. Gjithë lokalet e botës t'i vizitoni nuk do të gjeni një banak të tillë! Ky banak kishte edhe themel. E merrni me mend çdo të thotë kjo? Një banak me themel të thellë e të qëndrueshëm! Fazili hapi njëherë themelin, pastaj ndërtoi për banak një mur të trashë me gur të mëdhenj duke futur edhe haliç mes gurëve. Me ta përfunduar, ai e këqyri me kujdes dhe i pëlqeu shumë, por, nga frika se mos ia merrnin mësysh, tha: “Eh, më duket se i dhjeva në të!”

Sipër banakut, ai vendosi një kompensatë të trashë, të cilën e pati mbuluar me dy lëkurë lope, të thara e të rruara me brisk, që binin një erë fort të këndshme.

Dhe, o Zot! çfarë pastërtie gjeje aty brenda!

Me pastrimin e “*Potirit*“, besoni apo jo, merreshin ca qenie fare të vogla, të cilat punonin pa u lodhur. Këto krijesa njihen në Biboll me emrin *furrëtare* ose *buburrecë buke*, por Fazili i quante ato *buba kuzhine*.

*Bubat* punonin turn i tretë, vetëm në errësirë, duke lëpirë çdo lëng të derdhur e duke mbledhur çdo thërrime mbetjesh nga ushqimet e ditës.

Sapo ndizej drita, *bubat* largoheshin si me komandë, futeshin nëpër vrima e plasa, duke marrë me vete thërrmijat e fundit të ushqimeve e duke lënë një ambient që shkëlqente

nga pastërtia. Nëse ndonjëri nga këto *buba* dilte për punë ditën, Fazili e ndëshkon me vdekje në një mënyrë mjaft mizore. Sepse “*Potiri*” nuk funksiononte vetëm sipas rregullave, por edhe sipas ligjeve.

Ky qe, pra, “*Potiri*” i Fazilit, lokal me nam në gjithë Bibollin.

Tushi bëri në lokal edhe nja katër lojë domino me xhipin e Bibollit, Malikun, me të cilin dolën jek e jek.

Brenda “*Potirit*“ bëhej edhe politikë, sidomos bëhej shumë politikë e jashtme, ku rriheshin çështje botërore mjaft të rëndësishme.

Në një tavolinë, që ndodhej diku në një qoshe të mugët e që mbahej vetëm me tre këmbë, qenë ulur dhe po bisedonin katër burra. Kësaj tavoline ia pati shkepur këmbën vetë Fazili kur zhdëpi një herë në dru dashnorin e gruas, pse ky i fundit, ditën e Shën Valentinit, guxoi dhe i dërgoi një karafil si dhuratë. Herë-herë, katër burrat, vrisnin edhe ndonjë mizë, që ndalonte në tavolinë.

Diku pranë tyre qëndronte në këmbë i kthyer më fytyrë nga muri i sëmuri mendor Xim Pinci. Që të mos bezdiste klientët duke i pyetur siç e kish zakon për datën dhe vitin e saktë kur do të përmysej bota, Fazili i kishte vënë si detyrë që të numëronte kot së koti: një, dy, tre..., njëzetë..., shtatëdhjetë..., pesëqind... e kështu me radhë. Kur hyri Tushi në lokal, Xim Pinci kishte numëruar deri në katërmbëdhjetëmijë e ca, duke u ngatërruar vetëm shtatë herë. Sa herë ngatërrohej, ai niste sërish nga e para.



Tushi nuk i shikonte fare katër burrat, pasi u kishte kthyer shpinën dhe, siç e thamë, në atë qoshe nuk kishte dritë të mjaftueshme. Por, nga bisedat që ata bënë, ai kuptoi se qenë bërë bashkë katër diplomatë në rang ambasadorësh.

Ajo që e habiti Tushin ishte fakti që të gjithë këta ambasadorë e flisnin gjuhën shqipe me dialektin e Bibollit.

Përskaj tingujve të fjalëve të mbushura me kotësi, goditjeve që ata u jepnin mizave që ndalonin në tryezë, kërcitjeve të gurëve të dominosë dhe zhurmës që bënte ekspresi i kafesë, kalonte *koha*, ajo që torturonte të sëmurin Xim Pinci, kjo kalorëse e rrëgjuar nga luftërat e vazhdueshme e që i kish ngordhur kali nga vapa e madhe.

Xim Pinci herë pas here linte numërimin dhe, pasi përkulte pak trupin, lidhte duart prapa shpinës, merrte atë qëndrimin e tij prej hutaqi dhe i bënte pyetje kohës: “A ka mundësi, moj zonjë çalamane, të qëndroni vetëm një sekondë e të më thoni nga vini dhe ku shkoni?” Aq shpërfillëse ishte koha, aq kryeneçe, aq e pazotërueshme, aq e pamëshirshme dhe cinike në udhëtimin e saj, sa nuk mund të përshkruhet. Cili ishte destini i saj? Ndoshta një lloj krijimi me anë të shkatërrimit. Çfarë mbartte me vete? Asgjë me rëndësi të madhe, përveç një puhize të lehtë e të padukshme pluhuri harrese për të mbuluar për së gjalli këto grimca të vogla frymëmarrëse.

Në një moment, kur Tushi po mendohej, sepse nuk vendoste dot të dilte në lojë me gjashtën apo me katrën, plasi një sherr i madh te banaku.

Ai ktheu kokën dhe pa që ambasadorët ishin ngritur nga tavolina për të dalë nga “*Potiri*” dhe po shtyheshin me njëri-tjetrin kush e kush të paguante i pari gotat e

rakisë që kishin pirë. Atëherë Tushi u ftillua dhe kuptoi që katër “ambasadorët” na paskeshin qenë kasapi Fiqiri Kaca, traktoristi Qerim Topalli, tekniku i ndërzimit Marin Dermeku si dhe kushëriri i tij, shurdhi Mul Dermeku.

Traktoristi këmbëngulte, donte të paguante vetë. Ai i shtyu tre të tjerët si me ruspë, i nxori jashtë dhe mbylli derën nga brenda; mirëpo ata u sulën të gjithë njëherësh, shpërthyen derën dhe yrish e prapë te banaku, secili duke i zgjatur Fazil Krosit nga një kartëmonedhë. Ngase Fazili nuk vendoste dot cilit t’ia merrte lekët, gjakrat erdhën duke u nxehur edhe më fort dhe përleshja u bë më e egër. Atëherë tregtari Fazil Krosi tha me sa i hante zëri:

- Në emër të paqes dhe stabilitetit rakitë i keni të paguara prej meje.

Dhe bam, goditi me grusht syprinën e banakut.

Kjo goditje bëri që një re pluhuri të ngrihej gjer lart në tavan dhe kundërshtarët të mos e shikonin mirë njëri-tjetrin.

Fjalët e Fazilit të thëna me zë të lartë, ata i morën si ndërhyrje në punët e brendshme.

- Mos na u ngreh si gjel ti, sepse kjo që thua zotrote nuk bëhet edhe sikur të bashkohet qielli dhe toka bashkë, - e paralajmëroi tekniku i ndërzimit duke u kollitur herë pas here.

- Unë ju lë të paguani vetëm me një kusht, - shpalli traktoristi duke gulçar. - Të ulemi edhe njëherë në tavolinë ku të pini edhe diçka prej meje... Në të kundërt, asnjëri nuk del i gjallë prej lokalit.

Dhe nisi të shtynte me bërryla teknikun e ndërzimit Marin Dermeku.

Kasapi shfrytëzoi momentin kur traktoristi po shtynte Marinin dhe i zgjati me të majtën kartëmonedhën Fazilit, kurse me të djathtë, nxori shpejt nga brezi një thikë të hatashme dhe e drejtoi nga shokët.

- Më vrafshin shtatë teqe, po nuk e bëra fërtele atë që do të guxojë të paguajë, - u betua ai.

Pas tij, shurdhi Mul Dermeku nxori një hutë të mbushur me leshin e boleve të kastragjyshit të tij, që e pati gjetur në një vrimë muri, i rراسi cigaren e ndezur në vrimë, i dha flakë barotit, dhe bam, gjuajti tavanin.

- Moth bani thamatë, the për atë dhot thi atht' n'qiell, u vrava të zhithëve, - i kërcënoi ai, ndërsa nisi ta mbushte sërish hutën me barut e lesh.

Ende pa u shuar mirë jehona e krismës së hutës, gjeniu i popullit të Bibollit, i thuri Mulit këtë këngë, e cila këndohet edhe sot me çifteli:

*Mul Dermeku trim me fletë  
Lë e rritë me kakën e vetë  
Trim i çartun, mendjehollë  
Na çuditi gjithë Bibollë.*

*Pse kafen deshën me i pagu  
Sot e mot me e marru,  
Mul Dermeku, sederliu,  
Me hutën e tij shtiu.*

Pastaj vijonte refreni:

*Of medet, medet, medet,*

*Bibollin tonë ç'na e ka gjetë!  
As të vrarë, as namë, as gjamë  
Veç pak lesh në tavan.*

Sapo u dëgjua krisma e hutës, i sëmuri Xim Pinci e mori këtë si një sihariq mistik, që tregonte se në Biboll po kalonte tinëzisht, mu si një hajdute *koha* dhe se dikush i kishte zënë pritë dhe e kishte gjuajtur me pushkë për ta vrarë.

Ai e la numërimin, doli nxitimthi nga lokali dhe iu vu me vrap nga pas *kohës*. Teksa vraponte, ndërsa çirrej si në tym me sa i hante zëri, ai i lutej *kohës* të ndalonte, pasi donte të shikonte ku e kishte marrë plumbi. Donte të dinte cila ishte *koha e shkuar* apo *koha e tashme*... E ndali vrapimin vetëm kur po i këputej fryma. Qëndroi aq sa iu desh për të mbledhur veten, pastaj duke marrë frymë me fytyrë që i fishkëllente, nisi të fliste me sytë e përhumbur, të ngulur tej në horizont.

Thoshte se e donte *të ardhmen* të ishte e bukur; të vinte dhe të qëndronte me të, ta shikonte dhe ta prekte, sepse *e shkuara*, kishte qenë e ligë. Ajo kishte pas ndaluar në Biboll vetëm për t'u zhgërryer mu si një gomaricë. U mendua sërish për pak sekonda dhe krejt në beft, si t'i kish shkrepur në kokë një mendim gjenial, Xim Pinci nisi të grumbullonte lloj-lloj sendesh mu në mes të rrugës.

- Çfarë bën ashtu, Ximi? - e pyesnin kalimtarët. - Ç'janë këto gurë, drunj e lloj-lloj sendesh, që po i vendos në mes të rrugës?

- Shshsht..., - ia bënte ai, tashmë me zë të vogël, a thua se kish frikë mos e dëgjonin. - Është nisur dhe po vjen një e

ardhme e keqe. Të ndërtojmë një barrikadë, të mos e lëmë të kalojë.

Nganjëherë gjindja ia hiqte sendet që ai bënte grumbull mes rrugës, gjithnjë duke e qortuar e duke u përpjekur ta bindnin të mos e bllokonte rrugën ku kalonin njerëzit; por Ximi i mblidhte sërish sendet dhe i vendoste ku ishin, madje duke mbajtur mend me përpikmëri edhe radhën me të cilën i kishte pas vendosur më parë.

- Ta ndalim, - thoshte ai. - Të mos e lëmë të futet në Biboll e ardhmja e keqe.

Ndërkohë, brenda lokalit, katër burrat vazhdonin të ziheshin.

Që puna të mos shkonte keq e më keq, ata hodhën short me letra me vrimë dhe i ra për të paguar shurdhit Mul Dermeku. Dhe, ngase shurdhi nuk kish dëgjuar ç'u tha e nuk mori vesh mirë ç'u bë, ikën të gjithë pa paguar asnjëri.

- Më duket se e sajuan kastile këtë skenë, - tha Maliku, që nuk besoi çfarë i panë sytë. - Në Biboll njerëzit janë të gjithë aktorë, prandaj jeta duket si një film, nga ato që të shkrin gazit.

Tushi doli nga “Potiri” andej nga ora tre pasdite. Ai u kthye e zuri vend sërish pranë shtëpisë ku banonte Lushja dhe blegëriu pa pushim gjersa ra nata.

Ajo ditë, qe si të thuash ters, asgjë nuk lëvizi nga shtëpia përballë, asgjë për bërë...

Atëherë ai mendoi që ishte fatkeq. Vetë Zoti e kishte lënë në harresë... Por sërish u pendua nga ky mendim, pasi Zoti, tha me vete ai, është i madh. Ai sjell në tokë dashuri për të gjithë; për njerëzit, kafshët, insektet, barin, pemët, peshqit e gjithë krijesat që gjenden në faqe të dheut. Të keqen, sipas tij, ia bënte ish sekretari i partisë, hoxhë Rrahimi. A nuk kishte hoxha tagrin të fliste në emrin e Zotit dhe të ndante dashurinë e tij mes bibollasve? Dhe jo vetëm dashurinë, ai ndante edhe mallkimet e Zotit, të cilat, shumë herë ndodhte t’i hidhte me dashje në adresë të gabuar. Pra, e bënte shumë keq këtë punë Hoxha ynë, duke abuzuar me detyrën që i kishte ngarkuar vetë Zoti. Ai nuk e ndante dashurinë e Zotit sipas meritës, por dikujt i jepte më shumë e dikujt më pak; e ndonjërit nuk i jepte fare. Dhe, nëse ndonjëri ankohej duke thënë se nuk i mjaftonte aq dashuri Zoti, hoxhë Rrahimi sillej si pusht; e merrte me

të mirë, i buzëqeshte, i thoshte se dashuria e Zotit hë për hë qe mbaruar dhe se duhej pritur. “Bëj durim“, - i thoshte ai, - sa të na vijë prej qiellit dërgesa tjetër”. Madje premntonte që, kur të vinte dërgesa tjetër, do t’i jepte, medemek, edhe një gjysmë racioni më shumë.

Këto mendime e bënë Tushin të mbushej me urrejtje për hoxhë Rrahimin.

I bindur se hoxha, pjesën më të madhe të dashurisë së Zotit e mbante për vete, - sepse dukej ashiqare, që ai u ndante fare pak njerëzve, - Tushi vendosi t’ia vidhte dashurinë e Zotit hoxhë Rrahimit.

Në mes të natës, ai u ngrit nga shtrati ku flinte, u vesh, futi në xhep një kaçavidë dhe u drejtua për nga xhamia.

E dinte mirë, që hoxhë Rrahimi flinte në një dhomë, dera e së cilës ndodhej në krah të djathtë të sallës së lutjeve. Ngjit me këtë dhomë gjendej një korridor i ngushtë, pesë metër i gjatë, që niste po nga salla e lutjeve dhe vinte e mbyllej. Në fund të këtij korridori, nga e majta, ndodhej një tjetër derë, disi e fshehtë, që nuk binte fort në sy, sepse nuk kishte kornizë, nuk kishte as dorezë dhe, për më tepër, qe lyer me të njëjtën bojë, me të cilën ishin lyer muret. Pikërisht kjo derë të shpinte në një dhomë pa dritë, ngase nuk kishte dritare. Dera e kësaj dhomë rrinte gjithmonë e mbyllur me çelës. I vetmi që hynte e dilte prej aty brenda qe hoxhë Rrahimi. Dhe kjo ndodhte vetëm në rastet kur hoxha gjendej i vetëm në xhami. Tushit i tha mendja që, pikërisht në këtë dhomë, hoxhë Rrahimi mbante të fshehur pjesën më të madhe të dashurisë së Zotit.

Atij i duhej të kalonte mes për mes lulishtes për të dalë pastaj në cepin e rrugës ku ndodhej xhamia.

Hëna në qiell dukej si një drapër i vjetër, i holluar nga përdorimi i gjatë. Veç kësaj, shtëllunga resh të zeza lëviznin drejt lindjes duke sjellë herë pas here me revansh në tokë hijet e tyre të zeza.

Tushi eci përmes lulishtes duke shfrytëzuar errësirën. Sapo retë lëviznin dhe kthehej sërish ndriçimi i hënës, ai futej dhe priste poshtë pemëve ku errësira që më e dendur. Pastaj, me t'u zhdukur hëna, vazhdonte të ecte në drejtim të xhamisë.

Ai pa në lulishte dy qen që ndiqnin njëri-tjetrin. Njëri prej tyre ndaloi para monumentit të heroit të Partisë Demokratike, Shaban Kapsolles. I shkoi njëherë rrotull duke nuhatur, pastaj ngriti këmbën e pasme, e shurrosi dhe u largua. Tjetri pas tij u ndal t'i merrte erë shurrës që la i pari, por nuk qëndroi gjatë, ia dha vrapit me bishtin përpjetë duke lëshuar më të rrallë ca lehje si hungurimë.

Brenda një dhjetëvjeçari qenë ngritur aty dy buste heronjsh partie, që të dy përballë njëri-tjetrit. Shabani mbante veshur një pardesy dhe kishte ngritur dy gishtat lart. E vendosën aty kur demokratët ndodheshin në pushtet. Pastaj, kur ata ranë nga pushteti, socialistët ngritën përballë tij bustin e heroit të partisë së tyre, Loni Lepenicës, i cili, ndërsa kërcënonte me grushtin e dorës së majtë, në të djathtë mbante një sëpatë. Që të dy patën vrarë njëri-tjetrin gjatë përleshjes në një demonstratë. Edhe tani, që ishin shndërruar në mermer të ftohtë, ata dukej sikur i bënin karshillëk njëri-tjetrit; sikur grindeshin, shaheshin e kërcënonin në emër të partive.

Ngase aty rrotull nuk kishte ndonjë banjo publike, që një vend ideal për t'u fshehur pas tyre e për të bërë shurrën



katundarët që dilnin në pazar për të shitur ose blerë ndonjë send.

Tushi mbajti hapin që të dëgjonte, pasi iu bë sikur dikush foli. Ai kuptoi që fjalët vinin përballë tij dhe mundi të dallonte një burrë të dehur, i cili qe shtrirë në një stol. Fliste përçart: “...Prit, moj, prit... Do ta bëj hundë klasike...! Edhe trurin do ta ndërroj... E merr, moj, e merr... Si nuk e merrka kafka ime trurin e Ajshtajnit?! Jo, jo..., Nuk të mbaj më pastaj.... Ndoshta martohem me Xhenifer Lopez... Viçin e kam te shpia, dy keca m’i bën dhia...”

Tushi iu shmang nga e djathta, por e ndoqi nga pas një duhmë e qelbur urine. Pastaj u dëgjua krrokatja e trembur e një sorre të përgjumur, që flinte e strukur në degën plot me gjethe të një dushku.

Që nga ana tjetër e parkut vinte aty zëri i lodhur i një gruaje që çirrej e bërtiste me një burrë, i cili, kishte gjasa të ishte i shoqi. Bëhej fjalë për disa para të lëna në bixhoz. “Ti je një derr, ja çfarë je, - thoshte ajo. - Nuk mendon që ke grua, fëmijë... Dil nga shtëpia se më nxive jetën... Më janë dashur pesë vjet për t’i kursyer e mbledhur ato para”.

Pastaj një tjetër u ankua nga ballkoni i apartamentit ngjitur.

“- Më falni, por nuk bën kështu! Tani e gjetet të grindeni? - thoshte ai. Ju lutem shumë! Është ora dy e natës. Kam punuar e jam lodhur gjithë ditën dhe tani dua të fle. Nesër, sërish do të më duhet të dal që me natë për në punë”.

Tushi shpejtoi hapin dhe mbërriti pranë murit të pasmë të xhamisë. Aty ndaloi dhe mbajti vesh. Tashmë asnjë zhurmë nuk dëgjohej. Ai nisi të kontrollonte një nga një dritaret e sallës së lutjeve. Diku nga fundi vuri re një kabull

elektrik që vinte nga një garazh makine dhe futej në sallën e lutjeve përmes dritares, që pikërisht për këtë shkak nuk kishin mundur ta mbyllnin.

Kishte pasur një lidhje të shkurtër në sistemin elektrik dhe qenë shkrumbuar telat, ndaj përkohësisht kishin marrë energji që nga garazhi dhe e kishin futur në xhami.

Tushi shtyu kurtinën e dritares dhe vështroi brenda sallës së lutjeve. E gjithë salla ndriçohej vetëm me një llambë provizore. Salla që shtruar me parket prej dru lisi dhe ishte krejt e zbrazur. Në një gozhdë të ngulur në mur qëndronte varur veladoni i hoxhë Rrahimit. Ai u fut brenda dhe nisi të ecte ngadalë me veshët pipëz e me frikën në zemër se mund ta dëgjonin. Por pastaj i tha vetes se nuk duhej të frikësohej, përderisa po shkonte drejt dashurisë së Zotit. Ai hapi me kujdes një derë aty pranë, e cila lëshoi një gërvimë të lehtë, që e bëri të mbushej me frikë. Nën dritën e zbehtë që vinte nga salla e lutjeve ai mundi të shquante se që kuzhinë. Mbi një tryezë ndodheshin disa shishe të zbrazura birre si dhe pjata të boshatisura prej ushqimeve. Në mbështetësen e njëres nga karriget e ndodhura aty që harruar një shall grash prej kremi, stolisur me gonxhe trëndafili.

Tushi doli prej aty duke ecur së prapthi gjithë kujdes, me veshë të pupëzuem. Derën e la hapur.

Ndërsa qëndronte në këmbë për të vendosur nga duhej t'ia mbante, i erdhi në vesh e kollitura e një burri. Pastaj një zë gruaje që pyeti:

- Ç'të gjeti?

- E kam nga alergjia, që më shkakton parfumi yt, - tha burri me një zë të prridhun, ndërsa vazhdonte të kollitej.

Tushi kuptoi që zërat vinin që nga dhoma ku flinte hoxha. U avit ngadalë dhe, si mbajti vesh, njohu zërin e hoxhë Rrahimit, ish sekretar partie.

- Sa është ora?- pyeti hoxha.

- Nuk shikoj mirë... - tha gruaja. - Dy e gjysmë, më duket.

- Duhet të flesh, sepse do të dalësh prej këtu pa zbardhur drita, - i kujtoi hoxha gruas që gjendej aty bashkë me të.

- Më zgjoi kolla jote, - tha ajo. - Tani dua ta bëjmë edhe njëherë...

Hoxha u kollit sërish.

- Jo, - tha ai, ndërsa kollitej. - Shkon shumë pagesa. Ma dhë pazarin për një natë.

- Nuk ta dhashë për një natë. Të thashë njëzet për një të bëme, jo për një natë. Dy herë nga njëzetë, bëjnë dyzet. Nuk janë kushedi sa...

- Më the se kërkon njëzet për të fjetur me mua një natë. Pastaj ma luajte fjalën, ma ktheve me të bame, prandaj do ta lëmë me një herë. Njëzet, mjaft i ke.

Dhe filloi të kollitej sërish. Gruaja priti ta lëshonte disi kolla, pastaj pyeti:

- Sa të mori Zaidja e Hasanit, të kujtohet? Fiks njëqind mijë të mori...

- Zahidja është më e re se ti. Vjen e gjatë dhe e hollë si filiskojnë dhe cicat i ka marshalla. Pastaj ajo di të sillet si një çupë e marrshme.

- Të raftë një damull! Po Lulie Behari? Ajo kurva që kërcen lokaleve të natës...

- Ajo erdhi të pastronte gjynahet.

- Dhe ia pastrove, ë?

- Më duket se po, - tha hoxha, ndërsa qeshte dhe kollitej.

- Po Zhaneta Pogoni?

- Asaj torovoleje vetëm i dhashë të hante, sepse e kishte nxjerrë i shoqi nga shtëpia dhe kishte tre ditë pa ngrënë. Kur u ngop e bëmë njëherë shpejt e shpejt në këmbë.

- Po Pavlina, ajo jevga e shkurtër?

- Cila Pavlinë? Vallahi bilahi, nuk më kujtohet ndonjë Pavlinë...

- Pavlina, ajo biondja që u nda me atë drejtorin kurrizdalë të tatim-taksave.

- Ajo nuk e ka emrin Pavlina, e ka Paulina.

- Pavlina, Paulina, njësoj është... Thuaj, sa të mori?

- Aq sa ti më duket se më mori edhe ajo.

- Mirë pra... Do ta bëjmë edhe një herë me gjysmë çmimi.

- Me gjysmë çmimi pranoj, por lekët e kësaj here do t'i marrësh, kismet, kur të vish prapë në fund të javës, - tha hoxha.

- Dakord, por herë tjetër do ta ngre pazarin, një pesëmijëlekëshe më shumë...

- Të jap pesëmbëdhjetë më shumë, por pazari do të jetë fiks për një natë.

- Pazari do të jetë sa herë të më hypësh. Pastaj ti e ban si një derr dhe gjithmonë qelbesh erë hudhër nga goja. Unë po të jap një barrë qejf, kurse ti...

- Tani po shikoj se po fle me një shejtane... Bismilah! Ktheu për së mbari...

- Jo, kësaj here e dua nga mbrapa, lopthi...

- Elhamderulah! U pa kjo punë...

Tushi u pataks nga biseda që dëgjoji mes tyre.

Kur filluan të dëgjohen hungërimat prej derri dhe gulçimat e epshit të pakontrolluar të hoxhë Rrahimit, ai nisi të largohej pahetueshëm, në majë të gishtave. U fut në korridorin e ngushtë, i cili të shpinte tek ajo dhoma e fshehtë, ku ai mendonte që hoxha mbante fshehur dërgesat e dashurisë së Zotit. Nëse do të arrinte të hynte aty, do të qe me fat, pasi do të kishte mundësi të merrte shumë nga ajo dashuri. Nuk donte t'ia dinte pse po e vidhte, pasi ai nuk po ia vidhte Zotit, por po ia vidhte hoxhë Rrahimit, ish sekretar partie, këtij njeriu të ulët e pa karakter, këtij pushti maniak, që bënte seks me pagesë duke futur në xhami lloj-lloj femrash të përdala.

Derën e hapi pa shumë mundim, duke përdorur kaçavidën që mori me vete; por kur futi kokën të shikonte brenda, iu përplas në fytyrë një duhmë e ftohtë me veti gërryese.

Qe si një stuhi grimcash xhami të akullt, një si vorbull që sillej e përsillej brenda duke fshikulluar muret si me kamxhik.

Tushi guxoi dhe hyri brenda, ku gjeti aty shumë baule të mbyllura. Nga plasat e dërrasave të këtyre bauleve, fishkëllente një si erë e ftohtë brisk. Ai nuk arriti të kuptonte çfarë po ndodhte dhe vendosi të hapte njërën prej bauleve.

Kur ngriti kapakun, u pataks me çfarë i panë sytë: baulja qe mbushur plot me urrejtje, një urrejtje e zezë si sera e xhehnemit, e ngjeshur si me presë aq fort sa ishte ngurtësuar. Me të ngritur kapakun, masa e ngurtë nisi të plasaritej e copëtohej në miliona grimca të vogla me veti toksike. Pastaj nisi të vlonte duke pluskuar acide. Ai e

mbylli shpejt kapakun e asaj bauleje dhe hapi një tjetër, pastaj një tjetër e kështu me radhë...

Të gjitha këto baule të mëdha qenë mbushur dëng me urrejtjen që Zoti kishte hedhur mbi ish sekretarin e partisë, hoxhë Rrahimin, e që ai e kish kyçur me çelës në atë dhomë të xhamisë. Nuk gjendej aty pik dashurie Zoti, madje as gëzim, as mëshirë, as moral, as dinjitet, asgjë prej gjëje tjetër. Pra, qe gabuar kur i tha mendja se hoxhë Rrahimi mbante të fshehur për ta pasur vetëm për vete pjesën më të madhe të dërgesave me dashurinë që sillte Zoti.

Doli prej aty gati me vrap, krejt i shkujdesur, pa iu bërë vonë se mund ta dëgjonin e shikonin. Vajti në shtëpi ku u shtri dhe fjeti si i vdekur.

Ditën tjetër Tushi u ngrit herët në mëngjes. I rrihnin tëmthat dhe i dhembte koka. Doli nga shtëpia dhe si eci gati një orë në këmbë, ndaloi në një vend të shenjtë.

Ishte një majë kodre plot me bar, dushqe, dëllinja e fier që fërgëllinin nga era e lehtë e jugut..

Aty ndodhej varri i shenjtit Sharof, që thuhej se e kishte pas therur një shtrigë me nam, e cila kishte pas banuar në *Shpellën e orëve të liga*.

Tushi ra në gjunjë pranë varrit të shenjtit Sharof dhe filloi të blegërinte, mirëpo u kujtua se tashmë nuk ndodhej para shtëpisë së Lushes, por ndodhej në një vend të shenjtë, tek i cili kishte ardhur për t'u lutur dhe jo që të blegërinte. Atëherë ai bashkoi duart e nisi të lutej:

- I dashuri dhe jo fort i lavdishmi shenjti Sharof, që rron nganjëherë në zemrat tona! Unë kam një vajzë... Jo, jo... Nuk e kam unë, dikush tjetër e ka ..., - e ndreqi aty për aty Tushi. - Pra, siç thashë, dikush ka një vajzë të rritur, e cila quhet Lushe. Kjo Lushja... Bëje, pra, Lushen, o shenjti Sharof, të më dojë dhe të martohet me mua! Unë, o shenjt jo fort i lavdishëm, - pse të gënjej? - nuk jam as i gjatë, as i shkurtër, as i bukur, as i shëmtuar, as i pasur, as i varfër,

as i mirë, as i keq. E thënë shkurt, unë jam ky që jam, Tush Tarrota i Bibollit. Kaq kisha për veten.

Lushen e pëlqej... Që të mos ngatërrohesh e të bësh të martohet me mua, larg qoftë, ndonjë rruspi, po ta përshkruaj pak: Lushja është e shëndoshë nga prapanica, - s'ka problem, unë të shëndoshë e dua; ka një nishan në faqe, që ngjan me një kakërdhi, - nishanet, gjithashtu, i pëlqej, si dhe një dhëmb të rënë, - punë e madhe fort...! Për shkak të mungesës së dhëmbit, sa herë qesh, ajo vendos dorën para gojës. Ky gjest, mua më duket fort me mend dhe gjithashtu, i lezeçëm. Nishani i shëmtuar dhe dhëmbi i rënë kanë ndikuar që Lushja të jetë vajzë e mirë, kuptohet... Sepse ato fort të bukurat....

Teksa fliste kësisoj, Tushi ndjeu një erë të keqe t'i shponte hundët. Bah, çfarë ere e keqe! Ai hodhi sytë përreth dhe... ç'të shikonte?! E merrni dot me mend? Jo, asnjërit nuk do t'i kishte vajtur mendja çfarë pa Tushi aty. As fallxhorja Leze Delfi nuk do ta gjente dot duke parë filxhanin e saj. Madje edhe sikur të mendohej me muaj e vite e të bënte shumë marifete të magjishme duke shti fall nuk do ta gjente. Vetëm ndonjë deputet nga ata, që flasin në parlament fjalë që të lënë pa mend, ndoshta mund ta gjente. Prandaj po e themi vetë: dikush, dhe ky dikushi patjetër do të ketë qenë një bagëti e trashë katundi, - kishte bërë, me nder jush, nevojën mu pranë varrit të shenjtit Sharof. Dhe më e hatashmja që sepse Tushi e kishte shkelur me këmbë. Bah, çfarë tersi! Dhe të mendosh, që rreth varrit të shenjtit Sharof duhej të kishte vetëm ajër të freskët dhe rreze dielli të virgjëra për lezet, kurse në shkurre, mëllenja që ia thonë këngës pa pushim.



Lart në qiell dukej vetëm një re, që ngjante me një pulëbardhë të madhe, një pulëbardhë - engjëll lajmëtar, që vjen që nga rezidenca e Zotit për të sjellë në tokë frymën e shenjtë, bashkë me paqen e amshuar. Kurse aty pranë varrit të shenjtit Sharof, në vend të freskisë dhe qashtërsisë që fal natyra, ndodhej një ndyrësi, që e bën njeriun e shkretë të zërë hundën me dorë e të mos marrë frymë për një kohë të gjatë. Kjo ndyrësi, sikur e zhvishte nga shenjtërimi Sharofin, e bënte as më shumë as më pak nga ç' ishte, ta zëmë, Sharof Përdafi i Toskanës, që shtirej në çdo gjë dhe gënjente mu si një derr. Dhe të mendosh që Tushi po i lutej shenjtit, shpirti i të cilit, i përjetshëm qoftë kujtimi i tij, qëndronte pezull në ajër dhe e dëgjonte me shumë vëmendje. Me vëmendje dhe me keqardhje gjithashtu, sepse Tushi kishte hall. - Zoti e ndihmoftë! Turp dhe mëkat i madh për atë që e kish bërë! Phu! - pështyu ai. Por shpejt u pendua, sepse i ra ndërmend që edhe të pështyje ishte një gjë pa edukatë, që e bëjnë nganjëherë katundarët kur shkojnë rrugës së pazarit, sepse u zënë sytë ndonjë tip që e urrejnë.

Në një çast ai mendoi se atë menderosje mund ta kishte bërë ndonjë kafshë, ndoshta ndonjë qen rrugësh; por si e këqyri me shumë kujdes, Tushi vuri rë që në përbërjen e saj, përpos disa krahëve insektesh të koracuar, kishte edhe bërthamëza qershie.

Ngase qentë nuk mund të hipin në pemë për të ngrënë qershia, ai u përpoq të kujtonte cili nga bibollasit i hante qershitë me gjithë bërthamëza. Menjëherë iu kujtua hoxhë Rrahimi. "Qershitë duhen ngrënë me gjithë bërthamëza, sepse bërthamëzat pastrojnë zorrët", - u kishte pas thënë besimtarëve hoxha para do vitesh. Dhe ky fakt që

konsideruar si një zbulim fort i madh prej hoxhë Rrahimit.

Tushi qe paksa në dilemë për ato krahët e koracuar të buburrecëve dhe nuk dinte si ta shpjegonte faktin pse gjendeshin aty. Mirëpo shumë shpejt i dha dum edhe kësaj enigme. Me siguri që hoxha i përlaka edhe buburrecët, tha me vete ai, sepse u kujtua që i ati i tij Zavi, i kishte pas thënë njëherë që hoxha i Bibollit hante miza. Ai që ha miza, kuptohet që ha edhe buburrecë, tha me vete Tushi. Maskarai! Kafsha e pa zhvilluar! Horri i dreqit! Kodoshi me koqe të fryra. Dhe pa pik turpi, del e u flet besimtarëve si të shenjtërohen! Të fikt' Allahu e u bëfsh varr sa më shpejt! - e mallkoi hoxhën Tushi.

U largua prej aty duke mbajtur hundën me dorë e duke u përpjekur të fshinte këpucën për barit. Edhe lutja pranë varrit të shenjtit Sharof i shkoi ters Tushit. Një ters që lëre mos e pyet.

Mbërriti në shtëpi para se gjindja të dilte për punë, domethënë andej nga ora dhjetë, sepse bibollasit dalin për punë andej nga njëmbëdhjeta. Dhe e lënë fiks në një e një çerek. Ato e duan punën, kuptohet. Punojnë aq shumë, sa nuk bëjnë fare pushim në drekë.

Tushi mori vesh se në sallën e bibliotekës së Bibollit bëhej promovimi i një libri. Libri titullohej *Blegërimat e dashurisë* dhe ishte shkruar nga poeti dhe prozatori i madh Aush Loshi. Ai vendosi të shkonte në këtë aktivitet. Ky libër duhet lexuar, mendoi ai, pasi do të më bëjë të blegërij si një poet i madh. Lushja do të preket nga blegërimat e mia e do të fillojë të më dojë.

Kur hyri Tushi brenda sallës ku mbahej aktiviteti, qe ende shpejt, nuk kishte mbërritur ora e caktuar. Ndodheshin aty vetëm katër-pesë të ardhur, të cilët kishin zënë vend të ulur në karrige. Organizatorët venin e vinin për t'u dhënë dorën e fundit vendosjes së objekteve. Latif Kishaveci merrej me mikrofonin dhe foninë duke bërë prova: një, dy, tre, katër...

Një mbesë e poetit Aush Loshit, studente e shkollës së mesme, po vendoste në tryeza shishet e pijeve. Herë pas here ajo ndalonte dhe hidhte vështrime për të parë nëse gjendej çdo gjë në vendin e duhur.

Diku andej nga radhët e para, Lemja, gruaja e shefit të policisë, Filip Zhulit, fliste me shitësen e bulmetit, Kaleme Shollën.

Kalemja qe gruaja e akademikut Hashim Sholla, që pritej të vinte për të mbajtur një kumtesë shkencore në lidhje me krijimtarinë e poetit dhe prozatorit Aush Loshi.

Tushi vajti dhe u ul diku pranë tyre.

Dy gratë po llafoseshin në lidhje me një krem, që quhej *coconutoil*. Kalemja thoshte se ky krem i kishte prishur lëkurën e fytyrës dhe se nuk do ta përdorte kurrë më. Lemja e kundërshtonte. Thoshte se kremi *coconutoil* qe më i miri në botë dhe se e kishte lexuar në matrikull, që ishte njëqind për qind organik.

Tushi i dëgjonte pa ndonjë interes, madje, ngase i dhimbte koka, ndjeu bezdi dhe vendosi të ndërronte vend. Por ndodhi që gratë e ndërprejnë diskutimin rreth kremit *coconutoil*. Lemja nisi t'i rrëfente Kalemes një histori tjetër. Kjo histori filloi t'i pëlqente Tushit, ndaj mbajti vesh.

- ...Shitësi më dha kartën, të cilën e gërvishta, por nuk fitova, - thoshte Lemja. - Bleva një tjetër kartë, e gërvishta edhe atë, por prapë nuk fitova! Mora edhe një kartë të tretë. E gërvishta dhe fitova pesëmijë lekë... Pesëmijë, thashë, moj, nuk thashë tetë! Me këto lekë bleva pesë karta. I gërvishta dhe fitova njëmijë. Ia dhashë shitësit të më jepte një tjetër kartë dhe ai ma dha. Desha ta gërvisht, por nuk më bënte zemra ta gërvishtja. Si, pse? Kisha frikë, moj ti, se do të humbisja... Përse, tjetër?! Ç'të bëja? Thashë me vete: mjaft kam gërvishtur... Jo, moj, jo... Unë nuk i blej ato karta sepse dua të fitoj. Ti e di: kam aq shumë para, sa nuk më duhen më. Sak nuk më duhen. Unë i blej ato, thjesht, sepse më pëlqen të gërvisht. E, mirë, tani... Gërvisht, gërvisht, njësoj është. Por, kuptohet, që edhe të humb para nuk më pëlqen. Kështu, ia ktheva kartën shitësit dhe i mora lekët.

Me ato lekë bleva tre llokume me arra. Llokume, moj, thashë, llokume... Njërën llokume e hëngra vetë, tjetra më ra pa dashje në tokë. Këto që vijnë nga Turqia, ti e di, janë llokume të mira. I ke provuar ndonjëherë? Janë aq të ëmbël, sa të shkrihen në gojë. Jo, moj, jo, nuk janë vetëm sheqer. Kanë edhe shumë gjëra të tjera brenda. Blen edhe ti? Shumë mirë bën, që blen edhe ti nga ato, pasi këto të vendit nuk bëjnë fare. Unë blej gjithmonë... Pra, kur më ra llokumja në tokë, m'u dhimbs. Thashë njëherë të ulem e ta marr, por ti e di, moj Kaleme, që në tokë udhëtojnë mikrobe. Kam lexuar diku që mikrobet transportojnë sëmundje kontrabandë nga njëri vend tek tjetri. Edhe njerëzit në pushtet prandaj bëjnë kontrabandë, sepse janë infektuar nga mikrobe të tilla. Kontrabanda është sëmundje që shkaktohet dhe përhapet nga mikrobet. Kështu, e lashë, nuk e mora fare atë llokume. Pastaj, pashë që ia ngjiti dorën një lypës që kaloi atypari.

Llokumen e tretë ia fala një fëmije qaraman, i cili, fare pranë meje, zhgërryhej në tokë, përplaste këmbët e qante. Uaaa...! Çfarë fëmije mistrec që ishte, moj ti! I ankohej të ëmës: donte që në vend të një ariu prej pellushi, e ëma t'i blinte e t'i jepte minaren e xhamisë së Bibollit! Kur i dhashë llokumen, ai u qetësua, nuk e deshi më minaren e xhamisë. Prapë po qesh ti? Jo, moj, jo, nuk e them për t'u tallur. Jam grua serioze unë, nuk jam shakaxhie... Dëgjo, tani, dëgjo...

E ëma e fëmiut më falenderoi... Eh, mirë, edhe ti tani... Ngele duke më korrigjuar! Fëmijës, fëmiut, njësoj është. Pra, ajo më falenderoi. Madje shkëmbyen edhe numrat e telefonit. Më duket se quhej Hajrie. Hajria ngeli pa mend kur unë i thashë që isha gruaja e shefit të policisë Filip

Zhulit. Si...? - u habit ajo. Je gruaja e sherifit të policisë? Jo e sherifit, moj, i thashë, por e shefit. Ne nuk kemi sherif në Biboll. Në fakt, e kemi një sherif, kemi atë shoferin e autobusit, Sherif Dermekun. Prit, moj, mjaft qeshe... E thashë ashtu kot, sa për muhabet, sepse e di që kemi shumë njerëz me emrin Sherif. Mirë, tani, mirë... Edhe pak dhe mbarova... Pra, kur i thashë se isha gruaja e shefit të policisë, nuk donte ta besonte. Prej habitës bëri dy hapa prapa, u pengua dhe u rrëzua në tokë. Të betohem, moj Kaleme, nuk të gënjej.

E ndihmova të ngrihej dhe ajo e shkreta më falenderoi. Si u ndamë, vajta në shtëpi. U ula pranë dritares që të prisja të vinte im shoq, Filipi.

Teksa rrija në dritare, hodha sytë poshtë në rrugë dhe, uaaa, moj Kaleme! Uaaa...! Moj motra ime, çfarë llahtari! U llahtarisa kur mendova që disa gra të Bibollit marrin guximin dhe hidhen nga kati i pestë apo i gjashtë, edhe pse e dinë që vdekjen e kanë të sigurt. Unë për vete nuk do ta bëja kurrë këtë. Kurrën e kurrës! Do ta bëje ti, Kaleme? Hë, pra... Nuk bëhet, jo. Fundja, moj motra ime, përse do ta bëjmë? Nuk kemi asnjë arsye për ta bërë një gjë të tillë. Apo e kam gabim? Hë, thuaje! A nuk është tmerr, vetëm ta mendosh?! Si? Ç' thua, moj? Po u hodhe, hapi krahët sa të duash, vdekjen e ke të sigurt. I thonë gjashtë kate, oj ti! Nuk po hidhesh në valle, por po hidhesh nga maja e pallatit. Pastaj jeta është e bukur... Një gjumë do t'i fshinte të gjitha mendimet e liga. Prandaj fika dritën dhe u shtriva për të fjetur. ...Hë moj, dëgjo, se ngele duke kthyer kokën nga dera! Do të të vijë edhe burri. Duro. Të tha që do të vijë? Atëherë, përse mërzitesh? E di, e di, që ka për të mbajtur

kumtesë... Dëgjo, tani, dëgjo: andej nga e vona erdhi im shoq, Filipi. Menjëherë e kuptova që kishte pirë, sepse e dëgjova qysh kur ndodhej prapa derës. Iu deshën dhjetë minuta të fuste çelësin në vrimë për të hapur derën. Pastaj kur hyri, kuptova që nuk isha gabuar, sepse të qelbte era e alkoolit. Epo, hajt ma, thashë me vete, do ta bëjmë njëherë; sepse burri, sido që të jetë, i dehur apo jo, ai burrë është, në krevat nuk është i keq. Pse qesh, moj, si budallaçkë? A nuk është kështu? Uuuu..., kjo! Të raftë pika, të raftë! Shikon? Edhe ty ta ka qejfi... Mjaft, tani, mjaft qeshe! Mjaft, pra...! Do më lësh ta tregoj gjer në fund apo jo? ...Pra, siç thashë, hyri Filipi brenda. Si hyri brenda, u zhvesh, u fut poshtë jorganit dhe u rehatua. Pastaj tamam kur unë prisja të zgjaste dorën të më prekte, ai hapi gojën e tha se bota po shkonte drejt ngrohjes globale dhe se kjo do të ishte një katastrofë e madhe për gjithë njerëzimin. Tani merre me mend vetë, moj motër, çfarë ndjeva ato çaste. E di si u bëra?! Më erdhi aq inat, sa... Çfarë prisja unë të thoshte dhe çfarë tha ai, damullmadhi! M'u ngritën nervat. Im shoq, moj ti, gjithmonë mendon më të keqen. E mendon dhe e thotë bash në vendin dhe kohën e gabuar. Dhe unë, nuk di çfarë të bëj me të. Nuk është fare optimist. Unë nuk u shqetësova pse ai nuk... Kupton ç' dua të them? Fare, fare nuk u shqetësova. Por, a ishte vendi dhe koha për ta thënë atë llaf, moj aman? Rri, pra, mos qesh! Shif, kjo... Do më lësh të mbaroj apo si? Ku e kisha fjalën? Hë, po... I fola, nuk lash fjalë pa i thënë, derisa më në fund, më erdhi shumë keq për veten dhe nisa të qaja. Kurse ai, në vend që të prekej e të më merrte me të mirë, lëshoi një pordhë aq të madhe, sa u ngrit jorgani përpjetë. Atëherë, nuk u përmbajta dot

dhe e quajta *derr*. ...Prapë po qesh ti, moj? Për kokë të fëmijëve, derr i thashë. Nuk po tallem. Do të më lësh të mbaroj apo si e ke hallin. Prit, pra, ta vazhdoj... I thashë: ik shko e pordh në ndonjë konferencë shtypi ose pordhi sekretares tënde, asaj fyrifyçkës... Ti s'je tjetër veçse një derr me feçkë të llangosur. Kështu i thashë. Si? Të shkriva? ...Më raftë pika, po të gënjeva! ... Si?! E çfarë pastaj pse e kam burrë? Mirë, po pres sa të mbledhësh veten ti, pastaj vazhdoj prapë unë... Ai nuk u besoi veshëve. E di si u bë? Ç'të të them...! Pa thënë asnjë fjalë, u ngrit, u vesh, hapi sirtarin e komosë dhe mori pistoletën. Më ngriu gjaku se thashë se do më vriste. Por ai mori edhe dy krehër të tjerë me fishekë dhe doli nga shtëpia. I hipi makinës dhe, për ta bërë veten të pakrahasueshëm, vajti belaziu e vrau gjithë tufën me derra të Ndoc Noksanit. Kur u kthye tha: tani, moj grua, gjej ndonjë krahasim tjetër sepse nuk ka më derra. I vrava të gjithë.

Tani, moj Kaleme, qesh sa të duash, sepse e ke hak... Nuk ka më derra, tha Filipi! Si nuk paska më derra?! Derra nuk pati vetëm Ndoc Noksani, derra ka gjithë bota. Si i thua ti kësaj, moj Kaleme? Si i thua ti kësaj, moj motër? Një i dehur, kur nuk është agresiv, bëhet i lezeçëm... Por dëmit, moj, atij si i bëhej? I thashë Filipit të shkonte menjëherë dhe t'i paguante dëmin Ndocit. Sepse unë....

Ato çaste Lemja e ndërpreu rrëfimin, sepse ua afrua aty vetë poeti Aush Loshi.

Aushi, i vuri Tushit dorën në sup dhe me shumë dashamirësi i tha:

- Ti, more djalë, po më dukesh shumë i mërzhitur. A nuk më thua ç'hall të ka gjetur?



- Jam mirë, - tha Tushi. - Vetëm se po më dhemb pak koka.

- Nga cila anë, du me thanë, të dhemb më shumë, more bir? - pyeti Aushi.

- Nga ana e majtë, - tha Tushi dhe preku kokën me dorë.

- Si të vjen dhimbja, me hope, apo e vazhdueshme.

- Më vjen me hope. Në kokë kam rrahje si ato të zemrës. Sa herë rreh, dhemb.

- Po anën tjetër të kokës, si e ndjen?

- Atë nuk e ndjej fare, - tha Tushi. - Sikur nuk e kam timen, sikur kanë marrë gjysmën e kokës së një personi tjetër dhe ia kanë ngjitur gjysmës time.

- E ka nga dashuria, - tha poeti Aush me sigurinë e një kompetenti. - Gjysma e kokës tënde dhemb për shkak të gjysmë tjetër, që nuk është e jotja. Njerëzit dashurohen, sepse janë gjysma. Prandaj kërkojnë të bashkohen për t'u plotësuar. Bashkimi i dy gjysmave bën një të plotë. Por do të bëjmë diçka...

Mori nga tryeza librin e tij me blegërima dashurie, shkroi një autograf, ia la në dorë Tushit e tha:

- Të rekomandoj ta hapësh librin në faqen numër dyqind e pesëdhjetë. Aty do të gesh një poezi që unë e kam shkruar për dhimbjen e kokës që shkakton nganjëherë dashuria. Sapo ta lexosh, do të të pushojë. Pastaj mund të lexosh të tjerat, një nga një...

- Ju falenderoj shumë..., - tha Tushi.

- Nuk ka përse, - ia ktheu Aushi. - Unë jam poet i popullit, shkruaj për popullin dhe prek me penë aty ku i dhëmb popullit.

- Nëse mund t'ju pyes, - tha Tushi, - a gjendet këtu në këtë libër edhe ndonjë poezi për shtrëngimet e barkut, sepse nganjëherë... Pastaj mua më dhëmbin edhe kyçet kur prishet koha.

- Të them të drejtën, - nisi të thoshte Aushi, - në librin tim nuk ka ndonjë poezi shkruar enkas për këto lloj dhimbjesh, por e them me bindje të thellë, që secila prej tyre mund t'ju ndihmojë disi... Du me thanë, do ndjeni një farë lehtësimi menjëherë sapo t'i lexoni.

Ato çaste mbërriti aty Liza Piluri, një zonjë e shëmtuar kjo, por që vishej bukur me paratë e të shoqit që bënte biznes ndërtimi.

Aushi i kërkoi ndjesë Tushit dhe u kthye të përshëndetej me Lizën, e cila, ndërsa ecte drejt tij, hapi krahët e thirri:

- Po ku je, more gjigant, more *Sulejmani i Madhërishëm i letërsisë bashkëkohore*?! Uaaaa! Sa shumë kohë u bë pa u parë! Uaaa...! Sa shumë kohë!

- A vërtet, ti je Liza? - pyeti Aushi dhe hapi krahët ta përqaftonte. - Vërtet ti je?! Tani që po të shikoj, nuk po u besoj syve. Si ka mundësi që nuk paskeni ndryshuar fare?! Qenke tamam ajo Liza e bukur, ajo që keni qenë para tridhjetë vjetësh, pa asnjë ndryshim. Uauuu...! Çfarë befasi!

Dhe u shtrënguan në një përqaftim që zgjati plot dhjetë minuta. Gjatë këtij përqaftimi, ata patën rastin të bënë edhe një dorë muhabet duke i pëshpëritur njëri-tjetrit vesh më vesh. Sa herë i pëshpëriste Aushi, qeshte Liza, kur i pëshpëriste Liza, qeshnin të dy.

Kjo Liza e bukur, kishte një hundë si sqep papagalli, majën e së cilës e kishte lyer pa dashje me të kuq buzësh.

Qe e dobët si thaçkë, por i kish mbushur gropëzat e faqeve me krem të trashë. Për t'i dhënë fytyrës formë të rregullt ovale, në vend të furçës ajo kishte përdorur një shpatull nga ato që ustallarët i përdorin për të patinuar muret. Mbante në kokë një kapele me pupla, të cilat, padyshim vinin nga pularia me shumë emër e Hilë Kakarriqit. Kishte mbathur një palë këpucë me taka të larta prej qelqi delikat, ndaj ecte ngadalë e gjithë kujdes, që të mos i thyheshin. Nga supi i djathtë i varej me rrip një çantë e bukur, moderne, sa një kuti shkrepëseje, brenda së cilës mbante kunjat për të kruar dhëmbët e prishur.

Tushi i hodhi një sy librit që i la në dorë Aushi dhe kuptoi që ky libër do t'i qëndronte shumë gjatë kohës, sepse kishte kapakë të trashë, fletë të trasha, shkronja të mëdha të shkruara me bojë të trashë, si dhe ishte qepur me pë, gjithashtu të trashë.

Kur i shfletojë fletët, ata lëshonin një si gërvimë aq melankolike, sa duhej të kishe zemër të fortë t'i përballoje emocionet që të pushtonin. Edhe po të mos i lexojë fare, blegërimat që kishte brenda ky libër, mjaftonte kjo gërvimë që lëshonin fletët për të kuptuar vlerat e Aushit si poet.

Ai u përpoq të gjente faqen me numër dyqind e pesëdhjetë, ku ndodhej ajo poezia që i rekomandoi Aushi, por u çudit kur zbuloi që libri na kishte vetëm njëqind e dhjetë faqe.

Kështu, ai mendoi, që ndoshta nuk e kish pas dëgjuar mirë çfarë i tha poeti Aush.

Organizatorët e aktivitetit kishin vendosur që pjesëmarrësit të hanin e pinin njëherë, që të ishin të ngopur kur të fillonte mbajtja e kumtesave, që vërtet ishin të lodhshme, por shumë të rëndësishme. Një veprim i planifikuar me shumë mend ky, sepse ndodhte që auditori, ngase e mbante mendjen te tryezat e shtruara, nuk dëgjonte çfarë thuhej në podium. Veç kësaj kishte ndodhur shpesh që të ftuarve në sallë u kishte rënë të fikët, ngase nuk u kishin rezistuar dot gjer në fund kumtesave të gjata.

Kjo pati ndodhur njëherë me Lemen, gruan e shefit të policisë Filip Zhulit, të cilës i hahej më tepër se të tjerëve; por rasti më tragjik i ndodhi atë ditë vetë poetit dhe prozatorit Aush Loshi.

Ngase kishte dy ditë pa ngrënë nga merakuri i aktivitetit, Aushit i ra të fikët. Ndodhi pikërisht në çastet kur po i afrohej një pjate të mbushur me kukurec të pjekur. Në fillim ndjeu si dobësi. Ai nuk e kuptoi nëse kjo dobësi i vinte nga zemra, nga stomaku apo qe nga ato që u thonë dobësi karakteri. Kur kuptoi që nuk mund të rrinte në këmbë, u mbajt te një karrige, derisa u ul në gjunjë. Kur Liza Piluri u afrua ta kapë për krahu që ta mbante, Aushi u plandos në dysheme.

Liza i dha shpejt e shpejt, njëra pas tjetrës pesë shpulla për ta përmendur, por ai nuk u përmend. Atëherë, me shumë nxitim, ajo i derdhi në fytyrë një pagure të madhe *kokakola*, që shkumonte, pastaj dy *red bull* nga ato që pinë vipat në emisionet televizive si dhe katër kanaçe *pepsi*; tek e mbramja, ajo ia lau fytyrën me ujë të gazuar, por sërish pa rezultat.

- Bëni diçka, - tha pastaj Liza si me të lutur teksa hidhte rrotull një vështrim të shqetësuar. -Nuk po ndërmendet...! Dhe ta dini, që ky nuk bën shaka; do të vdesë seriozishtë...

U afrua Tushi, ngase i vajti ndërmend që t'i nxirrte gjuhën, por vuri rë, që Aushi gjuhën e kishte jashtë. Atëherë e tundi dhe e shkundi fort për supesh, ndërsa me zë të lartë i thoshte:

- Zotni Aush! O zotni Aush! Ju lutem, hapini sytë dhe shikoni, që të kuptoni çfarë hataje po na bëni? Ju po lini koqen e namit! Na mblodhe për dasëm apo na mblodhe për mort?!

Ndërsa i fliste, ai i futi edhe dy shpulla me të majtën, por Aushi sërish nuk luajti vendit.

Atëherë, ia behu aty akademiku Hashim Sholla, i cili, nga shkante, shtynte një karrocë të madhe si ato të supermarketeve, të mbushur kapticë me punime shkencore. Për ta sjellë në vete, akademiku Hashim e gjuajti Aushin mu në tepe të kresë me një dosje të trashë, të mbushur me plot katërqind fletët e një punimi shkencor.

Lemja u llahtarisi me çfarë i panë sytë; ngase nuk po e mbanin këmbët, u mbështet pas Kaleses që të mos binte.

Kalemja e rroku me krahë për mes të Lemen dhe hapi këmbët që ta mbante fort, ndërsa përpiqej ta qetësonte duke

e këshilluar të mos trembej, sepse i shoqi, Hashimi, dinte çfarë bënte.

Kur pa që Aushi nuk po përmendej, akademiku Hashim mori nga karroca e tij një fjalor të trashë enciklopedik dhe e goditi fort, kësaj here, pas koke.

Pas goditjes, Aushi futi njëherë gjuhën brenda, por nuk dihet pse e nxori prapë; pastaj hapi sytë për aq kohë sa iu desh të ngulte vështrimin mbi pjatën me kukurec që ndodhej në tryezën e shtruar, sepse pas kësaj, ai i mbylli sërish.

Menduan se vdiq, sepse forca e goditjes që dha akademiku Hashim, nuk ishte llogaritur mirë; ishte tejkualuar ajo masë që duhej vetëm për ta përmendur dhe jo për ta vrarë Aushin.

Duhet thënë që në Biboll, *masa e goditjes* ka qenë dhe vazhdon të mbetet një problem i madh. Njerëzit nuk e kanë të kultivuar si duhet sensin e masës. Ata nisen me qëllimin e mirë për të të bërë një shërbim dhe krejt pa dashje, të vrasin fare. Kjo lloj vrasje klasifikohet si *vrasje e keqe, ndodhur si pasojë e një qëllimi të mirë*.

Autorët që kryejnë *vrasje të keqe, ndodhur si pasojë e një qëllimi të mirë*, janë të detyruar t'u nënshtrohen disa procedurave formale në gjykatë për t'u shpallur, pastaj, të pafajshëm.

Vdekja e poetit dhe prozatorit Aush Loshi do të ishte një humbje e madhe në Biboll. Ai, përveçse ishte president i katër shoqatave, që i kishte ngritur vetë, (dy qenë kulturore, kurse dy të tjerat patriotike), ishte edhe krijues i veçantë dhe i jashtëzakonshëm në botën e letrave.

Shumica e veprave të tij qenë ilustruar me fotografi

të personazheve, të cilët ishin kapur nga aparati fotografik gjatë veprimit të ngjarjeve. Aushi, kishte mundur të fotografonte, sidomos, momentet më suksesive të zhvillimit të konfliktit si dhe pikat kulminante. Në librat e tij kishte katundarë që bënin shurrën në lulishte, duke u fshehur prapa busteve të heronjve të partive politike; gra që dërgonin lule tek varret e dashnoreve të burrave të tyre; kishte drejtorë modestë dikasteresh që e ndanin rrogën me sekretaret e tyre të varfra; mjekë që merrnin pjesë dhe qanin me lot në varrimet e pacientëve që vdisnin; kishte deputetë që dhieheshin në brekë ngase nuk e braktisnin dot parlamentin as për të shkuar në banjo; kishte politikanë që hanin një herë në dy ditë dhe nuk mbyllnin sy për të fjetur me net të tëra, ngase merreshin me hallet e popullit; kishte filantropë të pasur, që e shkrinin pasurinë e tyre duke u dhuruar shkollave patatina, lëpirëse, kokoshka, lapsa, letra me ngjyra dhe topa llastiku; kishte lule që flisnin, pemë që luanin basketboll, mace kameriere, qen shakaxhinj, krimba që bënin mjaltë, arinj namulinj, flutura që dashuroheshin me lakuriq nate; pula që hanin dhelprën, breshka që ndërronin zhguallin me njëra-tjetrën, kishte... e ç'nuk kishte në historitë e veprave të Aushit.

Interesante ishte mënyra e veçantë që përdorte Aushi për t'i shkruar historitë.

Para se të niste të shkruante, ai pyeste lart e poshtë njerëz kompetentë në fusha të ndryshme, duke bërë kështu një lloj investigimi në aspektin letrar. Nëse personazhi i tij ishte kriminel, Aushi shkonte e pyeste një prokuror se si duhej ta përshkruante, çfarë vesesh të këqija duhej t'i mvishte; merrte njohuri mbi teoritë kriminologjike, që të

kuptonte si funksionon një mendje kriminale, pastaj ulej dhe shkruante. Libri, i nisur si një roman, përfundonte si doracak udhëzues për punonjësit e drejtësisë. Nëse shkruante një frazë që tregonte se personazhi i tij ishte i sëmurë nga zemra, ai shkonte dhe pyeste ndonjë kardiolog për simptomat dhe prognozën e sëmundjes së zemrës. Donte të dinte si bëheshin ekzaminimet dhe testet e trajtimit për të parandaluar ndërlikimet. Dhe i shkruante të gjitha sa i thonin, duke bërë tek-tuk ndonjë ndryshim sipas rradakës së tij. Kësisoj, libri mbushej nga fillimi në fund me kalvarin e halleve dhe vuajtjeve të të sëmurit.

Nëse vendoste t'i vdiste personazhet, ai lexonte kronikën e zezë nëpër gazeta ose i bashkëngjitej ndonjë kortezhi të përmortshëm që ecte pas arkivolit ngadalë drejt varrezës.

I pyeste njerëzit përse, dhe si kishte vdekur i ndjeri, a kishte vuajtur shumë, sa vjeç kishte qenë, kishte qenë i gjatë apo i shkurtër, si vishej, ku e kishte pas pirë kafënë dhe a i kishte pas paguar në rregull energjinë elektrike dhe taksat, a kishte lënë grua, fëmijë e kështu me radhë.

Dhe mbante shënim gjithçka dëgjonte.

Skenat e dashurisë ai i peshkonte nëpër stolat e parqeve ose ngjitej në ndonjë pemë për të parë si brac përmes dritareve të dhomave ku flinin çiftet.

Një herë ai deshi të provokonte një flirt me një vajzë të re dhe të bukur, që të kishte mundësi të shkruante një poezi, por ajo e pështyu, pastaj e shtyu dhe e rrëzoi mu në trotuar.

Edhe pse rrëzimi qe gati fatal, sepse iu rropat koka për pllakave të trotuarit, kjo ndodhi iu duk interesante Aushit. “Kjo që më ndodhi me këtë vajzë, mendoi ai, vërtet nuk



mund të bëhet poezi, por ama, mund të bëhet prozë, mund të dalë një tregim shumë interesant”.

Atë natë nuk fjeti fare, e gdhiu duke shkruar.

Kur e përfundoi tregimin, iu kthye sërish nga e para dhe i dha edhe një dorë të fundit. Pastaj e lexoi me një frymë nga fillimi në fund dhe mbeti shumë i kënaqur me punën që kishte kryer. Aq shumë u ekzaltua, sa vajti të gjente vajzën që ta falenderonte për frymëzimin që ajo i kishte dhënë, por e kapën vëllezërit e saj dhe i dhanë një dru aq të shëndoshë, sa e bënë për spital. Por edhe kjo rrahje i shërbeu Aushit, sepse ai u ul dhe shkroi, tashmë, një novelë për dy vëllezërit dhe spitalin.

Për të përshkruar një femër të zhveshur, Aushi, ashtu siç bëjnë piktorët e vetmuar, paguante gra, që u kishin ndërprerë ndihmën sociale dhe për këtë shkak e shkonin jetën në mjerim të plotë. Sapo zhvisheshin, ai u ngulte vështrimin dhe niste të shkruante.

Njëherë, kur njëra nga këto femra po qëndronte e zhveshur para tij, Aushi vuri re që nuk i kishte pas prerë thonjtë e këmbëve dhe, veç kësaj, i vinte edhe një erë e keqe nga sqetullat. Aushi e detyroi të priste njëherë thonjtë, pastaj të hynte e të lahej në dush, pasi nuk donte që t'i përshkruante në letër këto gjëra të pakëndshme.

Njëherë tjetër ai eci dhe ndaloi mu në mes të një rruge ku kishte shumë makina dhe, për më tepër, lëviznin me shpejtësi. Ai desh i ta përplaste ndonjë makinë, që pastaj të shkruante një roman shumë tragjik, por ndodhi që shoferi i një kamioni frenoi mu para hundës së tij dhe kështu, ky projekt dështoi.

- O hu gardhi! - i thirri shoferi, pasi uli xhamin e derës

së makinës. - Si të erdhi kështu?! Ik më mirë e var veten, që të mos marrësh në qafë të tjerët.

Kurse para nja shtatë vjetësh, ai preku telin e korrentit dhe gati shkoi përlesh. E dërguan në spital për të vdekur, por arriti të mbijetonte. Pastaj, kur pas kësaj ndodhie u ul të shkruante, për çudi atij nuk i kujtohej asgjë. Shkroi vetëm një frazë: “*Rryma, ah, kjo rryma e elektrikut*”! Dhe ngeci. Nuk mundi të hidhte në letër as edhe një gërmë për bërë. Shtatë vjet kanë kaluar dhe Aushi ka ngecur po tek ajo frazë: “*Rryma, ah, kjo rryma e elektrikut*”!

Aush Loshi që, si të thuash, një dedektiv i letërsisë, një gjurmues të vërtetave të padiskutueshme, një spiun i stërvitur për të bërë zbulime të mëdha situatash reale. Një fotograf i paepur i mishmashit njerëzorë dhe i kapriçeve që sillnin ngaherë rastësitë e stisura. Në hapësirat mes fotografive gjendej teksti, i gjithi me shkronja kapitale.

Por le të kthehemi sërish te ndodhia e asaj dite.

Të gjithë sa u gjendën aty e panë shpirtin e Aushit: një si flakë e vobektë pranë hundës së tij, që luhatej të shuhej e nuk shuhej. Të pranishmit nuk dinin ç’të bënin me të. Në një çast u duk sikur u shua, sepse flaka e tij erdh’ e u zvogëlua aq shumë, sa mezi dallohej, por u shfaq sërish me një luhatje disi më të gjallërishtme. Sa herë flaka e shpirtit të tij gjallërohej e ngrihej, fytyrat e njerëzve ngazëllenin, zemrat mbusheshin me shpresën që Aushi do ia hidhte edhe kësaj here. Ja edhe pak dhe Aushi do të ngrihej ndenjtur e do të kërkonte të pinte, ta zëmë, një *red bull* për të marrë veten. Mirëpo, flaka e shpirtit të Aushit i la pa mend të pranishmit. Ajo as nuk shuhej, as nuk gjallërohej në masën e duhur.

Telefonuan ambulancën dhe pritën e pritën, por ajo nuk erdhi. Telefonuan sërish, por ata të shërbimit thanë që ambulanca ishte nisur, por kishte pësuar një defekt gjatë rrugës në ecje. Kësisoj, kaloi shumë kohë, derisa të pranishmit nisën të mërzhiten. I hidhnin vështrime njëri-tjetrit në kërkim të një zgjidhje. Ato vështrime shprehnin pakënaqësi, mërzi dhe lodhje. Nuk kishin as kohë, as durim ta prisnin aq gjatë Aushin të vdiste... Në fund të fundit, ai një shpirt i vetëm ishte, një shpirt si miliarda shpirtra të tjerë në botë. Nëse kishte për t'u shuar, le të shuhej shpejt; të dilnin nga kjo situatë dhe ata të flinin mendjen. Pastaj ca vite të mira i kishte në kurriz Aushi...

I hapën vend Tuxhar Topallit, që tha se mund tia ndiste sërish shpirtin duke i fryrë, ashtu siç i frymë zjarrit që të ndizet.

Me tu afruar pranë Aushit, që ishte shtrirë në dysheme, Tuxhari u ul në gjunjë dhe, si u mbush njëherë fort me frymë, i fryu aq fort flakës së shpirtit të tij, sa bashkë me frymën, nxori nga goja edhe një mori stërkalash pështyme. Në fillim u dëgjua vetëm një si cingëritje; si ajo cingëritja kur nga një kusi e mbushur me kungull që vlon, bien stërkala uji në zjarr; pastaj u pa një luhatje e vogël e flakës dhe... Flaka vazhdonte të digjej, kësaj here, pakëz më e gjallëruar; a thua se i kishin hedhur vaj të djegur, nga ai që u a heqin makinave për t'u futur një tjetër. Pritën edhe dhjetë minuta me shpresën se Aushi do të ngrihej, por ai nuk u ngrit.

Tuxhari i fryu sërish, kësaj here më fort; një herë, dy, tre, katër, shpejt e shpejt e pa pushim... Kur pa që nuk mundi t'ia dilte dot, ai tha:

- Për mendimin tim, ky është nga ata shpirtra që as nuk fiken, as nuk ndizen. Po deshët ngrohuni në të, sepse unë nuk i fryj më.

U largua duke ecur mbrapsht dhe qëndroi në të njëjtin vend ku ndodhej më parë.

Liza Piluri, bëri një provë: afroi gishtin e saj tregues dhe preku flakën e vogël, që dilte nga vrima e hundës së Aushit.

- Uau! - ia bëri ajo ndërsa e tërhoqi shpejt gishtin. - Të përvëloka! Poetë si ky me shpirt kaq të zjarrtë, zor se gjenden në faqe të dheut.

Deshi ta prekte edhe njëherë duke afruar gishtin e dorës tjetër, por nuk ia mbajti.

U kthye nga zonja Kaleme e tha:

- Provoje, provoje edhe ti njëherë...

Zonja Kaleme nuk deshë ta provonte. Teksa vështronte flakën e shpirtit që dilte nga vrima e hundës së Aushit, lidhi e trembur duart nga prapa, u përtyp njëherë, pastaj tha:

- Nuk është nevoja të preket me gisht, moj Liza... Duket ashiqare që të përvëlon. A nuk e shikon që është e kaltër si flakë oksigjeni?!

Akademiku Hashim Sholla u afrua sërish. Ai nisi të shpjegonte që flaka e shpirtit nuk ishte si flaka e një zjarri të zakonshëm. Sipas tij, ajo ishte një flakë më tepër hyjnore, që ngrohte, por nuk digjte, përndryshe njeriu do të bëhej shkumb nga brenda. Dhe që të përlligjte mendimin që shprehu, afroi gishtin e tij mu tek vrima e hundës së Aushit dhe preku flakën.

Duhet thënë, që akademiku Hashim Sholla kishte një gisht të madh, të trashë, gjithë kallo. Këto kallo atij ia

kishin krijuar miliona shfletime që ai u kishte bërë mijëra librave fletë për fletë.

- Shikoni! - tha ai ndërsa vazhdonte të mbante gishtin në flakë. - Nuk djeg, vetëm ngroh. Mirëpo pas disa çastesh, gishtit të trashë të Hashim Shollës filloi t'i dilte tymi i kallove që nisën të digjeshin. Ai e tërhoqi shpejt, rrahu gjuhën për qiellze e tha:

- Ncëk, ncëk, ncëk...! Sa e çuditshme!

- Eh, si digjet shpirti i poetit! - tha Liza dhe nxori një ofshamë të gjatë.

Marin Dermeku, deshi të afrohej e të ndizte te hunda e Aushit llullën e mbushur me duhan, por zonja Kaleme nuk e la.

- Ju lutem shumë! - tha ajo disi e nervozuar. -Të mos e banalizojmë si fenomen. Kijeni parasysh që kjo flakë kaq e ndritshme dhe kaq përvëluese buron nga shpirti i një poeti të madh, nuk buron nga një dru i ndezur shporetit! Ju lutem shumë!

Marin Dermeku u tërhoq i turpëruar.

U afruan dhe i frynë edhe të tjerë, një nga një, por pa rezultat.

- Mos u lodhni kot, - tha Tugjar Topalli. - Konkluzioni im numër dy më del që ky është një shpirt me zjarr të pashuar.

Ato çaste Liza Piluri iu "hakërrye" Tushit me shumë dashamirësi:

- Po ti, more djalë, ç'më rri ashtu si i trembur?! Oj, ky! Pa mblidhi njëherë forcat dhe fry edhe ti, se je në moshën më të bukur. Nuk thonë kot "*i riu si veriu*"! O të ndizet, o të shuhet fare, sepse edhe kështu...

- Por unë..., - ia bëri Tushi si i zënë në faj. - Nuk kam asgjë tepër të tjerëve...

- Ec aty, ec..., - i tha Liza. - Nuk paske asgjë tepër të tjerëve ti...! Pa ulu dhe provoje njëherë se ndoshta mund t'ia dalësh!

Tushi u afrua disi me përtesë dhe ra në gjunjë pranë kokës së Aushit. Pastaj, si u mbush njëherë fort me frymë, i fryu me fishkëllimë fiuuu.....

Me t'i fishkëllyer Tushi, flaka në fillim u zbeh, pastaj maja e saj u përkul mu si një pikëpyetje e tek e mbramja u shua!

Sa hap e mbyll sytë, hija e mortit ra mbi të gjithë.

Pushteti i vdekjes i bën njerëzit të heshtur e seriozë, ndaj duhej ulur koka e duhej përballuar situata me rregull e dinjitet.

Tani mund të lëviznin, ta mbyllnin këtë aktivitet, që nisi si festë e përfundoi si mort. T'i bënin Aushit një varrim dinjitoz, ku secili do të kishte rastin që, të paktën për kortezi, të demonstronte keqardhjen para Lilianës, gruas së tij të re e të bukur. Do të kishin rastin të demonstrosnin para saj edhe bujarinë, t'i hapnin zemrën, t'i afronin me devotshmëri shërbime nga më të ndryshmet për t'i lehtësuar disi dhimbjen; ta trajtonin me ngrohtësi, që ajo ta ndante me ata gjithë të keqen. Dhe të mirën, gjithashtu. Ta bënin që Liljana të mos ndjente dhimbje, por të ndjente dashuri; t'i jepnin asaj gjithçka, pra, gjithçka i kish pas dhënë Aushi, ditën dhe natën.

Pikërisht ato çaste, Tushin e mbërtheu një mendim i ngjethtë. Ndërgjegjja nisi ta brente si krimbi. Iu fiksua në mendje, sikur Aushi kishte vdekur për shkak të tij. A nuk i pati fryrë më fort se të tjerët flakës së shpirtit të Aushit? Ç'ju desh që i hyri asaj pune? Nëse Aushi do të vdiste, le të vdiste vetë. Ai i tha vetes, që njerëzit duheshin ndihmuar

për të jetuar, për t'i sjellë sërish në jetë kur ndodhen në grahmat e fundit; dhe jo t'i ndihmohet të japin shpirt. Kjo nuk ishte ndihmë. Kjo ishte vrasje, vrasje e bërë me paramendim në bashkëpunim me plot kriminelë të pashpirt, që gjendeshin rreth tij. Dhe këtë vrasje ai e kishte bërë në prani të gjithë atyre dëshmitarëve. Ndoshta, prandaj shefi i policisë Filip Zhuli e tërhoqi në një anë dedektivin Firun Çapërliu e nisi të bisedonte me të me zë të ulët. Çfarë po diskutonin? Mos ndoshta po bëheshin gati që ta arrestonin? Dedektivi Firun tundte kokën sa herë fliste Filipi. Çfarë udhëzimesh po merrte Firuni ato çaste? Nganjëherë, gjoja si krejt rastësisht, dedektivi Firun kthente kokën anej nga Tushi; e nganjëherë hidhte vështrime me bisht të syrit. Do ta arrestonin aty në sallë në prani të të gjithëve apo kishin vendosur ta prisnin kur të dilte jashtë? Ç'të bënte? Si ta rregullonte tani këtë punë. Çfarë pune?! Ky ishte një mëkat i madh, një krim monstruoz, peshën e të cilit, do ta mbante në kurriz gjithë jetën.

Dhe nuk do ia falnin kurrë, as Zoti, as ligji.

Ndërkohë, te porta e jashtme kishte mbërritur Azraili për të marrë shpirtin e Aushit, por e kishte ndaluar roja tek dera. Para se ta linte Azrailin të hynte brenda, roja i bëri ca pyetje njëra pas tjetrës. Azraili i jepte përgjigjet shpejt e shpejt se koha nuk priste dhe, pikërisht nga ky fakt, roja nisi të dyshonte më tepërt, ndaj vazhdonte ta rrekte me pyetje të tjera. Kuptohet, që kjo rrekte, ishte në favor të Tushit, prandaj duhej të vepronte, madje shumë shpejt.

Ashtu i tronditur siç qe, Tushi pyeti një kuqalash që gjendej pranë tij, nëse kishte shkrepëse ose çakmak.

- Jo, - tha kuqalashi duke dridhur pa shkak qerpikët. -



Nuk kam as shkrepse, as çakmak.

Dhe shtoi se nuk e pinte duhanin.

Ato çaste roja i shërbimit i mbaroi pyetjet dhe e la Azrailin të hynte në sallë... Kurse vetë u fut në kabinën e tij të vogël, ngriti receptorin e telefonit dhe i ra një numri.

Tushi u afrua pranë një burri shkurtabiq, i cili qe ulur në gjunjë dhe po lutej për shpirtin e të vdekurit. Iu duk fytyrë e njohur ky shkurtabiqi, por nuk i kujtohej ku e kishte parë. “Më duket se e quajnë Vedat”, - tha me vete ai. Pastaj u kujtua që ky Vedati punonte argjilën, bënte vazo dhe figurina kafshësh të ndryshme dhe, pasi i piqte, ua shiste të huajve që vizitonin Bibollin. Kur Tushi e pyeti nëse kishte shkrepse, Vedati bëri sikur nuk dëgjoi çfarë i thanë.

Atëherë Tushi, ngase koha nuk priste, thirri me sa fuqi pati:

- Në emër të Zotit më jepni shpejt një shkrepse! Më duhet një shkrepse, tani, në çast. Cili prej jush ka një shkrepse?

E panë me habi, sepse menduan që kishte luajtur nga fiqiri.

Tuxhar Topalli futi dorën në xhep, nxori një kuti shkrepeseje, ia zgjati e i tha:

- Ka brenda vetëm një fije. Provoje njëherë, ndoshta mbaron punë. Por cigaren dil e pije jashtë, se këtu nuk lejohet.

- Nuk e dua për të ndezur cigare, - tha Tushi. - E dua që të ndez sërish shpirtin e Aushit, këtij poeti të madh.

Ndërkohë Azraili kishte hyrë dhe po ecte drejt Aushit...

Me duart që i dridheshin Tushi nxori të vetmen fije të

shkrepëses që gjendej në kuti.

Merreni me mend vetë të dashur lexues, sa i tensionuar ishte Tushi ato çaste. Kishte në dorë një fije të vetme shkrepëseje dhe shprese! Jeta e Aushit varej tek ajo fije. E zëmë se u ndez fija e shkrepëses dhe mbajti flakë; po sikur, larg qoftë, të mos ndizej; ose të ndizej e të shuhej në çast? Dhe të mendosh që ato çaste Azraili, i cili kishte ardhur t'i merrte shpirtin Aushit, ndodhej jo më shumë se tre hapa larg! Por, a nuk bën Zoti nganjëherë mrekullira? Me ta fërkuar barotin në majë, fija mori zjarr dhe u ndez. Ishte pikërisht çasti, kur sapo mbërriti aty pranë Azraili dhe zgjati dorën të merrte shpirtin e Aushit për ta futur në torbë. Mirëpo Tushi u ndodh më i shpejtë se Azraili. Me njërën dorë ai shtyu fort Azrailin, i cili u rrëzua në dysheme bashkë me torbën ku kishte futur shpirtrat e të vdekurve të tjerë; kurse me dorën tjetër vendosi fijen e ndezur të shkrepëses mu te vrima e hundës së Aushit. Atëherë, në çast ndodhi mrekullia. Nga bira e hundës së Aushit u shfaq ajo flaka e kaltër. Shpirti i tij që ndezur sërish; madje ishte ngjallur më fort se më parë.

Poeti dhe prozatori Aush Loshi që rikthyer në jetë. Hapi sytë e tha:

- Kam pirë shumë alkool. Më duket sikur po më del flakë nga hundët.

- Gjithçka është në rregull, o zotni Aush, - tha Tushi. - Qetësohuni tani dhe mblidheni veten. Dhe, që të dëgjonte shefi i policisë Filip Zhuli, bashkë me dedektivin Firun Çapërlyu, Tushi ngriti zërin e shtoi: - Ishte thjesht një gjendje të fikëti...

Ky ka qenë një nga momentet më të jashtëzakonshëm,

që edhe sot e kësaj dite përmendet në Biboll. Të gjithë sa ndodheshin aty shtangën nga habia. Asnjëherë nuk kishte ndodhur të ngjallej një i vdekur me një mënyrë kaq të thjeshtë.

Aushi u ngrit ndenjtur, hodhi një vështrim të hutuar rreth e rrotull si të qe në kërkim të dikujt, pastaj pyeti:

- Cili ishte ai burri që pak më parë ndodhej këtu dhe që pastaj iku me vrap?

- Për cilin burrë po flisni? - pyeti Tushi.

- Ai që zgjati dorën drejt meje dhe ti e shtyve dhe e rrëzove në dysheme.

- Ai qe një lypës... - Tha Tushi. - Zgjati dorën t'i falje gjësend, por e përzura. Janë bërë shumë të bezdisshëm...

- E pashë si në ëndërr..., - tha Aushi. - Mbante edhe një torbë në shpinë.

- Lypësat ashtu e mbajnë, - tha Tushi.

- Ato çaste kam qenë më shumë në qiell se në tokë, - tha Aushi. - Do t'i kisha dhënë ç'të donte. Madje, edhe shpirtin. Të paktën, t'i kisha lënë në dorë një libër me autograf....

Dhe, si u mbush njëherë me frymë, hodhi një pyetje, që tingëlloi më fort si akuzë:

- A u mbarua krejt kukureci?!

- Ç'thua kështu, zoti Aush?! - tha Tushi. - Kukurec ka sa të duash. Vetëm të jesh mirë e të kesh oreks për të ngrënë.

Dhe i vendosi përpara një pjatë të mbushur plot.

Aushi nisi të hante shpejt e shpejt, si i babëzitur duke e mbushur gojën shumë. Tushi e qortoi me dashamirësi:

- Ju lutem, Zotni Aush, merreni ngadalë. Mos e mbushni gojën shumë dhe kukurecin përtypeni mirë. Duhet të kishit

ngrënë një herë, pastaj të vinit këtu. Nuk bën, që një poet i madh si ti, një *patrik* i letrave, të përmbushë nevojat shpirtërore për mijëra lexues të Bibollit. Kurse për veten e tij, të lërë pas dore përmbushjen e nevojave biologjike. Në fillim biologjia, zotni Aush, pastaj vjen poezia.

Ato çaste u dëgjuan zëra që vinin nga jashtë. Dikush bërtiste me zë të lartë, urdhëronte një tjetër të hapte torbën pasi donte t'i bënte një kontroll. Të pranishmit u afruan pranë dritareve të sallës që të shikonin nga brenda çfarë po ndodhte jashtë. Disa qenë më kuriozë, dolën nxitimthi nga salla që të merrnin vesh më mirë mbi ndodhinë. Edhe Tushi e la Aushin të hante dhe doli të shikonte.

Roja e shërbimit kishte dyshuar në Azrailin. Ai e kishte marrë atë për kontrabandist. Sapo Azraili që futur brenda në sallë, roja kishte lajmëruar menjëherë me telefon inspektorin e kontrollit të shtetit, Baki Dallkaku, të cilin e kishte djalin e tezes.

Inspektori i kontrollit të shtetit, Baki Dallkaku, e kishte ndaluar Azrailin teksa dilte dhe donte t'i kontrollonte torbën ku ai mbante shpirtrat e të vdekurve.

- Hape torbën, të shikojmë çfarë malli ke futur aty brenda, - urdhëronte inspektori.- Mos ke vjedhur ndonjë gjë dhe e ke fshehur në torbë?

- Ju betohem, që nuk kam vjedhur, zoti inspektor, - thoshte Azraili. - I rashë rreth e rrotull Bibollit dhe mblodha ca shpirtra njerëzish... Kaq mund të them. Aty në atë sallë, u futa sepse më erdhi sinjali për t'i marrë shpirtin një njeriu të njohur, një poeti të madh, por për shkak të rrethanave jo fort të përshtatshme nuk e mora dot dhe u largova. Kjo është puna që bëj unë.

- A keni ndonjë autorizim nga organet kompetente për ta bërë këtë punë? - pyeti inspektori i kontrollit të shtetit teksa përpiqej t'i zgjidhte grykën thesit.

- Çfarë autorizimi, o shef?! - pyeti Azraili. - Kam licencën. Vetëm ajo më duhet mua.

- A i ke faturat e shpirtrave që ke në thes, zotëri? - pyeti Bakiu. - Dua t'i shikoj, faturat dhe licencën.

- I kam, patjetër që i kam, - tha Azraili.

Nxori nxitimthi një deng me fatura dhe bashkë me licencën ia la në dorë inspektorit.

- Ja ku i ke, o shefi, - tha ai.

Inspektori i kontrollit të shtetit nisi t'i vështronte dokumentet një nga një me shumë vëmendje.

Ndërsa ai shfletonte dokumentet, Azraili ia nguli sytë orës që mbante në dorë inspektori Baki. Eh, çfarë ore që kishte inspektori i shtetit! Një orë të madhe sa një patkua kali; një orë me skelet floriri, që nuk i gjendej shoqja mbi dhë, sepse qe prodhuar jashtë serie. Baki Dallkauku e kishte blerë duke i kursyer lekët nga rroga që merrte... Pa prisni...! Jo, jo. Tani po kujtohem, që këtë orë ai nuk e kishte blerë vetë, por ia kishte bërë dhuratë pronari i pularisë me shumë emër Hilë Kakarriqi. Pra, me kursimet e pakta, ai nuk kishte blerë orën, por kishte blerë zinxhirin e trashë të floririt që mbante në qafë e që i kishte shumë hije... Tani, më falni, sepse m'u bë mendja ujem dhe nuk di ç'flas. Si më doli mendsh, që edhe zinxhirin e florinjte atij ia pati falur drejtori i gazetës e njëkohësisht bos i "Diging company", Faruk Bariu? Po çfarë bleu, vallë, inspektori i shtetit, duke kursyer lekë nga rroga? Sepse, si të gjithë shtetarët e posteve të rëndësishme, edhe ai duhet ta ketë

blerë ndonjë gjë me kursimet e tij të pakta e që ne tani nuk e kujtojmë dot... Fundja, a duhet të na kujtohet patjetër? Më mirë po u varim teneqen këtyre detajeve të parëndësishme dhe kthehemi sërish tek boshti kryesor i rrëfimit.

Si u hodhi një sy dokumenteve duke i shfletuar me kujdes, inspektori Baki zbuloi që licenca për *shpirtmarrje* i kishte skaduar Azrailit qysh para tremijë vjetësh. Veç kësaj, Azraili nuk kishte paguar as taksë për ushtrimin e këtij biznesi, as taksë për vlerën e shtuar të mallit. Madje ai i bëri me dije që duhej paguar edhe taksa mbi ambalazhimin, të cilën Azraili nuk e kishte paguar. .

- Çfarë ambalazhimi, o shef?! - pyeti i habitur Azraili.  
- Unë shpirtrat që marr nuk i ambalazhoj, i mbaj rifurxho, të gjithë në një thes. Përse u dashka të paguaj një taksë të tillë?

Inspektori i shtetit Baki Dallkauku e kundërshtoi. Ai i tha Azrailit që disa shpirtra njerëzish të thjeshtë, siç janë bujqit, peshkatarët, blegtorët dhe punëtorët e varfër, mund t'i mbante të gjithë bashkë në një thes pa i ambalazhuar. Por shpirtrat e njerëzve që bënin pjesë në parinë e Bibollit, sidomos ato të politikanëve, duheshin ambalazhuar medoemos. Të gjitha këto ishin sanksionuar me ligj.

- Ato duhen ambalazhuar, zotëri, - tha inspektori. - E thotë ligji, nuk e them unë.

- Në praktikën e punës time, - nisi të shpjegonte Azraili, - rregulli ma do që shpirtrat e njerëzve që bëjnë pjesë në pari e që shesin dokrra e bëjnë kakërdhi, t'i groposi thellë në tokë. Të njëjtën gjë unë bëj edhe me pronarët e partive politike. Nëse nuk groposen thellë, atëherë ndotet ambienti. Bakterie si *koçobacili*, *megalokoku*, *corraptokoku*,

*pordhanomiceti, kriminomiceti, luksokoku, legenobacili, bordellonomiceti* dhe shumë të tjerë, që ushqehen me djersën dhe gjakun e popullit, mund të përhapen gjithandej dhe të ndodhë në Biboll ndonjë katastrofë ekologjike.

Inspektori i shtetit bëri sikur nuk i dëgjoi këto fjalët e fundit të Azrailit.

Duke rrëmuar në thes ai gjeti edhe dy shpirtra që kutërbonin një erë të rëndë, të padurueshme.

- Po këto, përse i mban në torbë? - pyeti inspektor Bakiu. - Nuk e ndjen çfarë ere muti u vjen?! Të qelbin fare...

- Ke të drejtë, - tha Azraili si i zënë në faj. - Por nuk di ç'të bëj me ta, o shef. Këta janë shpirtrat e dy ish drejtuesve të lartë të shtetit, që kanë bërë shumë krime e zullume. As Zoti, nuk i mbajti. Nuk deshi t'i fuste as në tharkun ku mban shpirtrat e derrave që theren në Biboll e që ndodhet diku në hapësirën mes Venusit dhe Marsit.

Njërit prej ish mbajtësve të këtyre shpirtrave i kishin ngritur edhe një monument diku pranë sheshit të Bibollit.

- Si do ia bëjmë, o byrazer? - pyeti Baki Dallkauku, teksa nisi të kruante hundën.

Tani që inspektori nuk e thirri *zotëri*, siç bëri më parë, por e thirri *byrazer*, Azraili e kuptoi menjëherë se ku rrihej muhabeti.

- Si të duash e bëjmë, o shef, - tha ai. - Unë jam gati...

- A e di ti, o byrazer, sa është gjoba? - pyeti sërish inspektori.

- E di, - tha Azraili. - Por puna është, o shef, se unë nuk di ku paguhet gjoba.

- M'i fut shpejt paratë në xhep, sepse merrem unë me

pagesën, - tha duke folur me zë të ulët inspektori i kontrollit të shtetit.

Azraili i doli inspektorit përballë, që ta mbulonte për të mos qenë i ekspozuar prej vështrimeve të njerëzve, pastaj nxori një dhjetë mijë lekëshe, e fshehu mes gishtave dhe ia futi në xhep. Kjo që një punë shumë e lehtë, sepse inspektori Baki kishte xhepa aq të mëdhenj, sa mund të fshihte aty brenda një dosë të madhe bashkë me dymbëdhjetë gica e të mos i vinte rë askush.

Kur futi dorën në xhepin e pantallonave të inspektorit të shtetit, Azraili kuptoi me të prekur që xhepi ishte plot me para. Me shkathtësinë e një zhongleri Azraili i la në xhep dhjetë mijë lekëshin dhe nxori prej aty një kartëmonedhë njëqind dollarëshe, të cilën e fshehu menjëherë në mëngën e xhakëtës.

- Ik tani, o byrazer, - e urdhëroi inspektori Baki Dallkauku duke i kthyer dokumentet. - Dhe bëj kujdes me punën. Mos luaj me shtetin. Merre seriozisht, sepse herë tjetër nuk të fal.

Azraili e falenderoi inspektorin duke u përkulur. Mori dokumentet, hodhi torbën në sup dhe u largua.

- Ky mut-muti! - tha me vete Azraili teksa nxirrte nga mënga kartëmonedhën njëqind dollarëshe për ta futur në xhep.



Poeti Aush Loshi hëngri sa u ngop dhe e mblodhi veten. Madje, ai u kërkoi ndjesë të pranishmëve për shqetësimin që u kish sjellë në mes të këtij aktiviteti. Gjithashtu, ai tha se u ishte shumë mirënjohës të gjithëve sa kishin ardhur aty për të ndarë së bashku këtë gëzim kaq të madh, që të jep botimi i një libri.

Fill pas fjalëve të tij, u dëgjuan duartrokitje. Pastaj ca me ngutje e ca të tjerë ngadalë e me takt, u afruan pranë tryezave të shtruara që të merrnin ndonjë gjë për të ngrënë e për të pirë.

Kishte aty të haje çfarë të donte e bardha zemër: sallam derri dhe viçi, djathë të bardhë, djathë të verdhë, djathë të mykur nga ai i shtrenjti, por edhe shumë lloje kaçkavallesh; kishte salsiçe me majë mu si lapsa të mprehur; qofte si stilografë të trashë akademikësh, që mund t'i ngjyeje në salca lloj-lloj ngjyrash; byrek me gjizë, në daç në formë trekëndëshi, në daç drejtkëndësh e të trashë sa një bllok shënimesh; në daç në formë kulari të përdredhur. Kishte vezë të ziera, në lëvozhgat e të cilave qenë shkruar me kujdes, shumë bukur titujt e librave të botuar nga poeti i madh Aush Loshi. Kishte mashurka të njoma, tarator me

kastravecë, bakllava, kadaif, hasude... Harruam të themi, që aty pati edhe një asortiment shumë special: zorrë të trashë të mbushur me qull. Gjë e rrallë kjo edhe për mjeshtërit më të mëdhenj të kuzhinës e jo më për të pranishmit e uritur që gjendeshin aty.

Tushi hëngri dy nga këto zorrë dhe mbeti shumë i kënaqur. Ai ia vuri syrin edhe një zorre të tretë. Zgjati dorën dhe qëlloi që e kapi në të njëjtën kohë me Faruk Bariun, botuesin e një gazete, një burrë ky, që vlerësonte shumë dy gjëra: promovimet e librave me të ngrëna e me të pira si dhe shoqërinë me udhëheqës të lartë shtetërorë. Ngase e kapën dhe e tërhoqën të dy në të njëjtën kohë, zorra u këput në mes dhe secili hëngri nga një gjysmë. Megjithatë, botuesit Faruk, gjysma që hëngri Tushi iu duk më e madhe, prandaj dhe psherëtiu njëherë i pakënaqur e foli nëpër dhëmbë diçka si “T”ëmën e sëmës si është bërë mileti”.

Gjatë gjithë kohës poeti Aush Loshi edhe hante e pinte me oreks, edhe dhuronte libra me autograf.

Sapo merrte librin për t’ia lënë në dorë ndonjë të pranishmi, ndërsa përtypej, ai pyeste:

- Më falni, si e keni, du me thanë, emrin, që ta shkruaj...? Po mbiemrin? Oooo...! Më duket se jemi parë diku. Si? Nuk njihemi? E-po, ja që u njohëm tani.

Dhe buzëqeshte shumë i kënaqur.

Si shkruante në fletën e parë autografin që gjithmonë niste me “*Fort të nderuarit, më të dashurit dhe të sjellshmit, mikut tim të mrekullueshëm....*”, ia linte librin në dorë, gëlltitej sërish dhe shtonte:

- E di që jeni, du me thanë, shumë i zënë me punë, por është mirë ta lexoni, du me thanë, sa më shpejt. - merrte një

salsiçe, e kafshonte dhe, duke u përtypur, vijonte: - Gjërat e mira nuk lihen të ftohen... Si ta lexoni njëherë, mund ta merrni me vete kur të shkoni, du me thanë, në plazh dhe ta lexoni atje për së dyti. Jepjani edhe gruas dhe kalamajve ta lexojnë. Pastaj me radhë komshinjve, dajave, tezeve, hallave; du me thanë, njerëzve që njihni. Do kënaqeni të gjithë.... Dhe do më kujtoni, du me thanë.

Nganjëherë, ai shpjegonte:

- Me thënë të vërtetën, gjatë leximit të pjesës së parë kërkohet, du me thanë, pak durim, sepse edhe fillimi i një libri, ashtu si çdo fillim tjetër, ka shtërzimet e veta, por pastaj ecën mirë... Du me thanë, keni për ta parë vetë.

Një herë ai u mallëngjye aq shumë, sa iu mbushën sytë me lot. Kjo ndodhi kur iu afrua karrocieri Mark Pati, për të cilin flitej se i hynte natën në shtëpi vejtshës Liseta Blumi, duke u shtirur sikur ishte i shoqi i saj i vdekur. Markun e zinte shpesh lemza. Para një viti iu vra kali në një aksident. E goditi Brahim Çadërbashi me makinën e tij të markës *Lamborgini*. Që nga ajo kohë ai qe i detyruar ta tërhiqte vetë karrocën, kuptohet jo në rrugë të largëta. Kur i duhej të betohej, ai betohej në shpirtin e kalit, të cilin e pati dashur shumë. Edhe pse po e ngacmonte shumë keq lemza, karrocieri i tha:

- Profesor! Të betohem në shpirtin e kalit, që ti je poeti më i madh i të gjitha kohërave. Hih...! Më fal, profesor, sepse dikush po më përmend dhe më zë, hih..., lemza. Ju keni bërë aq shumë letërsi, hih..., sa i keni shkërdhy nanën. E keni tejkalu planin, hih..., katërfish. Sa herë e dashura ime merr e lexon blegërimat e tua të dashurisë, hih..., ajo nis e qan prej emocioneve, që i shkaktojnë ato. Atëherë

unë, e marr me të mirë, hih..., e më duhet ta gënjej duke i thënë që libri yt, nuk ban hiç-hiç-hiç..., hih..., ndryshe, ajo nuk pushon. Mund të qajë edhe një njëzetë ditë rresht... Të betohem në shpirt të kalit, që..., hih, kam rënë në hall!

- Faleminderit i dashur, - tha poeti Aush Loshi. - Më preke pamasë me këto fjalë... Edhe nga lemza jote u preka thellë, sepse po shikoj që të mundon shumë. Edhe për kalin... Du me thanë, mund të shkruaj edhe një poemë me blegërima hidhërimi për ngordhjen e kalit tënd, që ti e ke dashur, du më thanë, aq shumë. - Dhe fort i mallëngjyer e ftoi të hante. - Zgjateni dorën dhe merrni... - tha ai ndërsa fshiu me kollare një lot, që për pak do t'i kishte rrëshqitur për faqeje. - Hani, du me thanë, ndonjë ëmbëlsirë se ka sa të duash. Merrni ndonjë kallëp bakllava ose kadaif, ose hashure. Nuk ju pëlqejnë të ëmblat? Atëherë merrni një zorrë të trashë të mbushur me qull, se janë shumë të mira. Merrni, pra... Ndoshta... Du me thanë, do ju bëjë mirë edhe për lemzën.

- Po marr, po marr..., hih...! - tha Marku me lemzën që e mundonte. Dhe si përlau një zorrë të trashë të mbushur me qull, ndërsa përtypej, vijoi:

- Unë, profesor, hih..., do ua dija shumë për nder nëse shkruani edhe një libër me blegërima emocionuese në adresë të qeverisë, hih..., që ta bëni të na kthejë, hih..., pronat e grabitura.

- Sërish me preke, o zotni Mark, por ndoshta... Du me thanë... Të them të drejtën, nuk kam shumë kohë ... - tha Aushi, sepse u kujtua, që shtëpinë e vet e kishte ndërtuar në tokën e një tjetri. - Pini pak ujë të gazuar, ndoshta mund t'iu pushojë lemza.

Dhe i zgjati një shishe plastike.

- Oh, jo, jo, hih..., - kundërshtoi karrocieri. - E di unë ngase e kam... Më përmend deputeti i zonës, hih..., shoku Eshref. I rri mendja tek unë, ngase, qysh kur më ngordhi kali, jam pa punë, hih..., dhe kam shumë halle, ndaj dhe më përmend. Edhe ai i shkreti, hih..., ka rënë në hall të madh, nuk di ç'të bëjë, që të më shikojë sa më mirë.

Ato çaste pranë Aushit u afrua me shumë ndrojtje një vajzë e re dhe e kolme. Kjo vajzë kishte një nishan në faqe, si dhe një dhëmbë të thyer në pjesën e dukshme të gojës. Kishte veshur një bluzë të hollë farfuritëse që i shkonte fort me minifundin, që linte të zbuloheshin ca shalë të plota e të bukura. Në dorë ajo mbante një tufë me letra.

Ishte Lushja.

Tushi u pataksh kur e pa, sepse nuk e priste ta shikonte aty. Edhe Lushja e pa mirë Tushin. Teksa ecte në drejtim të poetit Aush Loshi, ajo i hodhi Tushit një sy kalimthi duke perënduar ato sytë e saj vërtet të bukur. Përtypte çamçakëz dhe herë-herë bënte sikur largonte me dorë një cullufe flokësh që i binte mbi sy. Kishte marrë me vete edhe qenin e saj, që ajo e thërriste “*Zoti president*”.

*Zoti president* kishte një turi të shkurtër e si me lara, një bisht që e mbante të kthyer krrut kur ecte si dhe një vesh e gjysmë, pasi gjysmën e veshit të djathtë ia kishin pas këputur kalamajtë e lagjes kur ishte i vogël. Ai sillej me njerëzit si një xhentëlmen, përpiqej t'i kënaqte të gjithë me atë vështrimin e tij të butë prej qengji duke kthyer kokën herë nga njëri, herë nga tjetri.

Një herë ai e ktheu kokën edhe nga Tushi dhe e vështroi me shumë vëmendje duke ngritur veshët përplotë, pasi u kujtua që e kishte parë. E kishte parë sa herë Tushi që ngulur përballë shtëpisë së Lushes për të lëshuar në adresë të saj ato blegërimat prekëse të dashurisë së tij. Por Lushja e qortoi, pastaj e tërhoqi lehtë për zinxhiri.

Ky qen ishte shumë i dashur me njerëzit. Ai kishte shumë qejf t'u lëpinte atyre gishtat e duarve dhe fytyrën.

Lushja deshi t'i jepte Aushit një cikël me blegërima dashurie, që t'ia lexonte. Këto blegërima me rimë, ajo tha se i kishte shkruar gjatë këtyre ditëve, kur një djalë që ngulur përballë shtëpisë së saj dhe blegërinte për t'i rrëmbyer zemrën.

- A mund të më thoni, du me thanë, si e keni emrin moj zoçkë? - e pyeti Aushi.

- Lushe, - tha ajo. - Lushe Çadërbashi.

- Lushe?! Sa emër i bukur, moj! Ku e paskeni gjetur, du me thanë, kështu, këtë emër?

- Ma ka gjetur halla, - shpjegoi Lushja. Dhe qeshi duke kthyer paksa kokën nga Tushi.

- Uaaa! Çfarë mrekuillie! - ia bëri Aushi. Dhe që të mos e merrte mësysh, preku njëherë me dorë hundën e vet.

- Nëse do m'i lexonit e do më jepnit një mendim, do më bënit shumë nder, - tha Lushja si me të lutur, ndërsa i zgjati fletët, që mbante në dorë.

- Patjetër, që do t'i lexoj, - tha Aushi. - Ç'është ajo fjalë, moj Lushe?! Kurse mendimin tim për blegërimat e tua, mund ta jap qysh tani, sepse ju, du me thanë... Dukeni nga pamja, marshalla; një poete e kompletuar, që nga koka e gjer te këmbët.

Ato çaste, *Zotin president* e pushtoi një dyshim. Ai i ktheu Aushit prapancën dhe tendosi bishtin në drejtim të tij. Ishte mu si ai gjesti që bëjnë nganjëherë në gjykatë dëshmitarët kur i vënë gishtin ndonjë kriminel, që mohon akuzat sepse nuk ka qejf të dënohet.

Lushja e tërhoqi lehtë si e zënë në faj dhe qeni u rrotullua sërish në pozicionin e parë. Iu afrua Aushit dhe nisi t'i nuhaste majën e këpucës së djathtë, pikërisht në vendin ku qe shqepur e qepur sërish te këpucari.

Aushi u zu ngushtë dhe zgjati dorën ta përkëdhelte.

*Zotit president* nuk i erdhi mirë që Aushi deshë ta përkëdhelte, pikërisht në çastet kur ai ndodhej në krye të detyrës dhe donte të bënte me nuhatje një investigim prej

qeni dedektiv. Ai donte të nuhaste për të kuptuar cilës shtrese shoqërore i përkiste Aushi? A ishte larë tani shpejt apo kishte nja pesë muaj pa u larë? Përdorte shampo apo përdorte sapun? Me çfarë lloj paste rruhej? Pasi rruhej, dezinfektohej me livando apo me raki kumbulle? Sa kohë kishte pa i ndërruar të brendshmet?

Aushit, ky qen, iu duk i zgjuar dhe me shkollë, ndaj vendosi ta merrte me të mirë, ta kompromentonte me një lëvdatë.

Ashtu siç bëjnë rëndom njerëzit e rangut të lartë, Aushi u mendua një copë herë në kërkim të fjalëve të mëdha, që lëvdata të kishte brenda edhe poezi edhe filozofi, edhe shkencë, por ngase nuk gjeti dot një të tillë, tha:

- Marshalla, sa qen i shkolluar!

*Zoti president* nuk arriti të përcaktonte saktë veç e veç të gjitha llojet e erërave, që buronin nga trupi i tij, ndaj hungëriu prej dëshpërimit. Por kur Aushi i dha gishtat t'ia lëpinte, ai u qetësua shpejt dhe vendosi ta bënte mik. Ngriti këmbën e pasme, që t'i linte si markë erën e shurrës së vet. Mirëpo, ndërhyri Lushja, e cila i la qenit të kuptonte që nuk bënte të ngutej, pasi njerëzit nuk njiheshin që në takimin e parë.

Lushja i shpjegoi Aushit që *Zoti president* ishte i sjellshëm, por jo i shkolluar. Ai nuk kishte pasur mundësi të merrte ndonjë bursë studimi për në *Shkollën e qenve*, sepse kishte qenë i persekutuar. Njëmbëdhjetë vëllezërit e motrat e tij i pati mbytur regjimi në lumin e Bibollit për një shkak që do ta rrëfejmë më poshtë. Kurse vetë *Zoti president* qe rritur jetim dhe, për më keq, në ilegalitet, sepse lagjja ku banonte kishte pasur ca fëmijë fort të prapë. Aso kohe



ata vdisnin ta shkëpusnin nga toka *Zotit president* duke e kapur me dy gishta për njërit vesh. Jo vetëm që e ngrinin lart në ajër, por e mbanin kështu pezull, derisa t'i shpëtonte shurra. Shurrosja si akt i pavullnetshëm i *Zotit president* ishte caku më i lartë i triumfit të tyre. Kjo lloj zbavitje, që aso kohe ishte bërë një sport krejt i zakonshëm, bëri që një ditë *Zotit president* t'i këputej gjysma e veshit.

*Luçia*, e ëma e *Zotit president*, kishte pasur një histori shumë të dhimbshme. Kjo histori niste qysh ditën kur i zoti e përzuri nga shtëpia, sepse i ra zgjebja.

Pas shumë javësh endje rrugëve të Bibollit në kërkim të ushqimit, një ditë, fare rastësisht, *Luçies* i ra rruga nga godina ku gjendej salla e mbledhjeve dhe që bibollasve u pëlqente ta quanin *parlament*. Aty ajo u takua dhe zuri miqësi me Lulushen, nënën e Lushes, që punonte si pastruese e “*parlamentit*“.... Tani do t’i lutesha lexuesit të bëjë durim e të na mirëkuptojë, pasi do na duhet të shkëputemi për pak çaste nga kjo linjë rrëfimi, që të bëjmë një parantezë të shkurtër, ku të shpjegojmë se si ndodhi që Lulushë Çadërbashi, bosja e punishtes së tjerrjes së leshit dhe thurjes së qilimave u ktheu në pastruese.

Dy vitet e para biznesi i tjerrjes dhe thurjes së qilimave pati shkuar mirë dhe familja Çadërbashi arriti të grumbullonte të ardhura të majme. Por, kur në Biboll hyri një modë e re arredimi shtëpish, shitja e qilimave pësoi një rënie drastike dhe ky biznes falimentoi. Atëherë Lulushja ia shiti punishten një të huaji, i cili e ktheu në punishte pijesh freskuese.

Me paratë që mori nga shitja e punishtes, Lulushja bleu

një makinë *Lamborghini* si dhe bëri një xhiro nëpër Evropë, që zgjati plot katër muaj.

Dy ditë pasi që kthyer në Biboll, ajo ia dha *Lamborghini* të shoqit të saj, Brahimit, i cili u nis të shkonte në një drekë synetlliku. Rrugës, ngase që i pirë, e përplasi makinën me karrocën e Mark Patit. Pas përplasjes me karrocën dhe kalin, makina doli nga rruga dhe vajti e i ra një furre të ndezur gëlqereje, ku mori flakë në pjesën e përparme.

Brahimin mundën ta nxirrnin shpejt nga makina dy punëtorët e furrës së gëlqeres. Pastaj ata, si shuan flakët, e tërhoqën makinën me një kamion dhe e larguan që aty.

Nga ky aksident i papritur Marku theu dy brinjë, kurse kali ngordhi në vend.

U hap një gjyq, i cili zgjati muaj të tërë dhe që në fund Brahimi e humbi. Ai u detyrua t'i dëmshpërblente Markut vlerën e kalit, si dhe një dorë të mirë parash të tjera për dy brinjët e thyera.

Ngase *Lamborghini* që dëmtuar aq keq sa nuk mund të riparohej, Lulushja e vendosi diku në kopsht, në një vend të rrethuar me rrjetë teli ku ajo rriste pula, pata dhe lepuj. Pulat e morën këtë prurje si një investim për ta, ndaj nisën të hynin brenda përmes xhamit të thyer e t'i bënin vezët në sedilje. *Lamborghini* u kthye në një kotec aq modern, sa pulat nuk e kishin ëndërruar ndonjëherë.

Një gjel kokorosh e pendëkuq hiqej me të madh, teksa mbante aty rregull duke vendosur radhë mes pulave, që nxitonin të uleshin për t'u rehatuar në sediljet e kthyera në furriqe. Nganjëherë, ky gjel, ngjitej krenar sipër *Lamborginit*, rrihte flatrat dhe i këndonte mbretërisë së tij të re e të veçantë. Menjëherë pas këngës, i hidhte haremit

një vështrim kodoshi për të zgjedhur pulën që deshte. Pasi i vinte syrin më të mirës, e ndillte me zë duke bërë sikur po i tregonte një kokërr misri. Me t’u afruar pula, ai bënte një rrotullim të shpejtë, rrihte tre herë paf, paf, paf, njëren flatër, e kapte pulën me sqep për lafshe dhe i kërcente në shpinë. Dhe, pasi ia bënte atë punë vetëm në dy sekonda, largohej triumfalisht duke u kokoroshur.

Vezët, Lulushes ia blinte pronari i “*Potirit*”, Fazil Krosi. Fazili, i futi ato vezë në menunë e lokalit dhe ua servirte klientëve si “*vezë lamborgini*”. Sa herë e pyesnin klientët për menyne, ai thoshte: “Kemi mish të pjekur, qofte të zgarës, kukurec, si dhe spinaq me vezë *lamborgini*”.

Familja Çadërbashi u rrënuar ekonomikisht pikërisht nga kjo ndodhi dhe Lulushja, që të mbijetonte, u detyruar të fillonte punë si pastruese, sepse ajo, as nuk kishte kryer ndonjë shkollë dhe as nuk kishte mësuar ndonjë zanat për gra.

Tani, le të kthehemi sërish tek *Luçia*.

Lulushja kishte dalë të hidhte në kazan plehrat e radhës kur i zunë sytë *Luçien*. Iu afrua si ta njihte qyshkur, sepse iu dhimbs që në shikim të parë. E mori me të mirë dhe e ushqe.

*Luçia* gjeti te pastruesja ushqim të mjaftueshëm si dhe dashuri pa kushte. Veç kësaj, Lulushja, se nga gjeti një ilaç, me të cilin i leu trupin dhe e shëroi nga zgjebja.

E gjendur mes dashurisë dhe përkujdesjeve të Lulushes, *Luçia* vendosi të banonte përgjithmonë pranë “*parlamenti*”.

Dalëngadalë *Luçia* zuri miqësi edhe me shumë kuadro të pushtetit, që kishin zyrat aty, të cilët, asnjëherë nuk i ngjisnin shkallët pa i dhënë gishtat që t’ua lëpinte. Shumica

prej tyre ishin shumë njerëzorë e të dashur me *Luçien*. Çdo ditë e përshëndesnin: “Mirmëngjes *Luçia*“. Ose: “Hajde këtu *Luçia*! Pa na thuaj ke ndonjë hall për të zgjidhur“? Ndodhte, që bënin me të edhe ndonjë shaka, pa të keq, kuptohet. Ndonjëri e qortonte duke i tundur gishtin: “Mos bëj gabim *Luçia* të ndërrosh parti, siç bëjnë disa prej nesh.” Dhe qeshnin. Madje, deputeti Eshref Kaçorri doli shumë herë edhe në fotografi me *Luçien*. Me këto fotografi ai bëri një album, të cilin në raste festash dhe takimesh të rëndësishme, por edhe kur hynte në parlament, ua jepte miqve ta shfletonin për ta parë.

*Luçia*, si kafshë që ishte, nuk i kuptonte fjalët që i thuheshin, por i nxirrte konkluzionet me intuitë, duke vëzhguar fizionominë e tyre, mënyrën si flisnin, gjestet dhe intonacionet e zërave që dëgjonte. Për gjithçka pëlqente, ajo luante bishtin, lëpinte buzët me gjuhë ose bënte ndonjë kërcim gazmor. Nëse silleshin keq me të, ulte kokën, varte veshët dhe bënte sikur po nuhaste tokën. Kësisoj, *Luçia* u jepte të kuptonin se duhej ta linin rehat.

Në të ftohtë, gjatë dimrit, rrinte prapa godinës ku ndodheshin zyrat e pushtetit. Si ngopej mirë me ushqim, mbledhej kutullaq pranë një tubi të madh kaldaje dhe rrinte në paqe; kurse verës, shtrihej në hije poshtë makinave të zyrtarëve të shtetit.

Hamza Mokra, një studiues i pasionuar, që merrej me zbulimin e historive të pashkruara të qenve-vipa, zbuloi se *Luçia* rezultonte stër-stër-mbesë e një qeni gjerman, mastif i viteve njëmijë e pesëqind, i cili, na paskësh qenë përdorur për të ndërsyer demat. Nga brezi në brez, për shkak të abuzimeve seksuale, që të parët e saj bënë me disa kodoshë rrugësh, gjaku

i kësaj race kishte ndryshuar shumë, derisa një natë, *Luçia*, u mbars me vëllanë e saj të madh dhe polli dymbëdhjetë këlyshë bastardë, mes të cilëve edhe *Zotin president*.

Duke qenë se Lulushja, si dhe i shoqi i saj, Brahimi, qenë të pakënaqur me stafin qeverisës të vendit, ata vendosën ta ngushëllonte veten duke krijuar vetë një staf qeverisës. Secilit nga këlyshët që kishte pjellë *Luçia*, ata i dhanë mandatin për të drejtuar një ministri përkatëse. Këlyshit më të mirë, - atij që ia kish pas lëpirë gishtat para se të tjerët të hapnin sytë për të shikuar, - Lulushja i kishte dhënë postin e presidentit. Edhe pse kjo pati qenë thjeshtë një shaka e dalë nga imagjinata e fantaksur e Lulushes, rezultoi me pasoja të rënda.

Orvatje për të krijuar një qeveri në hije me dymbëdhjetë këlyshët bastardë, që pati pjellë *Luçia*, u zbulua dhe, kësajsoj, Lulushen e pushuan nga puna. Kurse njëmbëdhjetë “*ministrat*” i kapën dhe i hodhën në lumin e Bibollit. I vetmi që shpëtoi ishte *Zoti president*, të cilin Lulushja e kishte pas larguar me kohë nga strofka prapa “*parlamentit*”, për t’ia bërë dhuratë vajzës së saj Lushes.

Pas largimit të Lulushes nga puna si pastruese, *Luçia*, nuk desh të shikonte njeri tjetër me sy. Me vështtrimin gjithnjë nga rruga, në pritje të kthehej pastruesja dhe me dyshimin se në largimin e pastrueses dhe të këlyshëve të saj kishin gisht edhe zyrtarët e shtetit, ajo nuk ia lëpiu më gishtat asnjërit. Kur ata i flisnin dhe i zgjasnin gishtat me shpresën se do t’u a lëpinte, ajo largohej në mënyrë demonstrative.

Koha rrodhi si uji i lumit; ditët ikën njëra pas tjetrës dhe shpresat iu sosën *Luçies*. Atëherë ajo nisi të mos hante as ushqimin që i hidhnin të tjerët, derisa një ditë ngordhi.

Pas rrëfimit shumë prekës në lidhje me *Luçien* dhe të birin e saj, *Zotin president*, Lushja i tha Aushit se dëshironte, si me një rast, t'i përshëndeste të pranishmit me një poezi të saj.

- Me shumë kënaqësi, - tha poeti Aush Loshi. - Apo nuk paskeni një zë si të violinës! Shkoni, shkoni... Du me thanë, ngjituni menjëherë në podium.

I vendosi dorën në llërën e zhveshur dhe e shtyu lehtë mu sikur t'i frynte një fjollë të hollë.

Ky gjest nuk i pëlqeu fare Tushit, i cili bënte sikur lexonte në libër, por në fakt, mendjen e kishte tek çdo lëvizje e Lushes.

Lushja vajti dhe u ngjit në podium, pa vënë rë që nga pas iu qep edhe *Zoti president*, i cili zuri vend pranë saj. Ndërsa frymëmerrte me gjuhën jashtë, ai nisi të vështronte majtas e djathtas sallën e mbushur me njerëz.

Katër herë ajo provoi ta largonte me urdhra që nuk u zbatuan. *Zoti president* nuk lëvizti nga podiumi ku qe shtrirë. Kish futur bishtin ndër shalë dhe shtrembëronte kokën në një anë, si të deshte të mos dëgjonte çfarë i thonin. Sa herë

Lushja i jepte urdhër të largohej, ai lëshonte ca kuisje aq të dëshpëruara, sa të këpusnin shpirtin.

Të pranishmit u shkrinë gazit. Ata e dinin që shkaku pse *Zoti president* e pëlqente podiumin dhe nuk donte ta linte atë nuk ishte sepse kishte ndonjë gjë të rëndësishme për të thënë. Atij i pëlqente të rrinte në podium, thjesht për t'u kapardisur, që të tjerët ta përqendronin vëmendjen mbi të. Dhe, kur ai të kruante, ta zëmë, veshin me putrën e këmbës së pasme, ose kur të lëpinte penisin e vet, ta duartrokisnin.

Kësisoj, Lushja hoqi dorë nga urdhrat, e la të qetë *Zotin president* dhe zuri vend në foltore.

Të pranishmit u kthyen të shikonin andej nga podiumi. Secili mbante në dorë, dikush një salsiçe, dikush një copë sallam e dikush tjetër ndonjë ëmbëlsirë. Andej nga fundi i sallës u dëgjua një e kollitur. Një zotëri i veshur me shumë sqimë, tërhoqi fort hundët dhe psherëtiu.

Tekniku i ndërzimit Marin Dermeku i tha shokut pranë:

- Shif, shif... Alamet femre!

Drejtori i një shkolle të mesme, Gjunio Resti, gogësiu dhe qeshi me hi-hi-hi.

- Hallall ta bëftë Zoti, - foli me sa i hante zëri një djalë shakaxhi, që bënte nganjëherë edhe numra shpejtësie me karta bixhozi duke ua futur grave mes gjinjve.

Dalëngadalë u bë një heshtje disi tinëzare. Qe mu si ajo heshtja kur ndonjëri përgjon si brac prapa derës së zyrës së drejtorit, sepse është futur aty sekretarja e tij e bukur. Herëherë, të pranishmit pëshpërisnin ndonjë fjalë me njëri-tjetrin, por sërish ktheheshin e merrnin pamje serioze, duke u përpjekur të tregoheshin të vëmendshëm.

Lushja kruajti njëherë zërin dhe nisi të recitonte:



*Unë jam Lushja, ti je Tushi  
Halli hallin ç'e përpushi  
U ndez flakë kraharori  
Flaka flakë seç na mori.*

*Tush, mor Tush, rrapatush  
Unë të desha si askush.*

*Ti je Tushi, unë jam Lushja  
Ti si dashi, unë delushja  
Po më erdhe prapë pas gjurmës  
Do të të var në degë të hurmës.*

*Tush, mor Tush, rrapatush  
Më mashtrove si askush.*

Të pranishmit në sallë duartrokitën.

U dëgjuan zëra:

- Bravo, bravo...!

- Ja më në fund një poete, e thjeshtë, e bukur dhe serioze.

- Unë e kam rritur këtë vajzë. E kam pas në kopsht të fëmijëve - u kthye e i tha me krenari Tushit një grua e moshuar, që punonte edukatore. - Qysh kur mbushi pesë vjeç, kam thënë me vete: kjo vajzë do të bëhet poete e madhe.

Lushja e la podiumin dhe nisi të ecte për të dalë nga salla. Ndërsa ecte, ajo i hodhi kalimthi një vështrim Tushit. Ishte një nga ato vështrimet, ku bashkë me njëren vetull të ngritur paksa përpjetë, shfaqet edhe një nënqeshje therëse

në cep të buzëve. Një nënqeshje nga ato që të lënë të kuptosh se të pret gazepi. Për çudinë e të gjithëve ajo hapi derën dhe doli jashtë, bashkë me *zotin president*, që e ndoqi nga pas me bishtin përpjetë.

Tushi nuk deshi ta besonte atë që i panë sytë e i dëgjuan veshët. Kishte ulur kokën dhe i vinte turp ta ngrinte, edhe pse pothuaj të gjithë të pranishmit nuk e dinin që ato vargje ishin për atë. Fakti që Lushja kishte vendosur t'i bënte këtë surprizë e gëzoi, sepse kësisoj, ajo kishte gjetur një mënyrë mjaftë fine për t'ia thënë ato fjalë. Por ai nuk pajtohej me përmbajtjen e tekstit të strofës së fundit. Sidoqoftë, ai ndjeu brenda shpirtit, që e donte Lushen dhe u betua nën vete që nuk do t'i reshtte përpjekjet, që një ditë ajo të bëhej gruaja e tij.

*Sulejmani i madhërisëm i letërsisë bashkëkohore*, Aush Loshi, i tha Lizës:

- Tushi i këtyre vargjeve është këtu në sallë. Pak më parë u afrova dhe fola me të, pasi dukej i mërzitur. I dhimbte koka nga dashuria.

- Ama edhe ajo vajza, Lushja, bukur ia kishte stolitur, - tha Liza.

- Ajo vajzë, që sapo u largua, e ka një fije talent, - tha rëndë-rëndë si një kompetent Aushi. - Por i duhet shumë punë për të bërë që të arrijë suksesin.

Dhe nisi t'i fliste Lizës për veten, duke i shpjeguar fazat nëpër të cilat ai kishte kaluar, që poezia e tij të arrinte nivelin e lartë që kishte sot.

- Jam lodhur e rropatur shumë jo vetëm mendërisht, por edhe fizikisht, - i tha ai Lizës.

Pas këtyre fjalëve, yrish e prapë te tryezat e shtruara.

Dhe, për gati një orë, pasuan dialogje mjaft interesante mes të pranishmëve.

Që të jemi pak më të kursyer me rrëfimin, po japim vetëm një dialog të bërë mes dy zotërinjve me pozitë fort të lartë në shoqëri: botuesit Faruk Bariu dhe shefit të policisë Filip Zhulit, që të dy, tipa mjaft të kulturuar dhe shumë inteligjentë. Ky dialog, i bëri shumë përshtypje Tushit.

- Aushin vërtet e pëlqej si shkrimtar, prandaj... Duhet të merrni qofte se qenkan shumë të mira, - tha zotni Faruk Bariu.

- Po marr, po marr..., - ia ktheu zotni Filip Zhuli. - Krijimtaria e tij është e veçantë, është si e gatuar në një kuzhinë speciale...

- Në fillim nuk e kisha lexuar Aushin, por pastaj e lexova sepse...

Zotni Faruk Bariu e ndërpreu në mes fjalinë, ngase iu desh të gëlltitej. Si u gëlltit njëherë ngadalë, me shumë kujdes, (sepse zotni Faruku bënte shumë kujdes kur gëlltitej, përtypej, gogësinte dhe teshtinte), ai tha: - Jo vetëm qoftet, por edhe suxhuku qenka fort i shijshëm...

- Unë e kam lexuar Aushin qysh kur.... Hëngra nja dy rrota sallam që më shijuan shumë, por do ta provoj edhe suxhukun. - tha zotni Filipi. - Do ta provoj... Pse jo?

- Salsiçet, më duket se nuk i provuat! - e qortoi me shumë dashamirësi zotni Faruku.

- Provova vetëm katër copë dhe zbulova që... Krijimet e tij, kanë, si të thuash, tharm, - tha zotni Filipi.

Ndërsa fliste, Filip Zhuli mori një tjetër salsiçe dhe i hodhi një vështrim majmuni duke e rrotulluar mes gishtave nga të gjitha anët. Në çastin kur hapi gojën që ta kollufiste,

atij ia bëri me sy një copë suxhuku. Atëherë ai ndërroj mendje, e la salsiçen dhe mori suxhukun. E kapi me shumë delikatesë dhe e kafshoi si njeri me edukatë duke lënë para të pranishmëve një përshtypje mjaft të mirë.

- Ashtu është... Aushi i ka të tharta krijimet, - ia pat zotni Faruku duke picërruar sytë mu sikur po përtypte një kumbull të papjekur. - Por duhet pranuar, ama, që nuk i ka të gjitha të tharta, ka edhe krijime të ëmbla...

- Tharm, tharm..., - ngulmoi zotni Filipi. - Nuk thashë të tharta.

- Ah, po...! - u kujtua në beft zotni Faruku. Dhe pyeti: - Të kujtohet ajo strofa e fundit tek vjersha “*Sa të dua ty, moj qëne*”? ... Të lëpish gishtat.

Zotni Filipi tundi kokën në shenjë aprovimi e tha:

- Këto byreçkat i kam xhan... Mmm...! Sa të shijshme! Mjafton të shijosh me lexim vetëm një cikël nga “*Blegërimat e dashurisë*” dhe të ikën truri.

- Nuk di ç’ të them... - tha zotni Faruku, i cili, sapo zbrazti në grykë një kanaçe të tërë me koka-kola. - Edhe proza e tij ka vlera ushqyese për trurin.

- Ashtu është, ashtu...- e mbështeti zotni Filipi. Mori një dardhë të madhe, të zverdhur nga pjekja, ia tregoi mikut të tij dhe, para se t’i ngulte dhëmbët, tha: - Shif, shif...! Çfarë bukuroshje...!

Zotni Faruk Bariu nisi të tregonte:

- Kam mbetur shumë i kënaqur nga një tregim i shkurtër me temë nga tradhtia bashkëshortore. Sidomos, më ka pëlqyer një detaj mjaft i bukur... Prit ta kujtoj... Hë... Personazhi kryesor, që më duket se quhej Meleq, sa herë gjente në shtëpi dashnorin e gruas, donte ta ftonte në duel,

por nuk fliste dot, ngase i bënte llapa miza-miza...

- Më kujtohet si tregim, por nuk e mbaj mend me detaje, - tha zotni Filipi.

- A ma zgjat pak një kokërr vezë, sepse nuk i mbërrij dot prej këtu ku jam? - iu lut mikut të tij zotni Faruku.

- Urdhëroni, jo një, por dy... - tha menjëherë zemërbardhi dhe bujari, zotni Filip Zhuli teksa i zgjaste vezët me shumë xhentesë.

- Dua të lexoj në lëvozhgat e tyre sa vepra ka botuar gjithsej Aushi, - tha zotni Faruku.

- Aq shumë sa... Lëre mos e pyet... - tha zotni Filipi. - Bakllavaja nuk paska të sharë, t'u shkrika në gojë...!

- Keni shumë të drejtë - e mbështeti zotni Faruku. - Por, pa provoni njëherë sa interesant është kadaifi. Do ju lërë mbresa të thella.

- Mmmm..., - ia bëri i kënaqur zotni Filipi, pasi kishte rrasur në gojë një kallëp të tërë. - Kadaif për kokën e kadaifit!

Për gati pesë minuta, dy miqtë, zotërinj fort të nderuar, e ndërprejnë dialogun me njëri-tjetrin. Të heshtur e të matur; ata merrnin nëpër pjata me shumë takt; nganjëherë duke zgjedhur e nganjëherë, çfarë tu zinte dora; gjithnjë duke bërë kujdes, që të shmangnin ndonjë nga ato përplasjet e pakëndëshme, kur krejt papritur, ndodh që dy duar të personave të ndryshëm, kapin në pjatë në të njëjtën kohë, le të themi, të njëjtën qofte.

- Çfarë keni që po merrni si me përtesë? - pyeti zotni Filipi, sepse vuri re që miku i tij zotni Faruku, po jepte ca shenja dorëzimi.

- Të them të drejtën, po më vjen një si e përzier, - tha

zotni Faruku, ndërsa mbante barkun e fryrë si kacek me dorë. Fytyra i qe skuqur e bërë si spec prej sikletit. Në ballë nisën t'i shfaqeshin bulëzat e para të djersës.

- Edhe mua, më bëhet sikur më ka ngecur në fyt ndonjë personazh negativ, - tha zotni Filipi. Dhe pyeti: - Vallë, nga çfarë, thua ti, duhet ta kemi?

- Mendoj që e tepruam pak me ato zorrët e trasha të mbushura me qull. - u ankua zotni Faruku. - Nuk u përmbajtëm dot...

- E si të përmbaheshim, o miku im?! Ishin kaq të shijshme, sa të shkriheshin në gojë...! - u justifikua zotni Filipi.

Zotni Filipi hodhi mendimin që do të ishte një gjë shumë me mend nëse do t'i fusnin barkut një tarator me kastravecë dhe ta mbyllim për sot.

- Nuk provuat hasuden, - i kujtoi zotni Faruku duke treguar me dorë një tepsi të vogël të mbushur me kamare.

- E provova, por nuk bëra mirë, sepse e teprua pak si shumë me bakllavanë, - tha duke rënkuar zotni Filipi.

- Jo vetëm me bakllavanë, por të rrimë shtrembër e të flasim drejt, e tepruam me të gjitha... - ia pat qortueshëm zotni Filipi. - Çuditë, o miku im, si nuk pëlcasim!

- Nuk pëlcasim, - tha zotni Faruk Bariu. - Vetëm se na vijnë në gurmaz ca si gogësima.

- E-po, gogësima do na vijnë... Çfarë tjetër? Nuk do na vijnë predha topi! - ia pat duke rënkuar Filipi Zhuli.

Andej nga e vona doli të fliste akademiku Hashim Sholla, që shtynte nga shkante atë karrocën me punime shkencore. Hashimi qe një burrë i dobët, mbante mbi supet një kokë me tre qoshe dhe ecte ngadalë duke u lëkundur. Kokërdhokët e syve i kishte të dalë paksa jashtë si të një kameleoni dhe mund t'i rrotullonte për të parë majtas e djathtas pa e lëvizur fare kokën; kurse zërin, - të hollë si pingërrimë. Ishte gjysmë shurdh e gjysmë qorr, shihte vazhdimisht përtokë, mbante syzet me gishtin tregues që të mos i binin dhe tërhiqte hundët.

Sa herë tërhiqte hundët, krijohej poshtë mjekrës së tij një vakum, që bënte t'i kërcente shamia nga xhepi i vogël i xhakëtës. Masa me të cilën ai tërhiqte hundët, përcaktonte edhe distancën e kërcimit të shamisë. Kur i tërhiqte pak, shamia nxirrte nga xhepi vetëm njërin cep, si të deshte të demonstronte gatishmërinë e saj; por kur i tërhiqte shumë, ajo kërcente menjëherë, dilte jashtë prej xhepit dhe i fshinte hundën Hashimit. Këtë lloj magjie Hashimi e kishte shpikur vetë që në moshë të vogël, kur i ati e kishte pas nxitur të ushtrohej për t'u bërë magjisttar.

Ai shtyu drejt podiumit karrocën e mbushur kopicë me

punime shkencore, nxori një duzinë me fletë të shtypura në makinë shkrimi dhe u afrua pranë foltores.

Për t'u zhveshur nga çdo lloj emocioni, ai tërhoqi dhe shfryu njëherë hundët. Atë çast shamia e tij nxori kokën nga xhepi i vogël. Ai e shtyu me gishtin e madh dhe e futi sërish brenda xhepit; pastaj tha se quhej Hashim dhe se ishte shkencëtar i të gjitha fushave.

Hashimi u ngatërrua në morinë e madhe të shkresave që mbante në karrocë. Në vend të referatit për librin e Aushit, *Blegërimat e dashurisë*, ai nxori e nisi të lexonte një material shkencor që e kishte titulluar "*Pesëdhjetë metodat e përpunimit të qumështit*".

Kur ai nisi leximin, gjysma e pjesëmarrësve qe shpërndarë. Por edhe të tjerët, kur panë që Hashimi kishte ngatërruar fletët, i thirrën që ta përmendnin, por ai veç në të vetën; vazhdonte leximin pa reaguari fare, duke bërë që njerëzit në sallë të qeshnin.

Atëherë iu afrua vetë poeti Aush Loshi dhe e preku lehtë me dorë në sup. Donte t'i thoshte që, krejt gabimisht, po lexonte një kumtesë të përgatitur për ndonjë vend tjetër.

- Zotëri i nderuar! - tha Aushi me një zë gjithë solemnitet. - Ndoshta, du me thanë...

- Do mbaroj shpejt, - tha Hashimi pa e ngritur kokën.

Aushi e preku edhe njëherë tjetër akoma më fort.

- Ju kuptoj, - tha Hashimi. - Unë nuk jam një njeri i pamarrun vesh, por siç ju thashë do të mbaroj shumë shpejt. Bëni durim.

Aushi ia vendosi të dy duart në sup dhe nisi ta shtynte, që ta largonte me pahir.

- Mos më prek me dorë, sepse mua më thonë Hashim



Sholla. Kupton apo jo?! - turfulloi tashmë i nxehur ai.

Aush Loshi i dha një të shtyrë edhe më të madhe dhe kësaj here Hashimi gati u rrëzua për të thyer qafën.

- Ç'është kjo ndërhyrje me shtyrje kaq brutale?! - briti ai. - Mos doni, tani, në çast, t'i telefonoj kryeministrit, të cilin e njoh personalisht, pasi e blen djathin në dyqanin e bulmetit ku shet gruaja ime? Apo doni që për pesë minuta të sjell këtu njëren nga togat e njësive speciale, bashkë me komandantin e tyre, që është halis burri i motrës time. Po ju paralajmëroj, duke ju kujtuar që atdheu ynë është një vend i lirë, ku secili ka të drejtë të thotë fjalën e tij.

Dhe i tërhoqi aq shumë hundët, sa shamia e tij kërceu nga xhepi i vogël i xhaketës, i fshiu hundën dhe ra në dysheme. Kur u përkul ta merrte, Hashimit i ranë edhe syzet.

I mori të dyja, futi shaminë në xhepin e vogël, vendosi syzet, u kthye sërish tek foltorja dhe u përqendrua mbi fletët e shkruara.

Atëherë ndërhyri shefi i policisë Filip Zhuli, i cili tha që, përderisa fjalimet nuk përbënin vepër penale, Hashimi nuk mund të pengohet. Veç kësaj, aktiviteti konsiderohej tashmë i mbyllur, pasi ia kishte arritur qëllimit.

Kështu, të pranishmit nuk kishin pse të rrinin më. Ata morën me vete çfarë mbeti mbi tryezat e ngrënies duke mbushur strajcat dhe xhepat dhe njëri pas tjetrit ia mbathën të gjithë duke e lënë Hashim Shollën fillikat në sallë. Bashkë me ta doli edhe Tushi.

Një grup të rinjsh deshën të rrinin, thjesht për gallatë, por shoku i tyre u kujtoi ndeshjen e futbollit mes Brazilit dhe Argentinës, e cila pritej të fillonte së shpejti. Kështu,

salla u zbraz, mbeti aty vetëm Hashimi që dëgjonte Hashimin që lexonte.

Hashimi nuk u tund nga podiumi derisa përfundoi së lexuari gjithë kumtesën.

Pa e ngritur fare kokën e duke mbajtur gjatë gjithë kohës syzet me gishtin tregues, ai përmendi me radhë një nga një gjithë metodat e përpunimit të qumështit.

- Ju falenderoj shumë për durimin dhe qetësinë që mbajtët në sallë, - tha ai teksa mblidhte letrat për t'i futur në dosje, sepse tashmë e kishte përfunduar kumtesën. - Jeni vërtet të mrekullueshëm.

Kur ngriti kokën, ai pa i çuditur që salla ishte boshatisur krejt nga njerëzit. Madje as gruaja e tij, Kalemja, nuk ndodhej aty. Pa e lëvizur fare kokën, ai rrotulloi njëherë sytë djathtas, - askush; pastaj majtas, - askush. Atëherë vendosi gishtin e madh tek xhepi i vogël i xhaketës, që të mos i dilte shamia, tërhoqi hundët, kruajti zverkun dhe ra pingul në mendime. Sikur përpiquej të kujtonte kohën e tashme.

- Kush jam unë? - pyeti veten Hashimi. Dhe po vetë u përgjigj:

- Jam Hashimi Sholla, shkencëtar.

- Ku ndodhem kështu?

- Ndodhem bash në foltoren e sallës.

- Çfarë bëra në foltoren e kësaj salle?

- Sapo mbajta një kumtesë shkencore.

- A është kjo njëqind për qind e vërtetë?

- Po, kjo është shumë e vërtetë, sepse kumtesën e mbajta vetë.

- Nëse është e vërtetë, a duhej të kishte në sallë njerëz që dëgjojnë?

- Po, në sallë, duhej të kishte njerëz që dëgjojnë, por njerëzit si mban dot as kur vijnë, as kur shkojnë.

- Nejse..., - mërmëriti pastaj si nëpër dhëmbë ai. - Të paktën, unë e bëra timen...

Dhe tërhoqi hundët, por kësaj here me masë.

Dhe sërish ndodhi ajo magjia: nga xhepi i vogël i xhakëtës, si për t'i treguar gatishmërinë e saj, nxori kokën shamia, por gishti i madh e bëri të fshihej në çast brenda xhepit.

Aushi doli nga salla duke shtyrë karrocën e mbushur kopicë me punime shkencore.

Roja, - një tip muskuloz ky dhe me këmbët e çapëluara, pasi që ushtruar përgjatë shumë viteve në sportin e ngritjes së peshave të rënda, - po mbyllte portën e hekurt të oborrit.

- Ej, ej, - i thirri Hashimi rojes. - Prit se mos më mbyllësh brenda.

Ndërsa po dilte nxitimthi, roja i dha një shkelm në prapanicë e i tha:

- Tyt! Allçak! Për faj tënd ngela pa parë ndeshjen e futbollit.

Hashimi u kthye dhe e pa gjithë inat.

- Çfarë do, që shikon ashtu, ë, çfarë do? - e pyeti gjithë nerva roja i gatshëm për t'i futur edhe një shkelm tjetër.

- Mos thashë ndonjë gjë, unë? - pyeti i frikësuar Hashimi. - Asgjë nuk thashë.

Dhe u përkul të rregullonte, medemek, lidhësen e këpucës.

Roja e pa edhe për pak sekonda pa ia shqitur vështtrimin, pastaj u kthye dhe i vuri drynin portës.

Tushi zgjodhi nga libri i poetit Aush Loshi nja shtatë blegërima me rimë, blegërima shumë emocionuese, të cilat, i mësoi përmendësh dhe vajti t'i blegërinte para shtëpisë së Lushes.

Andej nga dreka, pati një far sukseesi të dukshëm, sepse pas një blegërima me katër strofa, që ai e kishte shënuar me një yll të vendosur sipër, doli nga një vrimë poshtë derës së shtëpisë një mace laramane. Me të parë Tushin, macja u tremb, ia mbathi me të katra, u fsheh pas një vandaku me dru të stivuara e nisi të mjaullinte. Pastaj doli jashtë qeni i Lushes, *zoti president*; i nguli sytë Tushit dhe lehu tri herë radhazi, duke i mbajtur veshët pipëz përpetë. Edhe pse Tushi nuk e kuptoi çfarë deshë të thoshte qeni me ato lehje, kjo qe një shenjë e mirë, sepse tregonte që diçka kish filluar të lëvizte. Tushi lehu tre herë si qen. Atëherë qeni u afrua duke luajtur bishtin. Tushi shfrytëzoi rastin për ta korruptuar: i dha njëherë gishtat t'ia lëpinte, pastaj i vari për qafe nja katër blegërima të shkruara në letër si dhe dy puthje.

Blegërimat dhe puthjet, kuptohet, që ishin për Lushen, por *zoti president*, i dërgoi ato drejt e tek i zoti i shtëpisë,

Brahimi. Me t'i parë blegërimat e shkruara në letër Brahimi nisi t'i fliste të shoqes me zë të lartë, që të dëgjonte Lushja andej nga dhoma tjetër.

- Pa shiko, moj grua, çfarë emocioni të madh ka derdhur në këto blegërima ai djalë!- thoshte ai.- Atë që Paganini e bëri me violinë, Tushi i Zavit po e bën me blegërimë! Si mund ta lëmë të presë aty jashtë derisa të tretet prej dashnisë si qiriu?! Foli asaj budallaqes, vajzës tonë. Foli moj! Thuaj që nuk ka për të gjetur kurrë djalë si ai. Dhe tregoi si qemë lidhur unë e tij njëherë e një kohë.

- Si qemë lidhur ne të dy, Brahim? - u bë kureshtare Lulushja.

- Nuk të kujtohet? - pyeti Brahim.

- Jo, nuk më kujtohet, - tha Lulushja.

- Kemi qenë në *Agrade* duke shirë grurë me atë makinën shirëse që thirrej *motorricë*, - nisi të tregonte ai. - *Motorrica* bënte dërr-dërr-dërr... Por në të dyve, ajo dërr-dërr-dërr, na dukej si të ishte simfoni e Moxartit. Aq shumë zhurmë bënte ajo makinë shirëse, sa nuk morëm vesh fare çfarë i thamë njëri-tjetrit. Ama për t'u kuptuar, u kuptuam si ç'ke me të. Pastaj të shtriva mbi thasë, ku të shiva mu si *motorrica* duajn e grurit, kashtën në njërën anë, bykun në anën tjetër, kurse kokrrat i mbajta për vete.

- Eh! - ia bëri Lulushja. - Ajo zhurma e *motorricës* na ka hyrë në tru, prandaj vazhdojmë të mos e dëgjojmë njëri-tjetrin.

- Nuk e dëgjojmë, vërtet. Ama për t'u kuptuar, kuptohemi për bukuri... - e këndelli Brahim.

Kjo bisedë mes tyre i dha Tushit të kuptonte që prindërit e vajzës qenë në anën e tij. Dalëngadalë suksesi po bëhej më i dukshëm.

Kështu, ai mblodhi forca dhe e zgjati qëndrimin edhe dy orë të tjera, duke nxjerrë blegërima me një yll. Pastaj dëgjoi t'i vinte në vesh që nga brenda një teshtimë, që zhurmoi mu sikur rrahim tokën fort me fshesë kur duam të vrasim një mi, që na e ka sjellë në majë të hundës me net të tëra. Kishte shumë mundësi që teshtimën ta kishte nxjerrë Lushja, ngase qe bërë alergjike prej ndonjë blegërimë me efekt ngacmues. Tushi nxori një blegërimë tjetër, që ai e kishte shënuar duke i vënë dy yje përsipër. Pas kësaj blegërimë Lushja nisi të kollitej e të kruante zërin. Ndoshta po përgatitej të dilte në dritare e të fliste.

Tushi e shfrytëzoi këtë rast; nxori dy herë radhazi njërën nga shtatë blegërimat që ai e kishte shënuar me tre yje përsipër titullit.

Kjo blegërimë qe si një thirrje e dëshpëruar, që vinte e shuhej me një psherëtimë plot dhimbje. Mirëpo, ndryshe nga ç'priste ai, menjëherë pas blegërimës u dëgjua nga brenda shtëpisë një pordhë aq e madhe, sa atij iu bë sikur u dridhën xhamat dhe shtëpia u trand nga themelet. "Kjo shtëpi paska brenda një kalë kaba, fort të madh", - mendoi ai, sepse nuk besoi të kishte pordhur kësisoj ndonjë qenie njerëzore. Nuk deshi ta besonte, që atë pordhë e kishte lëshuar i ati i Lushes, Brahim Çadërbashi.

Fill pas krismës, dikush hapi një dritare, por e mbylli sërish pas një urdhri. Një tjetër, hapi dhe mbylli një derë të brendshme; pastaj edhe një tjetër derë; pra, qe larguar nga kuzhina dhe kish hyrë mbase në dhomën e gjumit. Sërish u dëgjuan hapje-mbyllje dyersh, pastaj zëra. Babai urdhëronte, vajza kundërshtonte, kurse Lulushja, mundohej ta qetësonte.

- E ka hundën si llullë, o babi... A merr vesh? - ankohej Lushja.

- Hunda e madhe, është kismet i të zotit, - mendohej ta bindte i ati duke përdorur një ton urdhërues në fjalët që thoshte.

- Po që mbllaçitet me shumë zhurmë mu si një derr kur han, ë? - u ankua sërish ajo.

- Mbllaçitja nuk është minus, - këmbëngulte babai.  
- Është një plus më shumë; tregon forcë, karakter dhe shëndet.

- Po që vazhdimisht kruan hundën me gisht?

- Hë, se ka merak pastërtinë, prandaj e kruan, - ia pat e ëma.

- Pastaj i vjen erë nga goja...

- Mësohesh, moj e mira e nanës, edhe me erën mësohesh, - përpiquej ta qetësonte Lulushja.

Asnjëra nga këto që tha Lushja nuk ishin të vërteta. Deri diku, ajo kishte të drejtë për hundën, por mënyra si e tha, ishte e ekzagjruar. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera, që ajo nxori, ato nuk qëndronin. E dinte edhe vetë. Të gjitha këto vese i kishte vetë i ati, Brahimi, i cili mbllaçitej kur hante, kruante hundën me gisht si dhe i vinte erë nga goja. Por Lushja, deshi të testonte të atin, të shikonte si do të reagoonte kur t'i ngjiste Tushit veset e tij. Brahimit, kuptohet që i erdhi mirë, sepse kuptoi, që nuk ishte i vetmi me ato vese, ndaj dhe mbajti anën e Tushit.

Pas kësaj bisede të bërë atje brenda, Tushi pati një shkartisje personaliteti. Ai mendoi ta linte fare, të mos blegërinte më, por të shkonte tek lokali i Fazil Krosit dhe të pinte derisa të bëhej tapë; mirëpo sërish ndërroi mendje.

“Përse të mos provoj njëherë të blegërij si një dash me shumë përvojë në arena luftimesh me brirë, duke treguar kështu forcë, vendosmëri, karakter të fortë dhe autoritet” - mendoi ai.

Ai blegëriu sërish fort, tashmë me vendosmëri e gjithë autoritet, duke u përpjekur të nxirrte një zë të fortë prej basi, si dhe të fuste në blegërimën e tij edhe pak nëntekst për t’u lënë të kuptohej, ndoshta pasnesër.

Tushi vuri re që kjo blegërimë pati një lloji efekti më të madh. Situata po ndryshonte dukshëm dhe gjërat po lëviznin për mbarë; sepse perdja e dritares së dhomës ku flinte Lushja lëvizi tre herë radhazi. Tre hundë u ngjitën për xhamit njëra pas tjetrës; dhe tre palë sy vështuruan përjashta Tushin që tashmë kish filluar të nxirrte ca blegërima emocionuese dhe shumë dinjitoze.

Hunda, që u shfaq e para, qe si grykë çajniku dhe nxirrte avull nga pasioni. E dyta, qe e trashë si një patëllxhan i lënë për farë dhe me ca qime të gjata në majë, ca qime si gjemba kaktusesh. Mbi këtë hundë qëndronin kaluç një palë syze me xhama të trashë si bythë kavanozi. Tushi njohu hundën e Brahim Çadërbashit. E treta, qe një hundë e shtrembër, si prej kocke e punuar me limë nga ndonjë axhustator i pavëmendshëm. Me të prekur maja e saj xhamin, xhami kërciti si ta kishin gjuajtur me ndonjë gur të vogël nga ato që hidhen në tavolinën e kumarit.



Në mbrëmje Tushi u kthye në shtëpi i rraskapitur, por tashmë me një fije shprese të ngjallur në zemër se ndoshta, me pak më shumë këmbëngulje, mund e përkushtim, do ia dilte mbanë.

Mirëpo natën, teksa flinte, ai pa një ëndërr që i ngjalli dyshime dhe ia rrëzoi shpresën përtokë.

Në ëndërr iu bë sikur i kishin futur një lak tërkuze të lagur rreth fytit. Tërkuzen e kishin lidhur lart, në një degë të trashë lisi, në majën e të cilit qëndronte dhe krokaste një korb. Duart ia kishin prangosur prapa shpinës, kurse këmbët Tushi i kishte vendosur mbi supet e Lushes. Ndërsa i dridheshin gjunjët, Lushja shtrëngonte dhëmbët prej peshës që duhej të mbante.

Njëzet metër më tutje, sipër një stoli, kishin vendosur një thes të madh plot me para.

Lushja duhej të zgjidhte mes Tushit dhe parave. Nëse ajo e donte Tushin, nuk do lëvizte për të shkuar e për të marrë paratë, por do ta mbante atë mbi supe për një afat të caktuar prej dy orësh. Nëse donte më tepër paratë, ajo do vraponte t'i merrte ato pa iu bërë vonë për hatanë, që do të ndodhte. Pra, Lushja mund ta fitonte thesin me para vetëm

nëse Tushi jepte shpirt i varur në litar. Ky ishte një test, që i bënte Lushes, ish sekretari i partisë, hoxhë Rrahimi, para se të bekonte lidhjen e tyre me martesë.

Rreth tij qe mbledhur një turmë e madhe bibollasish që blegërinin, pëllisnin, hungërinin, mjaullinin, lehnin e cingërinin; por ngase ata e bënëin këtë katrahurë zërash të gjithë njëherësh, ai nuk mundi dot të kuptonte çfarë donin të thonin.

Në fillim Lushja u duk sikur do ta përballonte këtë tundim me stoicizëm duke rezistuar gjer në fund, pasi qe vajzë e mirë dhe për më tepër, prej derës së fisme të Çadërbashëve. Por, nga minuti i njëzetë filloi të hidhte vështrime me bisht të syrit andej nga thesi i mbushur, të lëpinte buzët e të lëshonte ca blegërima të mekura dëshirimi. Nga minuti i tridhjetë e pestë-tridhjetegjashtë, ajo i shpeshtoi blegërimat dëshpëruese; pyeti sepse desh i të dinte çfarë kishte thesi, lekë, dollarë apo euro. I thanë se thesi qe mbushur plot me euro. Ato çaste diçka e lëngshme, e ngrohtë dhe me erë të keqe rrodhi e ra mbi kokën dhe supet e Lushes.

- Çfarë bëre kështu, o i dashuri im? - pyeti ajo.

- Më shpëtoi shurra, - tha Tushi. - Më shpëtoi nga frika.

- Po frika, përse të zuri?

- Nga mungesa e besimit, - u përgjigj ai si një mjeran.

Kaq u desh që Lushja ta linte Tushin të binte dhe t'ia thekte vrapit për të marrë thesin e mbushur.

Tushi ngeli varur në litar. Ndërsa shtrëngonte dhëmbët të mos i dilte shpirti, ai pa të afrohej ish sekretari i partisë, hoxhë Rrahimi për t'i kënduar ilahitë e fundit. Ndërsa diku andej nga fundi i turmës, Azraili përpiqej të hapte shteg

duke u shtyrë me bërryla, që të vinte të merrte shpirtin e tij për ta futur në torbë.

Kur u zgjua trandshëm, ai kuptoi se vërtet qe pshurrur në brekë dhe njëkohësisht, qe bërë ujë në djersë.

U ngrit nga shtrati, u la, u vesh dhe u nis të blinte ushqime në dyqan, por u habit kur përfundoi në xhami. Pasdite, i ndodhi tjetër gjë: humbi portofolin brenda në shtëpi. Nuk mbante mend ku e kishte lënë. Kërkoi sa kërkoi, pastaj, ngase nuk po e gjente, mori telefonin t'i çonte një zile, por u kujtua që nuk mund ta bënte këtë. Pastaj vuri rë që portofolin e kishte mbajtur në dorë gjatë gjithë kohës që e kërkonte. Pastaj, e preu mendjen dhe vajti për një vizitë tek doktor Neki Alizoti, të cilit, i tregoi edhe librin me blegërima dashurie të poetit Aush Loshi, që e pati marrë me vete.

Doktori i bëri shumë pyetje Tushit, pastaj shfletoi librin faqe për faqe, dhe si psherëtiu një herë i zhytur në mendime, i dha ca kokrra të verdha, që t'i pinte. Gjithashtu, doktori e porositi të bënte çdo ditë dush me ujë të ftohtë, të ushtrohej në sportin e mundjes, të shkonte në punë me hap rreshtor si dhe të këndonte këngë trimërie. Ai e këshilloi, i tha se do të ishte shumë mirë që, të paktën për nja njëzetë vjet, librin e Aushit, *Blegërimat e dashurisë* ta mbante larg.

- Sa larg duhet ta mbaj? - e pyeti Tushi doktorin.

- Larg, - tha doktori. - Mbaje shumë larg.

- Po sa shumë larg mendon ti, o doktor, sepse unë, nuk di sa...

- Mjafton ta heqësh nga shtëpia, por dhe nga mendja, - e këshilloj doktori.

- Po sikur ta dërgoj e ta hupi në ndonjë zgafellë lisi në *Malin e hidrës me shtatë krena?*

- Jo, jo, - tha doktor Alizoti. - Nuk ke përse shkon kaq larg.

- A ta vari në litarë pastaj t'ia hy me një shkop?

- Jo, - tha doktori. - Do çlirojë pluhur toksiko-letrar dhe do ju sëmurë të gjithëve si familje.

- A t'i vë, pra, flakën? Ta spërkati me benzinë dhe ta djeg krejt?

- Jo, për të djegur mos e digj, sepse edhe tymin e ka toksik, do prishet sistemi ekologjik.

- A t'i bëj një gropë, pra, ta mbuloj me dhë?

- Kjo nuk më duket e keqe si ide, - tha doktori Teki Alizoti. - Më mirë varrose në një gropë.

- Sa thellë duhet ta fus në gropë, doktor?

- Gjer në brez, mjafton.

- A ta mbledh gjindjen, t'i bëj mort, t'ia hamë hallvën?

Kjo pyetja e fundit e bëri doktorin të vinte buzën në gaz.

- Mos i bëj mort, sepse ai mortin e ka brenda, prandaj të bëri me dobësi zemre, - tha së fundi doktori.

Me t'u ndarë prej doktorit, Tushi vajti në shtëpi, mori një kazmë e një lopatë dhe u nis për në varrezë. Aty i bëri një varr librit "*Blegërimat e dashurisë*", e futi brenda dhe e mbuloi me dhë. Si e mbuloi me dhë, ai i vendosi edhe një copë dërrasë në të cilën shkroi si epitaf:

*Këtu prehet ai, që jetën na nxiu,*

*Libri, i dobëti, i keqi, i ziu;*

*Ai që na sollti telashe të mëdhaja*

*Më shumë se kanceri, murtaja...*

Ato kokrrat e verdha, që i dha doktori, Tushi nuk i piu; por këngët e trimërisë i këndoi të gjitha sa dinte. Kurse hapin rreshtor e bënte sa herë shkonte në banjo për të kryer nevojat personale. Por e bënte edhe kur shkonte, që të blegërinte para shtëpisë së Lushes. Kësisoj e mori një çikëz veten.

Ditën tjetër, - më duket se qe e diel, - ndonëse i lodhur sa s'ka më dhe i zhytur në dëshpërim të thellë, Tushi zuri sërish vend përballë shtëpisë së Lushes.

Ai nisi të blegërinte me një vendosmëri ende më të madhe, pa pushuar asnjë çast. Tashmë ai nuk nxori në adresë të Tushes blegërima nga ato që gjendeshin në librin e poetit të madh Aush Loshi, të cilin e varrosi. Ai nxori blegërimat e tij, ashtu si i vinin, të pa manipuluar me intonacione patetike dhe të pashoqëruara me gjeste të stisura. Në blegërimën e tij ishte vetë Tushi, ishte kafsha e natyrshme, ishte ai dashi i urtë, që blegërin shpresën e vet, dashurinë e vet, vuajtjen, gëzimin, frikën nga vetmia, dëshirën, mërzinë e thellë. Ai e bëri me shpirt; pa krenari, por edhe pa përlulje; pa stisje dhe pa ndonjë zgjuarsis të madhe.

Andej nga e vona filluan t'i pritëshin gjunjët, t'i merreshin mendtë e njëkohësisht t'i merrej edhe zëri.

Kur zëri iu shua krejt, çuditërisht u hap porta dhe prej aty doli Lushja.

Qe veshur me një fustan në ngjyrë blu të errët, plot

lule portokalli, ndërsa tërhiqte zvarrë shapkat e nënës së vet, Lulushes.

Ajo eci drejt Tushit duke lëshuar ca blegërima që shprehnin diçka të ngucakeqëshme në vete dhe që ajo përpiquej ta frenonte.

Dukej ashiqare që Lushja kishte qarë, por nuk u mor vesh nëse kishte qarë prej mallëngjimit që i kishin shkaktuar blegërimat e Tushit apo prej hidhërimit pse e kishin detyruar prindërit të dilte.

- Be-be-beee..., - blegëriu ajo duke shtrembëruar pak kokën nga e djathta gjithë pafajësi. Kjo blegërimë pati brenda një dozë kryeneçësie dhe zemërimi; megjithatë Tushi arriti të kapte edhe ca nota të buta prej kafshe, që dorëzohet në mirëbesim. Në gjuhën e popullit të Bibollit kjo blegërimë do të thoshte: “Çfarë do, or voc“?

- Beh-heee-heee..., - ia bëri Tushi me një zë të marrun, të lodhur, që të këpuste shpirtin.

Kësaj here, në blegërimën e tij pati dhimbje të madhe, dashuri, betime, premtime dhe një si lutje gjer në përgjërëm.

- Dakord, - tha ajo duke e pranuar kërkesën e Tushit për martesë. - Por vetëm me një kusht: të më bësh të lumtur.

- Be-heee..., be-heee..., - ia bëri Tushi dy herë radhazi, duke nxjerrë tashmë vetëm frymë, sepse zëri e kishte lënë krejt.

Kjo blegërimë, që një premtim, sipas të cilit, Tushi do të bënte të pamundurën për ta bërë të lumtur Lushen.

U kapën për dore. Tushi e dërgoi Lushen në shtëpinë e tij, ku gjeti edhe mirëkuptimin e prindërve.

I ati i tij, Zavi, kishte bërë investigime, që i patën marrë shumë kohë. Ai kishte nxjerrë konkluzionin që Lushja pati

lindur një vit para asaj ndodhisë aksidentale që e futi në krevat me të ëmën e saj. Pra, në dejet e Lushes nuk rridhte gjaku i Zavit.

Atë natë, para se të hynin në shtrat, si burrë e grua, Lushja e pyeti Tushi:

- A asht' ky fundi i lojës?

- Jo, - u përgjigj Tushi. - Asht' vazhdimi.

- Dua të di përse më do pikërisht mua, kur Bibolli ka plot vajza të tjera, madje më të bukura se unë, - tha ajo.

- Ti the më të bukura, nuk the më të mira, kështu? - pyeti ai.

- Mbase edhe më të mira..., - i tërhoqi zvarrë fjalët ajo.

Tushi i mori dorën mes pëllëmbëve të tij, u mendua një çast e ndërsa e vështronte në sy pyeti:

- A duhet të të gënjej?

- Jo, - tha Lushja. - Duhet të më thuash të vërtetën.

- Të dua pa e ditur përse, - tha ai

- Atëherë, më thuaj, sa shumë më do? - deshi të dinte Lushja.

- Nuk e di sa shumë të dua, - tha Tushi.

- Si na qenka kjo dashni kështu?! - tha ajo hem e mikluar, hem e acaruar.

- Sepse të dua pa krenari, pa zgjuarsi, pa masë, pa fjalë, pa arsye... - tha ai. - Të dua si një kafshë, prandaj edhe blegërij.

- Përse ke zgjedhur këtë mënyrë? - pyeti ajo.

- Sepse nuk di ndonjë mënyrë tjetër më të mirë e më të ndershme, - tha ai. - Pastaj, kështu është loja.

- Unë dua të gjesh një mënyrë tjetër, - tha ajo. - Një mënyrë që të duhemi prore...



- Ne mund të duhemi prore, por kjo nuk është kaq e thjeshtë. - tha ai.

- A mund të dashurohemi me sytë mbyllur? - pyeti Lushja.

Tushi u krodh në mendime. Nuk i erdhi mirë nga kjo pyetje, sepse mendoi, që Lushja nuk e pëlqente si paraqitje. Kur Tushi nuk u përgjigj, ajo ngulmoi:

- Të pyeta, a mund të dashurohemi me sytë mbyllur?

- Po, nëse e gjejmë njëri-tjetrin me të prekur, - tha disi përtueshëm ai.

- Thuaj diçka para se të shtrihemi në krevat. - tha ajo. - Diçka që të më japë të kuptoj, që ti vërtet më do.

- Kjo është fare e lehtë, - tha Tushi me buzën në gaz. - Vetëm dy fjalë duhen.

- Thuaj, pra, ato dy fjalë, thuaj... - e nguci Lushja.

- Hiqi brekët, - tha ai.

Mrekullia që bëri Tushi duke rikthyer në jetë Aushin e vdekur bëri që bibollasit ta thërrisnin edhe në shumë raste të tjera për të ringjallur njerëzit që u vdisnin. Ai u thoshte se rasti me Aushin kishte qenë i veçantë dhe se mrekullitë ndodhnin rrallë, jo për çdo herë, ndaj nuk shkonte. Por në një rast, Dodë Marria nga Dodona iu lut, si i thonë, sa për një gjak, që ta provonte njëherë për të risjellë në jetë gjyshin e tij, Reposhin, i cili sapo kishte vdekur.

Tushi i tha:

- Përse nuk e provon njëherë vetë, o Dodë? Është shumë e thjeshtë... - Dhe nisi t'ia shpjegonte: - Merr një shkrepëse, nxirr një fije dhe ndize. Pasi ta ndezësh, afroja te vrima e hundës....

- Unë, o vllau jem, nuk e baj dot një mrekulli kaq t'madhe, siç asht' ringjallja e një t'dekuni. - i tha Doda. - Nuk kam tagër prej t'madhnueshmit. Ty ta ka dhanë tagrin Ai qi asht' atje nalt, n'qiell. Xhithë Bibolli flet për k'të. Nëse ma ban kët' nder, unë t'jap si shpërblim një thes groshë si edhe viçin kur ta pjellë lopa.

- Sa vjeç pati qenë gjyshi Reposh? - pyeti Tushi.

- I vjetër ka qanë, vallahi, i vjetër shumë. - tha Doda.

- Thuaje, sa?

- I pati kalu të njëqind vjetët, bre...

- Unë them të mos e ringjallim, - tha Tushi. - Më fal pse po ta them, por është shumë i vjetër... Ç'ju duhet, në këtë moshë?

- Nuk na duhet hiç, bre vllau jem, - tha Doda. - Madje, as qi na rruhet fare pse vdiq. Por puna është se ka pas mshefun një qyp me flori dhe iku pa na tregu venin. Nëse e ringjallim, them se do na japë florinin si shpërblim.

- Unë e provoj njëherë, - tha Tushi, - por nuk e bëj për groshën dhe viçin. Pastaj, nuk ju garantoj njëqind për qind se mund ta ringjall.

- Po ti veç provoje njëherë, bre vllau jem, sepse për qiell e dhë, po u ringjall dhe na dha çypin, një pjesë e verdhushkave të takon edhe ty, veç groshës dhe viçit. Do të marrësh edhe ti pjesën tane.

- Sa mund të jetë pjesa ime, - pyeti Tushi si me shaka teksa buzëqeshte.

- Unë, o vllau jem, nuk mund ta them tash sa... Por do shikojmë pasi të bëjmë hesapet. Xhyshi ka dymbëdhjetë fëmijë, të cilët janë martu... Ata kan dalë të xhithë n'pension... Jo të xhithë... Dua të them i heqim dy, sepse kanë vdekë. Nipa e mbesa të xhyshit Reposh bahemi bajagi. Nja shtatëdhjetë e pesë, m'duket. Masanaj, stërnipën nuk janë shumë. Noshta bahen nja njëqind e tetëdhjetë ose njëqintë e nanëdhjetë. Xhithësecili do marrë pjesën e vet. Edhe ti, o vllau jem, do keshë një pjesë të qoçme.

Tushi uli kokën dhe u përtyp. Edhe nëse do ta ringjallte gjyshin Reposh, sipas kësaj llogarie që bëri i nipi, me aq shumë trashëgimtarë, i binte që Tushi të merrte qypin bosh.

- Po vij... - tha ai. - Por ta dish, që nuk e bëj për shpërblim. Pastaj, nuk të premtoj se do ia dal mbanë. Sepse, siç të thashë, këto mrekulli, ndodhin fort rrallë.

- Ti veç hajde provoje njëherë, bre vllau jem! - tha Doda. - Po u rinxhall, asht mirë, po nuk u rinxhall, n'pidh të s'amës i koftë!

Rruga për në Dodonë ishte për faqe të zezë, nuk shkohej me makinë. Por Doda se nga gjeti një zetar të vjetër kinez dhe u nisën. Motori i këtij zetori punonte me tre pistonat, nxirrte shumë tym të zi, si dhe lëshonte një zhurmë të llahtarshme.

Kur hyri në Dodonë, e pritën qindra njerëz në rrugë, a thua se po vinte me zetar Krishti i ringjallur për të rikthyer të vdekurit sërish në jetë. Kishte dalë për ta pritur gjithë fisi i madh i Marrive. Por kishin dalë edhe njerëz nga fise të tjerë që ishin thjesht kureshtarë. Pastaj nuk mungonin edhe skeptikët, që nuk besonin që plakun e vdekur Reposh Marria mund ta ringjallte ndokush, prandaj nuk përziheshin me turmën.

Sapo zbritën prej zetarit, Doda u bërtiti njerëzve që zgjatnin duart të preknin Tushin, sepse e dinin për njeri të shenjtë, që bën mrekullira. U tha atyre të mos afroheshin, por të mbanin distancë.

Një grua e dobët, që e thërrisnin Cie, u turr me yrish dhe sa hap e çel sytë i shkuli Tushit ca qime floku mu sipër veshit; pastaj ia mbathi me vrap. Cia nuk kishte mundur të bënte fëmijë, prandaj i donte qimet e Tushit t'i kishte si hajmali, që të ngelej shtatzënë.

Tushi fërkoj me dorë kokën sipër veshit, sepse i dhëmbi.

- Bëj kujdes dhe mos i lër të më afrohen, sepse po m' u sulën të gjithë kështu, do më rrjepin për së gjalli mu si një gjel, - i tha ai shumë i trembur Dodës.

Fill pas këtyre fjalëve, Doda iu hakërrye Cies me zë të lartë:

- Oj shterpa e dreqit! Fëmijët bahen me të qime, jo me qime. Ktheja shpejt qimet të zotit, sepse për qiell e dhë, po nuk ia ktheve....

Ato çaste Dodës iu desh ta linte Cien për të larguar bojaxhiun Lazam Zhegu, i cili ia behu aty e nisi t' i lutej Tushit që t' i ngjallte gruan e tij të parë, Elhamen.

Elhamja kishte vdekur para dhjetë vjetësh në një aksident automobilistik.

- A nuk ke hiç marre, or ti? - i tha Doda Lazamit. - Po u nxhall Elhamja, çfarë do të bash me at' që ke tash, Mihanen? A t' erdhi mirë kur ia nxhite dorën qysh javën e dytë të zisë? Ti nuk po ia del dot Mihanen... A nuk e shef si ta ka tha hunën e ta ka ba si sqep qukapiku. Na dashke ene Elhamen! Qejfli i madh ti!

- E kam pas dasht ma shumë Elhamen, sepse ka qenë ma e mirë, - tha Lazami. - Kjo e dyta më doli belazezë. Rrihet me kunatat, kurse mua më ka kërcënuar; më ka thënë se do ma presë atë senin natën në gjumë.

- Ta ka thanë sepse ti u hedh sytë grave t' milletit. Masanaj, shenjti Tush, nuk i rinxhall të dekmit kotnasikot, pa ndonji arsye t' fortë. Unë e solla k' tu për të rinxhallë xhyshin Reposh, sepse kam hall. Xhyshi ka marrë me vete një sekret t' madh. Ka pas mshef një qyp me flori dhe vdiq pa na tregu se ku e ka mshef...

Doda nisi të argumentonte që ringjallja e të vdekurve

nuk qe punë fort me mend, sepse do të sillte një kaos të madh në Biboll. Çfarë do të bëhej me ata të ringjallurit që kishin pas vdekur qindra vite më parë? Ata nuk do t'i njihte askush. Madje, as që do t'u besonin se kishin pas jetuar në Biboll. Tjetra ishte, sepse do të kërkonin të merrnin pronat që kishin pasur kur ishin gjallë; do të kërkonin të merrnin shtëpitë, tokat, dyqanet e gjithçka tjetër. Do t'u shpallnin luftë stërnipërve e stërmbesave, do bahej hataja...

- Po u rinxhall gruja e parë Elhamja, banu gati të dalësh prej shpie, ti bashkë me Mihanen, - i tha Doda Lazamit. - Të mos themi pastaj që mund të të vijë bashkë me dashnorin që ka zanë në botën e përtejme!

Lazami u përtyp njëherë, pastaj luajti prej vendit. U duk ashiqare që nuk i erdhi mirë nga fjalët që dëgjoi.

- Pra, nuk qenka gjë as ringjallja! - mërmëriti si nëpër dhëmbë ai.

- Nuk asht', - tha Doda. - Por njerëzit, kur u bie në mend se kanë për me vdekë, i zë frika e fillojnë të shohin andrra me sy hapun.

- Hajt, pra... Ma bëfshi ditën e mirë! - tha Lazami.

Ktheu shpinën dhe u largua.

Fill pas tij, ia behu aty Liseta Blumi.

- O shenjti Tush! Të lutem dëgjoma një hall! - iu lut ajo Tushit dhe ra në gjunjë mu te këmbët e tij.

Doda e kapi për krahësh Lisetën. U përpoq ta ngrinte dhe ta largonte, por ajo nisi të qante e të dridhej.

- Unë ta dëgjoj hallin, por nuk di a ta zgjidh dot, - i tha Tushi, ngase ndjeu keqardhje kur e pa aq të tronditur. Dhe pyeti: - Çfarë kishe për të thënë?

- Më vjen burri natën në errësirë dhe më futet në krevat,

- tha Liseta duke e vështruar me sytë e saj të trembur. - Të lutem, o shenji Tush, bëje të mos vijë...!

- Të gjithë burrat u futen në krevat grave të tyre, ditën dhe natën, - tha Tushi me autoritetin e një të drejti. - Ky nuk është hall.

- Po ai ka një vit që ka vdekur! - tha Liseta. - A duhet ta bëjë këtë edhe pas vdekjes?!

Tushi u befasua, pasi në herë të parë nuk e kuptoi se bëhej fjalë për të shoqin e saj të vdekur.

- Kur vjen, a e ka fytyrën me dhë? - pyeti Tushi.

- Fytyrën nuk ia kam parë, o shenji Tush, sepse ai vjen dhe ikën nëpër terr, - tha Liseta.

- A vjen çdo natë? - pyeti Tushi.

- Vjen një herë në javë, por ka ndodhur që ka ardhur edhe dy herë...

- Nga e di ti, që është pikërisht burri yt i vdekur? - pyeti Tushi, gati me pëshpërimë, që të mos dëgjonte Doda aty pranë.

- Sepse i vjen era hudhër dhe e zë lemza tamam siç e zinte kur ishte gjallë. Pastaj, duket nga zëri që është ai. Veç kësaj, sa herë vjen, më sjell ndonjë gjë të ëmbël për të ngrënë, por sjell edhe ndonjë rrobë për të veshur. Nganjëherë më jep edhe lekë. Të njëjtën gjë bënte edhe kur ishte gjallë.

- Si arrin të futet në shtëpi? - pyeti Tushi.

- Futet nga dera, sepse ka çelësin. Kur vdiq, harruam t'ia nxirrnim nga xhepi i pantallonave.

- Nëse nuk do që të vijë, ndërroja bravën derës dhe siguroi mirë dritaret, që të mos hapen, - e porositi Tushi pasi e kishte kuptuar si qëndronte puna.

- Po ai më ka thënë se, nëse i ndërroj bravën derës, do të më hedhë në qafë gjithë demonët e së keqes, - tha e trembur Liseta. - Ndoshta është më mirë ta ringjallësh, o shenjti Tush, sepse kështu...

Tushi e kuptoi për çfarë bëhej fjalë, sepse u kujtua që kjo histori pëshpëritej vesh me vesh ne gjithë Bibollin. Karrocieri Mark Pati i futej natën në shtëpi një vejushe duke u hequr si burri i saj i vdekur.

- Unë e ringjall, - tha Tushi. - Por të ringjallurit, edhe pse janë të njëjtët, nuk kanë atë pamjen që kanë pasur.

- Le të jetë si të jetë, o shenjti Tush, - tha Liseta. - Të lutem shumë, veç ringjalle...

- Po e provoj njëherë, - tha Tushi.

Shtriu krahun, bëri me gisht andej nga varreza e me sigurinë absolute të një profeti tha:

- U bë! Këtej e tutje yt shoq do të të shfaqet si karrocieri Mark Pati.

I dha dorën Lisetës dhe e ndihmoi të ngrihej.

- Sido që të shfaqet, nuk ka problem, o shenjti Tush. - u mallëngjye vejusha Liseta Blumi, - Unë vetëm desha të ringjallej...

Tushi u vu sërish për udhë, por shumë shpejt u përball me një burrë që i zuri rrugën në një mënyrë shumë kaba. Ky burrë kishte vraga në fytyrë; kurse kokën e kishte të rruar e gjithë gunga. Kishte qenë burgosur njëzet e shtatë herë për ushtrim dhune. Quhej Hasan Pogoni, por thirrej *Hasani i gungave*.

*Hasani i gungave* i nguli një vështrim të turbullt e iu hakërrye:

- Edhe unë i kam nja dy fjalë, or ti i shenjtë.



- Nuk jam i shenjtë, megjithatë, urdhëro e fol, - tha Tushi disi i trembur.

- Gruja jeme, - ia nisi *Hasani i gungave*, - iku prej shpie e vajti në Itali. Në rregull?

- Në rregull, - tha Tushi instinktivisht, krejt i përhumur.

- Tani dëgjo këtë tjetrën: atje punoi si prostitutë, derisa një ditë u gjet e dekun në një kazan plehnash. A jemi prapë në rregull?

- Në rregull, - tha sërish Tushi.

- Por dëgjo këtë tjetrën tani: më ka ardhur një lajm se është parë teksa blinte biletën për t'u kthy prap ke shpia jeme. A ndalemi pak këtu, o byrazer?

- Po mirë, ndalemi, - mërmëriti si nëpër dhëmbë Tushi.

- Sa për dijeni, mua më thonë *Hasani i gungave*. Tani po të pyes: a më njef mu ti?

- Jo nuk të njof...- belbëzoi Tushi, ndërsa nisi të dridhej.

- Noshta ti nuk më njef, por zanin, asht e sigurt qi ma ke ndigjue.

- Tani bjери drejt e në temë..., - mori guxim e tha Tushi.

- Drejt po i bie, - tha *Hasani i gungave*. Dhe iu hakërrye: - Nëse ti je ai, qi ke ringjallë grun teme, pasha zotin e madh, ta këpus kokën qëfësht...

Dhe bëri gjestin sikur priste fytyrën me thikë.

Hyri në mes Doda, i cili e shtyu *Hasanin e gungave* duke e qortuar me shumë takt:

- Pasha qiell e dhë, or Hasan, ti qake rrotë kari! Mos u ban beterr, or ti, e mos kërko sherr kot së koti, sepse me mua të gjen belaja...

*Hasani i gungave* i nguli Dodës një vështrim prej bualli të inatosur.

- Mos më shif ashtu, or ti, - e paralajmëroi Doda. - Sepse, edhe pse kaptina jote asht' plot gunga e nuk gjendet vend ku të mbijë ndonji gungë e re, unë t'i baj gungat nëpër gunga.

- Ashtu...?! - u skandalizua *Hasani i gungave*. U grind njëherë si qen duke përveshur anën e djathtë të buzës së sipërme dhe pyeti: - A më pret këtu, sa të shkoj në shtëpi, të marr sëpatën?

- Këtu më ke, or ti, por hajde pak shpejt, se nuk të pres gjithë ditën, - tha Doda.

*Hasani i gungave* ia dha vrapit, por pastaj u kujtua që Doda i tha të kthehej shpejt dhe ndaloi. Unë jam *Hasani i gungave*, tha me vete ai. Nuk marr urdhra nga askush. Dodë Marria nuk mund të më thotë mua të kthehem shpejt! Unë kthehem kur të dua vetë dhe jo kur të dojë Doda. Madje, po të dua unë, nuk kthehem fare. Në këto mendime e sipër ai vajti në shtëpi duke ecur ngadalë-ngadalë. Hëngri një tas fasule, piu edhe një mashtrape të madhe me dhallë, pastaj i erdhi si gjumë.

“Nesër“, - tha me vete *Hasani i gungave*. - Nesër do ia rregulloj qejfin Dodës”.

Dhe u shtri të flinte.

Me tu larguar *Hasani i gungave* Doda ngriti dorën lart, e bëri turmën të heshtë e thirri: - O milet! Sot e kam pajtu unë shenjtin Tush për me rinxhallë xhyshin Reposh. Pra, asht në ndoren teme. Po e bezdisët kështu e nuk e latë rehat, do t'i them qi jo vetëm të mos ua rinxhallë të dekmit, por kam për ta ndërsy me u vdekë ene ju. Pranaj, rrini sa ma larg.

Pas këtyre fjalëve turma e frikësuar nga fjalët e Dodës

u distanca. Tashmë ata e vështronin Tushin nga larg, pa guxuar të afroheshin, ndërsa pëshpërisnin ndonjë fjalë vesh më vesh me njëri-tjetrin.

- Unë nuk jam shenjt, o Dodë, - tha Tushi. - Madje, as që dua të jem. Nuk dua të kem probleme... Ç'janë këto budallallëqe?!

Ndërkohë kishin mbërritur pranë një kafeneje. Në ambientin e jashtëm të saj, ndodheshin pesë a gjashtë burra nga ata skeptikët, që sapo i zumë me gojë. Qëndronin të ulur në karrige dhe, ndërsa gjerbnin në heshtje kafetë, hidhnin romuze me njëri-tjetrin. Diku në një tavolinë andej nga qoshja rrinte i vetmuar një burrë i panjohur për të gjithë, një mysafir i ardhur prej larg, që vështirë se mund t'ia përcaktoje moshën. Ky burrë mbante në kokë një kapele të vjetër, ishte i parruar dhe dukej si i trembur. Në karrigen pranë tij ndodhej një torbë gjysmë e mbushur. Tushi e njohu menjëherë: ishte Azraili.

Azraili kishte marrë shpirtin e plakut Reposh Marria dhe qe ndaluar një copë herë aty, edhe të pinte një kafe, edhe të shikonte gallatë me fisin e madh të Marrive.

Me të parë Azrailin, Tushi e kuptoi që ishte e kotë vajtja te plaku Reposh. Nuk kishte ç'bënte më aty, prandaj deshi të kthehej në rrugë. Por prapë i tha mendja që, ndoshta do të qe më mirë të mos tregonte që kishte parë Azrailin, sepse nuk do ia besonin. Thjesht të bënte çfarë i kërkonin dhe të largohej në punë të tij.

Fare pranë Tushit, një grua, që mbante një djalë të vogël për dore, krejt indiferente, përpiqej të hapte rrugë përmes turmës kureshtare që të shkonte në punë të vet. Djali e pyeste të ëmën sepse donte të dinte çfarë po ndodhte, por

e ëma e tërhiqte pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja. I vogli vazhdonte të këmbëngulte, donte patjetër një përgjigje nga e ëma. Atëherë ajo ndaloi për një çast dhe i pëshpëriti diçka në vesh.

- Unë dua ta shikoj këtë përrallë, - tha i vogli duke u ankuar me zë të lartë.

- Ta tregoj kur të mbërrijmë në shtëpi, - i thoshte e ëma me zë të vogël, ndërsa e urdhëronte të heshte.

- Jo, mami, jo,- kundërshtonte djali duke ngritur zërin gjithnjë e më fort. - Ti vetëm m'i ke treguar përrallat, por unë dua edhe t'i shikoj me sy. Asnjëherë nuk kam shikuar me sy ndonjë përrallë....

E ëma vazhdoi ta tërhiqte fëmijën pa ia vënë veshin në ato çfarë thoshte.

Kur Tushi u fut në dhomën e të vdekurit, gjeti aty katër gra. Dy qenë të reja. Ato hynin e dilnin; vinin rrotull duke bërë ndonjë punë; kurse dy të tjerat, qenë nëna e Dodës me motrën e saj. Kishin zënë vend të ulura rrafsh në një qoshe dhe bisedonin me njëra-tjetrën me zë të ulët.

- K'shtu si t' thash, moj Xhabie, - thoshte nëna e Dodës. - Plaku as që çeli gojë me tregu ku e kishte mshef çypin me flori... Xhith jetën e majtëm në pllamë të dorës me shpresën se do na i jepte ato flori. Të xhithë jemi ba copa për t'i shërby sa ma mirë. Derisa vdiç, i kemi shërby si me qanë mbret e shkue mbretit. E prap, moj motër, nuk i nxori, që nuk i nxori floringjtë...! Tash ja ku vdiç e shkoj belaziu... I hupi për xhithmonë... Jo, thuaje ene ti...! Kush asht aj, moj motër, si ia ban këtë t' pabame njerëzve t' barkut t' vet...?!

Mbi një tavolinë prej druri gjendeshin sendet personale të plakut Reposh, që kish ndërruar jetë: kutia e duhanit, llulla, qeleshja, shamia e hundëve, një shervete e kuqe si dhe shkopi.

Plaku Reposh qe shtrirë në një krevat të ulët, i sajuar me dërrasa. Kokën ia kishin pas lidhur me një shami për mjekre, që t'i mbanin gojën mbyllur. Njërin sy e kishte

të mbyllur, kurse tjetrin, të hapur. Kishin provuar t'ia mbyllnin, por nuk kishte qenë e mundur. Plaku kishte edhe mustaqe. Një palë mustaqe të mëdha si ato të kreshnikëve të maleve. Por Tushit nuk i bënë shumë përshtypje mustaqet. Atij i bënë përshtypje koka e anuar e të vdekurit si dhe vështrimi i atij syri të hapur që ishte ngulur drejt e në vatër të oxhakut.

Nisën ta brenin mendime: çfarë kishte dashur të shikonte plaku ato çastet e fundit të jetës? Përse kishte dhënë shpirt me vështrimin e atij syri të ngulur drejt e në vatër të oxhakut? Atij i tha mendja, që ndoshta, ai qypi me flori për të cilin i foli Doda ishte fshehur pikërisht në një gropë poshtë vatrës së oxhakut.

Doda i nxori nënën dhe tezen jashtë. Tushi pa që nga dritarja shtatë a tetë burra. Disa prej tyre qëndronin në oborr e disa të tjerë, në bahçe. Pinin duhan e bënë muhabet në mënyrë krejt të natyrshme. Nuk binte në sy ndonjë atmosferë dhe aq e përmortshme.

Me të nxjerrë gratë jashtë, Tushi iu afrua të vdekurit të bënte atë provën me shkrepëse. Që në fillim e dinte që ishte e kotë, sepse shpirti i tij nuk kishte si të ndizej sërish, përderisa tashmë ai ndodhej në torbën e Azrailit. Megjithatë, thjesht për formalitet, ai nxori shkrepësen nga xhepi dhe, si ndezi një fije, ia afroi plakut me shumë kujdes mu te vrima e hundës... Jo që nuk u pa ndonjë shenjë e ngjashme me ato që ishin shfaqur te Aush Loshi, por ndodhi më e keqja: mustaqja e djathtë e plakut të vdekur mori flakë. Tushi u përpoq ta shuante flakën, por ndërkohë që përpiqej të shuante njërin mustaqe, mori flakë edhe mustaqja tjetër. Ai u tërhoq i trembur dhe hodhi sytë nga

Doda, i cili, për çudinë e Tushit, ia plasi një të qeshure me gulçë. Ato çaste mori flakë edhe shamia me të cilën i kishin lidhur të vdekurit kokën për mjekre, që t'i mbanin gojën mbyllur... Nëse Tushi nuk do të kishte përllarë shpejt një batanije për t'ia hedhur sipër të vdekurit, do të ishte djegur gjithë shtëpia. Doda përpiquej të frenonte veten, që të mos qeshte, por nuk ishte e mundur.

- Më vjen shumë keq, - nisi të thoshte i tronditur Tushi. - Unë u mundova për mirë, por... Shikon çfarë ndodhi tani?!

Doda vazhdonte të qeshte nën vete me gulçë.

- Mos u mërzit, bre vllau jem - tha ai, sapo i frenoi për një çast gulçet e brendshme të gazit. - Tash do të themi, që ia rrujtëm mustaqet, sepse na e pati lanë amanet.

Dhe ia dha sërish një të qeshure që u përhap ajrit si një flatrim turtujsh.

U desh të kalonin minuta të tëra që Doda ta mblidhte veten prej gazit që e pushtoi.

Kur Doda pushoi së qeshuri, Tushi i foli atij për dyshimin që i kish lindur në kokë në lidhje me atë thesarin e fshehur.

- Shikoja vështrimin e fundit, - tha ai duke iu afruar gjyshit Reposh. - E ka ngulur pikërisht në vatër të zjarrit. Them se aty mund të gjendet thesari, prandaj ka vdekur pa e mbyllur atë sy.

Doda e la të qeshurën menjëherë.

- A thu vërtet, bre vllau jem?! - foli ai pa e frenuar dot një ngazëllim të brendshëm që dalëngadalë e bëri t'i ndizej fytyra si një llambë. - Nëse asht' kshtu, ne mund ta mbajmë t'fshehtë... Nuk do kallzojmë qi e xhetëm çypin.

- Nuk jam shumë i sigurt, - tha Tushi, - por syri që nuk

i është mbyllur dhe vështrimi i ngulur në vatër të oxhakut tregon që...

Doda vajti nxitueshëm dhe i futi shulin derës duke e mbyllur nga brenda. Pastaj që të dy u afruan pranë vatrës së oxhakut ku ndodhej një rrasë e madhe dhe e sheshtë guri e mbuluar me hi.

- A thua, bre vllau jem, të jetë ndonji gropë poshtë rrasës?! - tha Doda me kureshtjen tashmë të mprehur brisk. - Nëse çypi asht' poshtë rrasës... Për qiell e dhë ti je vllau jem sot e mot, sa t'jetë jeta.

Mori mashën dhe me majën e saj u përpoq të luante rrasën e gurit, por nuk ia doli dot. Atëherë e pastroi nga hiri dhe gjeti një të çarë nga e djathta. Duke përdorur majën e mashës, arriti ta luante vendit rrasën.

- O zot i madhnueshëm! - ia bëri ai. - Për qiell e dhë, o vllau jem, ë-hë, qenka një gropë nën rrasë! Shife, shife, ë-hë!

E mbërtheu rrasën me duart që i dridheshin dhe e hoqi. Hodhi vështrimin, dhe... Ç'të shikonte...! Qypi ndodhej aty, i futur në gropë drejt në këmbë!

- Ë-hë! Shif, o vllau jem, shif! Ë-hë...

Ato çaste dikush i ra derës.

- Kush asht' aj si i bie derës, bre? - pyeti i nervozuar Doda.

- Jam Xhela, - u përgjigj një zë i shtruar e i ëmbël femre prapa derës. - Kam harru mrena kusinë, qi mjel lopën.

Gjela ishte vajza e Dodës.

- Jemi t'zanë tash, oj Xhela, - tha Doda - Po i veshim xhyshit rrobat e reja, pranej hajde mas nja dhetë minutash.

- Po mu m'duhet të mjel lopën tash, sepse do e nxjerrin ta kullotin.



- Largohu t' thashë! - iu hakërrye nga brenda Doda.

- Mirë, pra, - tha Gjela që prapa derës. - Do ta nxjerrim lopën jashtë pa e mjelë.

Ata mbajtën vesh hapat e Gjelës që po largohej; pastaj Doda mbërtheu qypin me duart që i dridheshin dhe e nxori prej gropës. Hapi shpejt kapakun dhe... I iku goja fare! Çfarë pa Doda aty brenda?! Ç' ishte gjithë kjo hata?! Mos ndoshta gjyshi Reposh, që pati qenë shquar për rrengje në të gjallë të tij, kishte vendosur të tallej me ta duke u punuar rrengje edhe për së vdekuri?! Pa prit të shikojmë mirë, na bëjnë sytë, apo... Doda e uli kokën aq shumë të shikonte, sa gati e rراسi brenda qypit.

- Ë-hë, - ia bëri sërish ai. - Ni mut paska mrena! Ë-hë...

Futi dorën në qyp dhe nxori prej aty një bri të madh e të zi cjapi!

Ashtu siç qenë, Doda dhe Tushi qëndruan për pak kohë pa folur fare, sepse nuk dinin çfarë t' i thoshin njëri-tjetrit.

Ndodhi në një çast që Tushi u bë kurioz, donte të shikonte bririn. Ia mori Dodës nga duart dhe, si i hodhi një vështrim prej eksperti, gjeti brenda bririt një letër të vogël të mbështjellë tub. Futi dy gishtat brenda si pincë dhe e nxori.

- Po kjo, ç' është? - pyeti ai disi i habitur duke ia treguar Dodës.

- Ma jep mua, - tha Doda dhe ia rrëmbeu nga dora si i babëzitur. - Noshta e ka lanë t' shkrueme k' tu, se ku nodhet i mshefun çypi me florihtë.

E shpëstolli letrën dhe lexoi:

*Atij,  
që punën s'e don  
dhe kërkon  
e shpreson  
të gjejë flori,  
i hyftë në bythë  
ky bri i zi!*

- Më duket se na e punoj rrengçorri...! - tha Doda teksa i ra ballit me pëllëmbë. - Na çoj ke çulli! Për qiell e dhë, o vllau jem, na ka gënjy. E ka pas shpik historinë e qypit me florinj, qi t'i bajm hysmet!

Tani, në pamje të parë, ndodhitë e kësaj historie tingëllojnë si të pavërteta, si një lajthitje e autorit. Por unë, ju betohem në Zot, që pak para se të shkruaja këto rreshta, u ktheva nga vizita që bëra te mjeku psikiatër, Neki Alizoti, i cili, më garantoj që mendja ime punon krejt në rregull. Unë vajta tek psikiatri, jo se kisha ndonjë shqetësim apo sepse dyshoja tek vetja, por vajta për hatër të sime shoqeje, e cila...

Më mirë, po e tregoj si ndodhi:

Para ca kohësh më mori shumë malli për veten. Një mall zhuritës i paprovuar kurrë ndonjëherë. E ndjeja aq shumë mungesën e vetes, sa nisa të qaj me lot. Nuk ishte fjala për t'u parë në pasqyrë, sepse ajo është një gjë krejt e thjeshtë, e bëjnë të gjithë. Dhe kur e bëjnë, ca ndjehen mirë e ca të tjerë, ndoshta jo. Sepse ndodh, që në pasqyrë të shfaqet një fytyrë krejt e huaj, që nuk është aspak e jotja. Ti ndjen në shpirt butësi, mëshirë për njerëzit në hall, dashuri pakufi për jetën; je shumë i ëmbël dhe i bukur nga brenda. Dhe kur komunikon me njerëzit, goja të nxjerr mjaltë në vend të fjalëve. Por kur hedh sytë në pasqyrë për të parë veten, të shfaqet një fytyrë e vrazhdë, me sy të kërcyer, një hundë si patëllxhan me tre-katër qime në majë; rrudhat dhe

brazdat në lëkurën tënde, të kujtojnë se jeta, ndonëse e ke dashur shumë, nuk ka qenë për ty një nënë e dhembshur, por ka qenë një njerjë e pashpirt. Atëherë, gjithë ndjesitë e tua, gjithë ai shpirt i bukur shkartistet, bie në rënie të lirë, derisa brenda unit tënd dëgjohej një përplasje e madhe, që rezulton të jetë shkatërrimtare. Kjo përplasje nuk ndodh pranë teje. Ajo ndodh shumë larg. Dhe pikërisht për këtë shkak, ti je i pavëmendshëm. Por dita-ditës ti ndjehesh i braktisur nga uni yt i brendshëm, që ka mërguar nuk dihet se ku. Kupton që s'je tjetër, vetëm se një krijesë e huaj, një krijesë që ngjan me të gjithë, një shëmbëlltyrë e tyre, por kurrë nuk je uni yt, nuk je vetvetja.

Pra, siç thashë, mua më ndodhi të zhuritesha nga malli për unin tim të brendshëm, të cilin, për shkak të mungesës së vëmendjes, si dhe për shkak se kisha dashur të përshtatesha në jetë, kisha dalë prej tij e isha larguar aq fort, sa një zot e di ku gjendesha. Madje, unë nuk dija as cili isha; dhe kjo, sa herë e mendoja, më frikësonte tej mase. Kjo mungesë e unit më bëri të vuaja. Nuk di pse dëshiroja me zjarr të isha ai ferishtja i sapolindur para pesë dekadash dhe të qaja edhe njëherë fort, siç kisha qarë kur pata dalë nga barku i ujhëm i nënës time. Ato çastet e zbritjes në këtë botë duhet të kenë qenë më të bukurat. Sepse nuk ka lumturi më të madhe sesa kur të mbajnë në pëllëmbë të dorës si një dhuratë e dërguar prej Zotit. Pastaj, teksa rritesha, pak e nga pak fillova ta përdhosja vetë virgjërinë time. Kur nisa të nxjerr belbëzimet e para, të ec e të zgjasja dorën për të kapur sendet, pikërisht atëherë duhet të kem rënë në mëkatet e vogla, të cilat, me kalimin e kohës, kanë ardhur duke u rritur.

Gjatë fëmijërisë time të hershme më thonin se i kisha ngjarë babait tim, se kisha marrë pak edhe nga daja, por edhe nga gjyshi e stërgjyshi, të cilët, i mbanin mend shumë pak.

Flokët i kisha të zez si të dajës, hundën, të gjyshit, zërin dhe gjestet si të babait, ecjen si ajo e vëllait tim të madh, që tashmë ka vdekur; trupin prej vigani si të stërgjyshit, për të cilin, fliste një foto e vjetër. Kjo foto gjendet edhe sot në njërin nga muret e brendshme të muzeut të Bibollit. Dhe tmerrohem kur mendoj që ai ka qenë edhe në luftë. Atje ka vrarë shumë të tjerë. Sigurisht, e ka bërë për të qenë ai që ishte. Ndoshta ia ka arritur e ndoshta jo. Por le të kthehem sërish te vetja. Pra, unë isha pak nga të gjithë këta burra. Të gjithë këta njerëz kishin dhënë nga pak për të më sajuar mua, derisa më pagëzuan me një emër, që, të them të drejtën, nuk më ka pëlqyer kurrë. Nëse do të ndodhte që t'ua ktheja mbrapsht gjithçka kisha marrë prej tyre, do të kisha humbur e do isha bërë fir, nuk do të gjendesha askund në faqe të dheut. Kurse emri im, i cili është thjesht një markë e gabuar, do të qe vetëm një abstraksion, asgjë më tepër. E ndjeja që ai emër nuk më përkiste aspak, ndaj më vinte ta flakja tej. Po si mund ta bëja këtë? A ishte e mundur një gjë e tillë? Madje njëherë, m'u fiksua sikur emrin ma kishin vënë për të vetmin qëllim të caktuar, për një qëllim makabër: para se të më gjuanin me plumb prapa koke, të më thërrisnin në emër, që ta ndjeja më fort tmerrin e vdekjes. Vallë, kur mund të ndodhë kjo? Do të ndodhë sot, nesër apo pas një jave? A nuk është një torturë mizore të të kalojë gjithë jeta duke pritur që armiku yt mizor, ai *zoti i vogël* fare, para se të shkrehë këmbëzën e armës së tij

vdekjeprurëse, të të thërrasë një herë në emër?! Ky mendim më dëshpëronte pa masë dhe më bënte të vuaja. Nuk më pëlqente aspak kjo përzierje, sepse nuk isha tjetër veçse një sajese me copëza të huaja, që edhe ishin, edhe nuk ishin të miat. Sepse edhe isha edhe nuk isha ai që duhej të isha. Ndoshta, pikërisht për këtë, meritoja të vdisja.

Fill pas kësaj ndjesie mora penën dhe i shkrova një letër vetes. Vetes time pa emër. Kur e mbarova, i vendosa një pullë dhe e hodha në kutinë postare. Pastaj ia thashë këtë time shoqeje.

- Për ku e nise letrën? - pyeti ajo.

- E hodha zarfin me letrën në kutinë postare, pa shkruar mbi të ndonjë adresë, - thashë unë.

- Përse nuk e shkrove adresën? - pyeti sërish ajo.

- Sepse, në të vërtetë, nuk e di ku gjendem.

Ime shoqe në fillim stepi; më pas më vështroi me një si frikë përzier me dhembshuri.

Tek e mbramja u bë kurioze, donte të dinte çfarë i shkrova vetes; por unë i thashë që ende nuk e kisha marrë e lexuar letrën dhe se do t'i jepja një përgjigje sapo ta lexoja.

- Vishu shpejt, - tha menjëherë ajo shumë e shqetësuar.

- Do të shkojmë për një kontroll te doktori psikiatër Neki Alizoti.

- Prit, moj, - i thashë. - Pse me kaq ngut? Unë jam mirë si kokrra e mollës. Çfarë dua unë te doktor Nekiu?!

- E di, moj zemra ime, e di që je shëndoshë e mirë, - tha ajo. - Por, a të kujtohet, para shtatë a tetë vjetësh, që e lamë pa bërë një vizitë që patëm planifikuar? Bile, nëse e mban mend, doktor Nekiu asokohe na caktoi edhe ditën edhe orën e takimit, që ka qenë e hënë, ora nëntë e gjysmë

paradite. Atëherë ne nuk vajtëm, sepse plasën trazirat dhe u vendos shtettrrethimi. Pastaj harruam, na doli menç fare. Atë vizitë, pra, do të shkojmë të bëjmë sot, sepse ka qenë shumë e rëndësishme.

Ç't'i thoja? Nuk doja t'ia prish, prandaj dhe vajtëm.

Doktor Neki Alizoti, për çudinë time, më bëri ca pyetje nga ato që u bëhen të çmendurve dhe unë, pikërisht për këtë shkak, e pashë me vend të mos i përgjigjesha fare.

- Nga gjithë pacientët që kam njohur gjatë karrierës sime, ti je më kopili, - tha më në fund ai.

- Nuk jam pacient, - e kundërshtova aty për aty.

- Unë jam psikiatër, - tha ai. - Për mua të gjithë njerëzit janë pacientë.

Dhe më ftoi të bënim një lojë shahu.

Që nga koha e zhvillimit të kësaj historie kanë kaluar vite dhe gjërat kanë ndryshuar.

Ish sekretari i partisë hoxhë Rrahimi vdiq nga SIDA para një muaji e gjysmë. Xhamia ku ai shërbeu, tani thirret *Xhamia e horrit* dhe fare pak besimtarë futen aty. Ata preferojnë më shumë të merren vesh me Zotin drejtpërsëdrejti, sesa me hoxhën si ndërmjetës.

Aush Loshi, *Sulejmani i madhërisëm i letërsisë bashkëkohore* është dekoruar nga presidenti i republikës me titullin “*Nderi i kombit*“. Vepra e tij është futur në programet mësimore dhe studiohet nga studentët në shkolla. Edhe gazetatat mbushen nganjëherë me shkrime mbi jetën dhe veprën e këtij patriku të madh të letrave. Nganjëherë, gazetarët shkojnë ta intervistojnë, por ngase Aushi flet përçart, përgjigjet e pyetjeve i sajajnë vetë, duke krijuar kështu kontradikta mes fjalëve që janë thënë dhe atyre që thuhet sot.

Edhe akademiku Hashim Sholla ka vajtur me kohë tek të shumtit. Ai la një vepër të madhe shkencore të pabotuar. Karroca e mbushur me punime shkencore del shpesh në ankand, ku shitet e blihet dorë më dorë me çmime që koha-



kohës vijnë duke u rritur. I biri i tij, Halimi, shiti edhe tokat që kishte trashëguar nga të parët e tij dhe ngriti një akademi, së cilës i ka vënë emrin “*Akademia Hashim Sholla*”.

Xim Pinci vazhdon të ngrejë barrikada në mes të rrugës për të penguar futjen në Biboll të një të ardhmeje të keqe... Kur ia heqin sendet që grumbullon në mes të rrugës, ai bëhet aq shumë nervoz, sa nis të qajë.

Karrocieri Mark Pati, me lekët që mori si dëmshpërblim nga Brahim Çadërbashi, bleu një kalë tjetër dhe tani punon me karrocë. Tashmë ai jeton bashkë me vejushën Liseta Blumi dhe ka lindur me të edhe një fëmijë, një djalë, që e merr nganjëherë për ta shëtitur me karrocë rrugëve të Bibollit.

Liseta vazhdon të besojë se Mark Pati, me të cilin ajo ka vendosur të kalojë gjithë jetën, është burri i saj i vdekur dhe i ringjallur sërish.

Azrailit i ka ecur mirë biznesi, pasi në Biboll janë shtuar shumë vrasjet. Ngase nuk ia dilte dot vetë t’i mblidhte shpirtrat e të vdekurve, ai ka punësuar agjentë që bëjnë punën e tij në të katër anët e Bibollit.

Inspektori i kontrollit të shtetit Baki Dallkauku është bërë dy herë ministër i ekonomisë dhe i energjetikës. Bashkë me Fazil Krosin ata kanë blerë një ishull të shkretë, të cilin kanë ndërmend ta popullojnë për interesat e tyre.

Doktori psikiatër Neki Alizoti më fton shpesh për të bërë nga një lojë shahu. Kur del i mundur nga loja, ankohet e thotë se ia kam bërë me hile. Ai vazhdon të më trajtojë me shumë kujdes, ashtu siç trajtohet një pacient; dhe ende mendon që nga të gjithë pacientët e tij, unë jam më kopili.

Edhe Zav Tarrota, edhe Brahim Çadërbashi kanë

vdekur nga pleqëria. Jetojnë vetëm gratë e tyre, tashmë të plakura.

Dodë Marria ka vite që rropatet pas rrenës së gjyshit Reposh. Vazhdon të gërmojë tokën gjithandej për të gjetur qypin me flori. Edhe pse gjindja i hedh shpesh romuze dhe e tall duke i përmendur atë bririn e zi të cjamin, ai prapë shpreson që gjyshi Reposhi nuk ka luajtur me ta, por e ka groposur diku thesarin e tij.

Liza Piluri po i jeton vitet e fundit të jetës së saj në një azil pleqsh. Para do kohësh ajo i sollti shumë telashe *Sulejmanit të madhërishëm të letërsisë bashkohore*, Aush Loshit, sepse hapi fjalë që kishte qenë dashnorja e tij e fshehtë për shumë vite. Ky lajm shokues zuri faqet e para të gazetave për gati dy javë rresht. Kurrë nuk u mor vesh, nëse Liza tha të vërtetën apo gënjeu për të treguar që kishte qenë frymëzuesja e një poeti të madh si Aushi.

Lushja është bërë, si të thuash, pasqyrë e Tushit dhe Tushi, po ashtu, pasqyrë e Lushes.

Ajo vjen e shëndoshë nga trupi. Ngase ka një prapanicë bajagi të madhe, për të ruajtur balancën, ecën gjithnjë me trupin paksa të përkulur përpara, duke nxjerrë si kundrapeshë dy cica aq të mëdha, sa nuk do t'i mbanin dot as dy kosha nga ato që fermerët i mbushin me rrush.

Dhëmbin e thyer e ka rregulluar te dentisti. Dhe mban në faqe të njëjtin nishan që ka pasur më parë.

Lushja vazhdon të ketë atë fytyrë që ka pasur: as e bukur, as e shëmtuar. Sytë i ka të zinj e të mëdhenj me harqet e vetullave të trashë. Kur është në të mira, asaj i qeshin e i rrezatojnë mirësi, por në çaste zemërimi, nga ata sy buron një dritëzim i ftohtë.

Flokët i kanë marrë një ngjyrë kashte thekri. Për më tepër, ajo i ka aq të rralluar, sa po të ulesh pranë saj dhe të nisësh t'ia numërosh, bëhen a nuk bëhen nja dyqind fije. Ngase i ka të rralla e të shkurtra, ajo i lidh tufçe prapa kokës.

Nganjëherë e shikojnë të vendosë ndonjë shami dhe kjo ndodh kur del nga shtëpia për vizitë te ndonjë i afërm i saj ose kur shkon të blejë gjësend dyqaneve. Çifti ka sjellë në jetë katër fëmijë, dy djem e dy vajza, që shkojnë çdo ditë në shkollë.

Tushin ajo e trajton si ta kishte fëmijë dhe jo burrë. I jep këshilla kur mendon se duhet, e qorton në rastet kur sipas saj ai bën gabime dhe kujdeset për të mu sikur ta kishte rritur vetë.

Në mëngjes, para se i shoqi të dalë nga shtëpia, ajo i bën një si kontroll rreshtor. E urdhëron të rrijë para saj drejt në këmbë dhe i shkon njëherë rrotull nga të gjitha anët mu si një komandante e ndonjë toge ushtarësh për të zbuluar ato që ajo i quan “*defekte të riparueshme*”.

Kësisoj nis avazi: prit të marr gërshtëren të të pres nja dy qime që të janë rritur shumë te vetulla e syrit të djathtë; mbërtheje zinxhirin e pantallonave, sepse e ke lënë hapur; i ndërrova të brendshmet pasi u lave mbrëmë? Prit ta drejtoj pak jakën e këmishës... Shikon? I ke mbërthyer keq kopsat, prandaj të rri shtrembër. Njërën çorap e ke veshur nga e prapa... Nxirre shpejt dhe ktheje për së mbari... Me lëng groshe e ke bërë xhaketen? Hiqe ta pastroj me një mapë të lagur me ujë. Tani fshije hundën, sepse na efshtove. . Jo aty, jo; fshije nga ana tjetër. Iiii..... Të marrtë e mira, të marrtë...! Dhe mos më shiko ashtu, sepse t'i shkula veshët

e t'i dhashë në dorë. Pa ma thuaj njëherë me blegërimë, që të marr vesh sa shumë më do.

Dhe Tushi zgjat turirin përpara e blegërin:

- Be-hee-heee...

- Beee..., - ia kthen edhe Lushja.

Dhe nisin të qeshin të dy.

Nganjëherë, ajo i bën këto edhe në sy të miletit, duke e vënë të shoqin në një pozitë të vështirë. Në raste të tilla, Tushi merr pamjen e një burri autoritar; hiqet sikur fjalët e gruas në njërin vesh i hyjnë, në tjetrin i dalin; madje ai hedh edhe ndonjë romuz në adresë të saj për t'i bërë të tjerët të qeshin. Por, kur gjenden vetëm për vetëm me të, ai zgërlaqet para saj, nuk bën dot as gëk as mëk, i aprovon të gjitha sa thotë gruaja me një bindje të përlulur prej gjynahqari.

Tani, koha e blegërimave të dashurisë së tyre ka perënduar. Megjithatë, ata sërish blegërijnë; blegërijnë për gjëra të tjera, për të cilat, autori i këtij libri, ndoshta do t'ju rrëfejë ndonjë herë tjetër.

Fund